

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2024



45

PRISHTINË
2025

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2024

45



PRISHTINË
2025

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

YEAR-BOOK 2024

45

Editor: Correspondent member Myzafere Limani

Prepared by: Lendita Juniku-Pula



**PRISHTINA
2025**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2024

45

Redaktor: Anëtare korresponente Myzafer Limani

Përgatitur nga: Lendita Juniku-Pula



**PRISHTINË
2025**

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË	1
KRYESIA	1
ANËTARËT E AKADEMISË	3
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	3
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	3
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	3
SEKSIONI I ARTEVE	4
ANËTARËT IN MEMORIAM	4
ANËTARËT E JASHTËM	4
ANËTARË NDERI	5
SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK	5
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024	9
KUVENDI I AKADEMISË	9
KRYESIA	16
PROJEKTI ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE	51
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	49
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	51
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	53
SEKSIONI I ARTEVE	56
RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2024	57
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2025	61
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	75
KRONIKA E VITIT 2024	83

PËRBËRJA E AKADEMISË

KRYESIA



Akademik
Mehmet Kraja
Kryetar
(3.10.2019 – vazhdim)

Akademie
**Justina
Shiroka-Pula**
Nënkryetare



Anëtar
korrespondent
Nysret Krasniqi
*U.d. Sekretar
shkencor*
(1 prill 2024 –
30 shtator 2024)



Akademik
Sabri Hamiti
*Sekretar i
Seksionit të
Gjuhësisë dhe të
Letërsisë*



Anëtar
korrespondent
Besnik Krasniqi
*U.d. Sekretar
shkencor*
(1 tetor 2024 –
31 mars 2025)



Anëtar
korrespondent
**Fetah
Podvorica**
*Sekretar i
Seksionit të
Shkencave të
Natyrës*



Anëtare
korrespondente
**Gjyljeta
Mushkolaj**
*Sekretare e
Seksionit të
Shkencave
Shoqërore*



PËRBËRJA E AKADEMISË

ANËTARËT E AKADEMISË

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më
2004,
Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më
2020,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më
2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më
1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më
1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më
2008.
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur
më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më
2016,
Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më
2012,
Nysret Krasniqi (1976), i zgjedhur më
2020,
Shkumbin Munishi (1971) i zgjedhur më
2020.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më
2016,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,

Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më
2016.

Justina Shiroka Pula (1953), e zgjedhur
më 2020,
Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur
më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më
2012,
Besnik Krasniqi (1978), i zgjedhur më
2020,
Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më
2016,
Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur
më 2016,

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më
2012,
Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më
2000,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më
1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më
2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më
2016,

Myzafere Limani (1954), e zgjedhur më 2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më 2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):
Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):
Agim Çavdarbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Idriz Ajeti,
Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Edi Shukriu,
Ekrem Murtezai,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Luan Mulliqi,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,

Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

ANËTARËT E JASHTËM

Branko Pavićević (histori), Mali i Zi, i zgjedhur më 1976.
Dragiša Ivanović (fizikë), Mali i Zi, i zgjedhur më 1976.
Dušan Kanazir (biokimi), Serbi, i zgjedhur më 1976.
Ed-hem Čamo (veterinë), BiH, i zgjedhur më 1976.
Grga Novak (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1976.
Janez Milčinski (mjekësi ligjore), Slloveni, i zgjedhur më 1976.
Mihajlo Apostolski (histori), Maqedoni, i zgjedhur më 1976.
Pavle Savić (fizikë), Serbi, i zgjedhur më 1976.
Aleksandar Stipčević (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983.
Branislav Đurđev (histori), BiH, i zgjedhur më 1983.
Ramiz Abdyl (shkencat ushtarake), Kroaci, zgjedhur më 1983.
Agnia S. Desnickaja (gjuhësi), Rusi, e zgjedhur më 1991.
Eric P. Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 1991.
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991.
Joseph Milie-Emili (mjekësi), Kanada, i zgjedhur më 1991.

Kolë Popa (kimi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991.
 Neil S. Cherniack (mjekësi), SHBA, i zgjedhur më 1991.
 Wilfried Fidler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991.
 Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996.
 Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996.
 Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996.
 Çesk Zadeja (muzikë), Shqipëri, i zgjedhur më 1996.
 Gjelo Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996.
 Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000.
 Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000.
 Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000.
 Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000.
 Ibrahim Kodra (art figurativ), Itali, i zgjedhur më 2000.
 Tish Dijs (muzikë), Shqipëri, i zgjedhur më 2000.
 Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004.
 Noel Malcolm (histori), Britania e Madhe, i zgjedhur më 2004.
 Emin Riza (trashëgimi), Shqipëri, i zgjedhur më 2008.
 Francesco Altimari (gjuhësi), Kalabri, Itali, i zgjedhur më 2008.
 Muhamed Mufaku (orientalist), Jordani, i zgjedhur më 2008.
 Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
 Koleç Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
 Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
 Radoslav Katičić (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012,

Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2016,
 Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i zgjedhur më 2016.
 Brian D. Joseph (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2020.
 Irena Sawicka (gjuhësi), Poloni, e zgjedhur më 2020.
 Abdylmenaf Bexheti (ekonomi), Maqedoni, i zgjedhur më 2020.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, (farmakologji), i zgjedhur më 2000.
 Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Tereze), (humaniste), e zgjedhur më 1990.
 Josip Broz Tito, kryetar i RSFJ-së, i zgjedhur më 1979.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Lendita Juniku Pula, sekretare e Akademisë,
 Vjollca Hykolli, drejtoreshë e Departamentit për Buxhet dhe Financa,
 Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit,
 Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë për marrëdhënie ndërkombëtare,
 Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese, Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa,
 Lidije Kelmendi, zyrtare e librisë,
 Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e lartë për bibliografi dhe hulumtim shkencor
 Naime Velu, zyrtare për arkiv
 Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut,
 Gerta Çuna, zyrtare e TI- së për përkrahje,

Burim Rexhepi, zyrtar i lartë për
botime,
Nitë Krasniqi, zyrtare e logjistikës
Dafina Kavaja, asistente ekzekutive
Petrir Bashota, zyrtar zotues
Valbona Olluri, zyrtare teknike
Alban Bytyçi, vozitës-korrier.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024



KUVENDI I AKADEMISË

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2024 ka mbajtur katër mbledhje. Mbledhja e parë më 28 shkurt (CXIII), mbledhja e dytë më 7 mars (CXIV), mbledhja e tretë më 18 qershor (CXV) dhe mbledhja e katërt më 23dhjetor (CXVI).

I. Mbledhja e parë i vitit 2024 (CXIII) u hap me një minutë heshtje në nderim të veprës së akademik Feriz Krasniqit i cili ndërroi jetë më 26 janar 2024.

Në këtë mbledhje të Kuvendit u shqyrtua raporti i punës së Akademisë për vitin 2023 dhe raporti financiar për vitin 2023. Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta në të cilat i kanë shqyrtuar dhe i kanë miratuar raportet e punës së tyre. Më pas edhe Kryesia e ka shqyrtuar raportin e përgjithshëm dhe materialet për këtë mbledhje janë ndarë me kohë.

Ai kërkoi që sekretarët e seksioneve të deklarohen në rast të ndonjë plotësimi eventual. Sekretarët u deklaruan se nuk kanë asgjë për të shtuar.

Kuvendi njëzëri e miratoi raportin e punës të ASHAK-ut dhe raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2023. U tha që këto raporte do të botohen në revistën “Vjetari 2023”.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje, kryetari Kraja foli për veprimtarinë botuese dhe projektet e ASHAK-ut. Ai tha se kemi probleme me dorëshkrime, sepse po hyjnë në program të punës

dorëshkrime të papërfunduara dhe më pas ato po paraqiten edhe në tenderin e vitit përkatës, po ashtu të papërfunduara dhe apeloj që asnjë dorëshkrim të mos përfshihet në program të punës pa qenë i gatshëm.

Sa u përket projekteve, ai tha se ka disa projekte të cilat figurojnë për vite me radhë në programet e punës së ASHAK-ut, por nuk ka punë në to dhe nuk ka asnjë raport. Bartësit e tyre duhet të hartojnë raport me shkrim në të cilin duhet të paraqitet puna e bërë dhe një arsyetim për mbylljen e punës. Nuk mund të lejojmë më që projektet të na figurojnë nëpër programe të punës e të mos ketë asnjë punë.

Në vazhdim kryetari e njoftoi Kuvendin se Kryesia e Akademisë ka ngritur dy grupe punuese, një për plotësimin e Statutit dhe të Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë dhe një tjetër për hartimin e akteve normative për themelimin e Akademisë së të rinjve.

Grupi i parë ka kryer punën dhe nga nesër të gjithë anëtarët e Akademisë do t'i marrin të dy draftet. Do t'u lihet në dispozicion rreth një muaj kohë për të paraqitur vërejtje, propozime e sugjerime, të cilat më pas i dërgohen grupit punues. Grupi i shqyrton dhe më pas të dy draftet do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit në qershor.

Grupi punues ka marrë mandat nga Kryesia për plotësimin e Statutit dhe

Rregullores, vetëm për funksionalizimin e Seksionit të Arteve dhe eventualisht edhe ndonjë seksioni tjetër që për ndonjë arsye, nuk mund të jetë funksional.

Sa i përket grupit të dytë ai tha se themelimi i akademisë së të rinjve është kërkesë e kahershme e ALLEA-s, por tani duhet të nisim punën. Të gjitha dokumentet që hartohen, do t'u dërgohen të gjithëve për shqyrtim si drafte.

Në vazhdim diskutoi H. Islami. Ai tha se në një nga mbledhjet e kaluara kryetari Kraja e ka akuzuar padrejtësisht për donacionet e projektit *Vendbanimet e Kosovës*. Ai tha se me qëllim të njoftimit të drejtë të anëtarëve të Akademisë e ka mbledhur të gjithë materialin dhe se në të janë të gjitha dokumentet, duke filluar nga marrëveshjet me dy ministritë MAPL dhe MKRS, dëshmitë e mbajtjes së punëtorive, faturat për të gjitha shpenzimet etj...dhe se të gjitha është i gatshëm t'i prezantojë një nga një.

Kryetari Kraja tha se ai ka folur në bazë të asaj çfarë ka lexuar në raportin e punës, por tani është mirë që janë të gjitha dokumentet përkatëse dhe u sqarua kjo çështje.

Në vazhdim diskutoi M. Kullashi. Ai shprehu indinjatën e tij për mospjesëmarrjen e ASHAK-ut në asamblenë e UAI, në Filadelfia. Ai tha se mospjesëmarrja e ASHAK-ut atje nuk na bën nder, sepse bashkëpunimi me ta ka qenë në nivel dhe frytdhënës.

M. Kullashi po ashtu shprehu indinjatë për mosnënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Akademinë e Linceit.

Lidhur me diskutimin e M. Kullashit për mospjesëmarrjen e ASHAK-ut në asamblenë e UAI, M. Kraja tha se për këto punë është kompetent Këshilli për Bashkëpunim Ndërkombëtar i ASHAK-ut. M. Kullashi është anëtar i Këshillit dhe në bazë të informatave që kam ai asnjëherë nuk ka marrë pjesë në mbledhje të Këshillit, edhe pse ka pasur ftesë të rregullt.

Sa i përket marrëveshjes me Akademinë e Linceit, M. Kraja tha se ajo marrëveshje është sjellë disa vjet nëpër Akademi, më pas kur ka ardhur zyrtarisht nga Akademia e Linceit, unë e kam nënshkruar. Më pas iu kemi dërguar atyre me nënshkrim, e kanë pranuar dhe e kanë nënshkruar. Marrëveshja pra është e nënshkruar dhe tani jemi në pritje të përcaktimit të pikave të bashkëpunimit.

Në fund diskutoi J. Sh. Pula. Ajo tha se seksionet i kanë propozuar anëtarët e Këshillit në mbledhje të rregullta. Më pas Kryesia me vendim të veçantë, në bazë të propozimeve të seksioneve e ka ngritur Këshillin. Tani atë Këshill e udhëheq nënkryetari i Akademisë. Unë i kam ftuar me rregull mbledhjet e Këshillit, por nuk ka pasur kuorum për mbajtjen e tyre, sepse nuk kanë ardhur anëtarët në mbledhje. Akademik Kullashi tani po deklaron që është tërhequr, por ai nuk ka paraqitur me shkrim asgjë. Ajo i luti anëtarët e Këshillit që të marrin pjesë në mbledhje. Nëse dikush do që të tërhiqet për çfarëdo arsye, të njoftojë me shkrim, ashtu që sa më parë të zëvendësohen dhe Këshilli të funksionalizohet.

II. Mbledhja e dytë të Kuvendit CXIV u mor vetëm me zgjedhjen e sekretarit shkencor të ASHAK-ut.

Me kërkesë të kryetarit Kraja L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 29 anëtarë të Akademisë nga 35 (pa akademik Rexhep Qosja) sa janë gjithsej. Sekretar shkencor i Akademisë mund të zgjidhet kandidati që merr 18 vota.

Kryetari më pas propozoi komisionin e zgjedhjeve më këtë përbërje: Eqrem Basha, Besnik Krasniqi dhe Fetah Podvorica. Propozimi u miratua njëzëri.

Para fillimit të procesit të votimit diskutoi H. Islami. Ai propozoi që të mos përfshihen në kuorum disa anëtarë të Akademisë të cilët nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, ashtu që të krijohet mundësia e zgjedhjes së Sekretarit shkencor dhe të mos përsëritet situata si në Kuvendin e kaluar. Ai tha se jemi në gjendje jo të mirë meqë nuk po mund të bëjmë zgjidhje. Ndoshta është dashur Kryesia të ndër marrë veprime, duke biseduar me të tre kandidatët që të tërhiqet njëri. Ka edhe mundësi tjetër, të përdoret shorti në mes të tre kandidatëve, është një gjë normale që mund të aplikohet në raste të tilla. Pas fjalës së H. Islamit, kryetari Kraja tha se në kuorum mund të mos përfshihet vetëm akademik Rexhep Ferri, meqë vetëm për të kemi njoftim zyrtar që nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Akademisë, për të tjerët nuk kemi njoftime zyrtare. Sa i përket shortit, ai tha se as Ligji e as Statuti i Akademisë nuk parasheh diçka të tillë dhe propozoi të shpërndahen fletëvotimet.

Me pajtimin e Kuvendit u shpërndanë fletëvotimet.

Pas votimit, me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Sekretari shkencor të Akademisë: votuan 29 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe asnjë e pavlefshme.

Anëtar korrespondent Bardh Rugova mori 9 vota

Akademik Fejzullah Krasniqi mori 10 vota

Anëtar korrespondent Frashër Demaj mori 10 vota.

Meqë asnjëri nga kandidatët nuk mori numrin e nevojshëm të votave, në përputhje me Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 12, paragrafi 3, votimi u përsërit për kandidatët me numër më të madh, përkatësisht kandidatët me numër të njëjtë të votave. U bënë gati fletëvotimet për votimin e dytë.

Pas votimit të dytë u mbledh Komisioni i zgjedhjeve dhe pas numërimit të votave konstatuan se votimi i fshehtë dhe të njëjtin rezultat:

Votuan 29 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 27 fletëvotime të vlefshme dhe dy të pavlefshme.

Akademik Fejzullah Krasniqi mori 14 vota

Anëtar korrespondent Frashër Demaj mori 13 vota.

Në fund kryetari Kraja tha se edhe kësaj radhe dështoi zgjedhja e Sekretarit shkencor. Statuti i Akademisë, neni 35, paragrafi 3 parasheh një zgjidhje në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit shkencor dhe saktëson: “Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit shkencor, Kryesia me vendim të veçantë cakton ushtruesin e detyrës së Sekretarit shkencor”. Meqë muajt në vijim ka shumë aktivitete shkencore e

artistike të parapara me programin e punës për vitin 2024, nuk kemi mundësi të thërrasim pandërprerë mbledhje të Kuvendit, prandaj Kryesia në bazë të nenit 35, paragrafi 3 do të caktojë ushtruesin e detyrës për periudhën gjashtëmujore. Do të ndjekim parimin e renditjes së seksioneve: SGJ, SSHSH dhe SSHN dhe sigurisht që kandidatët e njëjtë do të jetë mirë të mos përfshihen. Në ndërkohë mund të mendojmë prapë si Kryesi për thirrje të mbledhjes zgjedhore, pasi të përmbyllim fazën e aktiviteteve dhe të Kuvendit të punës të qershorit.

III. Në mbledhjen e tretë (CXV) të Kuvendit kryetari Kraja fillimisht e ftoi Kuvendin për një minutë heshtje në nderim të veprës së akademik Rexhep Ferrit i cili ndërroi jetë më 6 qershor 2024.

Në vazhdim Kuvendi filloi shqyrtimin e programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2025. Kryetari Kraja tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta dhe i kanë miratuar programet e punës së tyre. Programi i punës më pas është shqyrtuar nga Kryesia e Akademisë dhe sot jemi këtu për ta miratuar atë. Ai i ftoi sekretarët e seksioneve të raportojnë nëse kanë diçka për të shtuar. Meqë nuk pati asnjë diskutim kryetari kërkoi nga Kuvendi miratimin me vota të programit të punës. Programi i punës së ASHAK-ut për vitin 2025 u miratua njëzëri dhe do të botohet në revistën “Vjetari 2024”.

Në vazhdim Kuvendi i shqyrtoi me radhë plotësimin e Statutit të ASHAK-ut dhe plotësimin e Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Kryetari Kraja tha se Kryesia e Akademisë e ka ngritur grupin punues për të bërë plotësimin e Statutit dhe të Rregullores dhe grupi ka pasur mandat për të bërë vetëm plotësime të cilat e funksionalizojnë Seksionin e Arteve dhe ndonjë tjetër nëse paraqitet nevoja. Ai e ftoi A. Bajramin që si kryesues i grupit të njoftojë Kuvendin me ecurinë e punës. A. Bajrami njoftoi se grupi punues ka bërë propozimet sipas kërkesës së Kryesisë dhe draftin e Statutit dhe të Rregullores ua ka ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtje apo sugjerime. Meqë nuk ka pasur asnjë vërejtje apo sugjerim draftet e dokumenteve në fjalë i janë përcjellë Kryesisë për procedim të mëtejshëm.

Më pas Kryetari kërkoi nga L. Pula të ofrojë sqarimet e nevojshme për vazhdimin e punës. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 24 anëtarë të Akademisë nga 34 sa janë gjithsej (pa akademik R. Qosja). Statuti i Akademisë konsiderohet i miratuar me 2/3 e anëtarëve të Akademisë, apo 11 vota, ndërsa Rregullorja konsiderohet e miratuar me shumicë votash, apo 18 vota.

Diskutuan M. Limani, F. Podvorica dhe R. Ismajli.

M. Limani në diskutimin e saj propozoi që të shikohet mundësia që të mos përfshihen në kuorum disa anëtarë të Akademisë që nuk janë prezent që një kohë, por M. Kraja tha se nuk mund t'i heqim nga kuorumi anëtarët e Akademisë për të cilët nuk kemi njoftim zyrtar, sepse bëjmë shkelje ligjore. F. Podvorica propozoi të bëhet një zgjidhje alternative për çështjen e votimit, por R. Ismajli tha se nuk mund

të ketë zgjidhje alternative, sepse nuk e parasheh as Ligji e as Statuti.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi njëzëri plotësimin e Statutit.

Më pas filloi shqyrtimi i rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë.

S. Hamiti propozoi që te neni 4 të shtohet edhe një paragraf (1.3) dhe në atë paragraf të shënohet që: Të gjithë anëtarët e këtij Komisioni duhet të jenë nën 75-vjeç.

Propozimi i S. Hamitit doli në votim dhe mori vetëm 5 (pesë) vota. Propozimi nuk kaloi dhe Kryetari e paraqiti për votim Rregulloren. Votuan të gjithë anëtarët. Për votuan 20 anëtarë, ndërsa kundër votuan 4 anëtarë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se në këtë mbledhje ishte planifikuar të miratohen edhe aktet përkatëse për themelimin e Akademisë së të rinjve në kuadër të ASHAK-ut, por grupi punues me kryesuese Gjyljeta Mushkolaj nuk kanë arritur të kryejnë punët e përcaktuara nga Kryesia e Akademisë, prandaj kjo çështje shtyhet për një mbledhje tjetër të Kuvendit, përderisa Kryesia do ta shqyrtojë edhe një herë këtë çështje, si dhe përbërjen e grupit punues.

IV. Mbledhja e katërt (CXVI) e Kuvendit ishte mbledhje zgjedhore për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja i cili fillimisht e ftoi Kuvendin për një minutë heshtje në nderim të veprës së akademik Tahir Emrës i cili ndërroi jetë më 7 tetor 2024.

Ai më pas tha se në sallë janë të pranishëm 29 anëtarë të Akademisë, kuorum ka dhe mbledhja mund të fillojë.

Kryetari Kraja e propozoi përbërjen e Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, si në vijim: Jusuf Bajraktari, Zejnullah Rrahmani dhe Fejzullah Krasniqi.

Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Në vazhdim kryetari Kraja tha se sekretarët e seksioneve mund të paraqesin arsyetimet e shkurtra për secilin kandidat (për anëtar të rregullt, për anëtar korrespondent dhe për anëtar të jashtëm). Të gjithë sekretarët u deklaruan se nuk kanë asgjë për të shtuar.

Para fillimit të votimit kryetari Kraja kërkoi nga L. Pula të ofrojë sqarimet e nevojshme për procesin e votimit.

L. Pula tha se në sallë janë të pranishëm 29 anëtarë të Akademisë nga 33 sa janë gjithsej, pa akademik Rexhep Qosjen, që tani më me vendim të Kuvendit, ka kohë që nuk përfshihet në kuorum.

Ajo më pas njoftoi se, pas kërkesës së Kryesisë së Akademisë drejtuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë (APK) për dy kandidatët e propozuar nga UP-ja (Muhamet Hamiti dhe Lindita Tahiri), për të cilët ka pasur dyshime që mund të ketë konflikt interesi me dy anëtarë të Seksionit (S. Hamiti dhe Ali Aliu), nga APK ka ardhur përgjigjja e cila saktëson se:

“zyrtarët: z. Ali Aliu dhe z. Sabri Hamiti, duhet që gjatë gjithë procesit për përzgjedhjen/pranimin e kandidatëve pjesëmarrës për pranimin e anëtarëve

korrespondentë të Akademisë, nga fillimi e deri në përfundim të këtij procesi, të tërhiqen tërësisht nga çdo vendimarrje, apo çaste paraprake të vendimarrjes”.

Mbi këtë bazë ajo tha se akademikët Ali Aliu dhe Sabri Hamiti mund të marrin pjesë në procesin e votimit për anëtarë të rregullt dhe të jashtëm, por nuk mund të marrin pjesë në procesin e votimit për anëtarë korrespondentë, si dhe në asnjë diskutim eventual që mund të bëhet për pranimin e anëtarëve korrespondentë. Kur fillon procesi i votimit për anëtarë korrespondentë, ata duhet ta lëshojnë sallën.

Ajo vazhdoi duke thënë se:

“Së pari votohet për anëtarë të rregullt, pastaj për anëtarë korrespondentë dhe në fund për anëtarë të jashtëm.

Jua rikujtoj se në bazë të Statutit të Akademisë, neni 24 dhe në bazë të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, neni 14:

-Anëtari i rregullt i Akademisë zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Akademisë. Akademia ka 19 anëtarë të rregullt (pa R. Qosjen) kuorumi për këtë mbledhje është 10 anëtarë të rregullt të Akademisë, pra anëtar i rregullt i Akademisë zgjidhet kandidati që merr 10 vota.

-Anëtari korrespondent i Akademisë zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë. Akademia ka 33 anëtarë të rregullt dhe korrespondentë (pa R. Qosjen), pra anëtar korrespondent i Akademisë zgjidhet kandidati që merr 17 vota.

- Anëtar i jashtëm i Akademisë zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë, pra në këtë rast zgjidhet po ashtu kandidati që merr 17 vota.

Më lejoni t’ju njoftoj se në fletëvotim kandidatët për anëtarë të rregullt dhe për anëtarë korrespondentë renditen sipas seksioneve dhe më pas renditen sipas numrit të votave të fituara në Seksionin përkatës.

Kandidatët për anëtarë të jashtëm renditen në fletëvotim sipas abc-së.

Votimi bëhet duke rrethuar numrin rendor para emrit të kandidatit”.

Në diskutimin e tij J. Bajraktari propozoi që disa anëtarë të Akademisë, që për arsye shëndetësore ka kohë që nuk marrin pjesë në mbledhje, të mos përfshihen në kuorum.

Kryetari Kraja edhe një herë kërkoi sqarime nga L. Pula.

L. Pula tha se bazuar në Statutin e ASHAK-ut, neni 29, paragrafi 14, Kuvendi mund të vendosë që të mos përfshihen në kuorum, anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes apo për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë, por për këtë duhet të marrë vendim Kuvendi.

Kryetari Kraja tha se nuk mund t’i largojmë nga kuorumi anëtarët e Akademisë, sepse për asnjërin prej tyre nuk kemi konfirmim me shkrim që nuk marrin pjesë në mbledhje. Të gjithë nga ata i kanë marrë materialet e mbledhjes dhe nuk kanë deklaruar asgjë.

Pas këtyre diskutimeve me pajtimin e Kuvendit u shpërndanë fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt.

R. Dhomi propozoi që të kryhen tri radhët e votimeve (për anëtarë të rregullt, korrespondentë dhe të jashtëm) dhe në fund të shpallen rezultatet. Propozimi u miratua.

Së pari u votua për anëtarët e rregullt. Gjatë këtij votimi anëtarët korrespondentë e lëshuan sallën.

Pas votimit u mblodh Komisioni i zgjedhjeve, i numëroi votat dhe e hartoi raportin.

Së dyti u votua për anëtarët korrespondentë. Gjatë këtij votimi, A. Aliu dhe S. Hamiti e lëshuan sallën.

Pas votimit u mblodh Komisioni i zgjedhjeve, i numëroi votat dhe e hartoi raportin.

Së treti u votua për anëtarët e jashtëm. Pas votimit u mblodh Komisioni i zgjedhjeve, i numëroi votat dhe e hartoi raportin.

Pas përfundimit të votimit, J. Bajraktari, kryesues i Komisionit e njoftoi Kuvendin me rezultatet e votimeve, si në vijim:

Për anëtarë të rregullt:

1. Kanë votuar 16 anëtarë të ASHAK-ut.
2. Fletëvotime të vlefshme 14.
3. Fletëvotime të pavlefshme 2.

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Nysret KRASNIQI 9 vota.
2. Bardh RUGOVA 11 vota.
3. Mehmet HALIMI 5 vota.
4. Shkumbin MUNISHI 11 vota.

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Arsim BAJRAMI 12 vota.

2. Besnik KRASNIQI 12 vota.
3. Frashër DEMAJ 11 vota.
4. Gjyljeta MUSHKOLAJ 7 vota.

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Arsim MORINA 10 vota.
2. Fetah PODVORICA 7 vota.
3. Myzafere LIMANI 4 vota.
4. Salih GASHI 10 vota.
5. Qamil HAXHIBEQIRI 8 vota.

IV. Seksioni i Arteve

1. Xhevdet XHAFA 11 vota.

Komisioni në bazë të rezultatit të votimit i shpalli para Kuvendit të Akademisë emrat e kandidatëve që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave dhe në këtë mënyrë janë zgjedhur anëtarë të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi.

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore: Arsim Bajrami, Besnik Krasniqi dhe Frashër Demaj.

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës: Arsim Morina dhe Salih Gashi.

IV. Seksioni i Arteve:

Xhevdet Xhafa.

Për anëtarë korrespondentë:

1. Kanë votuar 27 anëtarë të ASHAK-ut.
2. Fletëvotime të vlefshme 26.
3. Fletëvotime të pavlefshme 1.

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

I. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Muhamet MALA 24 vota.

II. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Bajram BERISHA 10 vota.
2. Enver HAMITI 19 vota.

III. Seksioni i Arteve

1. Ismet JONUZI 25 vota.
2. Valton BEQIRI 8 vota.
3. Zake PRELVUKAJ 19 vota.

Komisioni në bazë të rezultatit të votimit i shpall para Kuvendit të Akademisë emrat e kandidatëve që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave dhe në këtë mënyrë janë zgjedhur anëtarë korrespondentë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

I. Seksioni i Shkencave Shoqërore:
Muhamet Mala.

II. Seksioni i Shkencave të Natyrës:
Enver Hamiti.

III. Seksioni i Arteve: Ismet Jonuzi dhe Zake Prelvukaj.

Për anëtarë të jashtëm:

1. Kanë votuar 27 anëtarë të ASHAK-ut.
2. Fletëvotime të vlefshme 16.
3. Fletëvotime të pavlefshme 11.

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Arben MERKOÇI 15 vota.

2. Jorgaq KAÇANI 16 vota.

Sipas rezultatit asnjëri nga kandidatët nuk kanë marrë numrin e nevojshëm për t'u zgjedhur anëtarë të jashtëm të ASHAK-ut.

Në fund të mbledhjes kryetari Kraja uroi anëtarët e zgjedhur dhe e ftoi Kuvendin e administratën në drekë me rastin e mbajtjes së Kuvendit zgjedhor dhe me rastin e festave të fundvitit.

KRYESIA

Gjatë vitit 2024 Kryesia e Akademisë ka organizuar këto aktivitete:

- Në mjediset e Akademisë, më 25 mars 2024, në 25-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s, u hap ekspozita e botimeve për Kosovën në gjuhë të huaj: *Kosova në gjuhët e botës*.

- Më 10 qershor 2024, në organizim të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në Prishtinë, u mbajt konferenca shkencore: *25-vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekull shtetndërtim, arritje dhe sfida – qasje multidisiplinare*.

- Po më 10 qershor në mbrëmje, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) mbajti koncert festiv për nder të *25-vjetorit të Ditës së Çlirimit të Kosovës*.

Kryesia e Akademisë gjatë vitit 2024 ka mbajtur 22 mbledhje (XLVIII-LXIX) në të cilat është marrë me shqyrtimin e çështjeve, duke u bazuar në kompetencat e parapara me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

I. Kryesia në mbledhjen e parë të vitit 2024 (XLVIII), diskutoi për parapërgatitjet për thirrjen e seancës zgjedhore për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut. Kryetari Kraja tha se është mirë të procedojmë me përgatitje. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë dhe u tha që sekretarja e Akademisë të përgatitë një propozim-agjendë dhe më pas Kryesia të vendosë për më tutje.

Më pas u diskutua dinamika e dorëzimit të dorëshkrimeve të vitit 2023. M. Kraja tha se duhet të shpejtojmë me dorëzimin dhe shtypjen e botimeve, ashtu që të mbyllim kontratën ekzistuese dhe të shpallim tenderin për vitin 2024, sepse ka dorëshkrime të parapara me programin e punës për vitin 2024, e që shumë prej tyre janë të gatshme.

Kryesia në vazhdim:

- E shqyrtoi draftin e memorandumit të bashkëpunimit në mes të ASHAK-ut dhe Universitetit të Prishtinës dhe e miratoi atë me një plotësim të paragrafi 11 duke hequr fjalinë: " si anëtarë të komisioneve vlerësuese në konkurse për përzgjedhje të stafit akademik". U tha që drafti të rregullohet teknikisht dhe t'i dërgohet Rektorit. Më pas vendoset për kohën dhe vendin e nënshkrimit.

- Diskutoi për mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve të ASHAK-ut për hartimin e raporteve të punës për vitin 2023. U tha që edhe për këto mbledhje, sekretarja e ASHAK-ut të përgatitë propozim-agjendën dhe më pas Kryesia vendos për më tutje.

- Diskutoi për çështjen e pamundësisë së funksionimit të Seksionit të Arteve. Ai tha se këtë vit i kemi zgjedhjet për

anëtarë të Akademisë dhe me këto akte normative që i kemi në fuqi nuk ka mundësi që SA të mbajë mbledhje për zgjedhje. Ai propozoi të caktohet një grup punues i cili do të hartojë propozime për plotësimin e Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë dhe plotësimin eventual të Statutit. Ai në vazhdim propozoi përbërjen e grupit punues, si në vijim: anëtar korrespondent Arsim Bajrami, kryesues dhe akademik Eqrem Basha, anëtare korrespondente Myzafer Limani, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj dhe Lendita Pula, anëtare të grupit.

Propozimi u miratua nga anëtarët e pranishëm, me përjashtim të S. Hamitit, i cili abstenoj.

Më pas kryetari Kraja njoftoi se Seksioni i Arteve është jofunksional, sepse U.D. Sekretarit i ka kaluar mandati dhe nuk ka kushte për zgjedhjen e U.D. Sekretarit të ri. Ai tha se kompetencat tani për tani i kalojnë Kryesisë. Me këtë konstatim u pajtuan të gjithë anëtarët e Kryesisë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- a) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të akademik Fejzullah Krasniqi për qëndrimin e tij në Tiranë, më 20-22 dhjetor 2023, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën ndërkombëtare: *Sfidat e ngrohjes së ndërtesave të banimit në zhvillimin e qëndrueshëm*, që u mbajt në ASHSH, si dhe raportin e udhëtimit zyrtar të stafit të administratës së ASHAK-ut, më 26-28 dhjetor 2023, me qëllim të realizimit të takimit të përbashkët në ASHSH, me zyrtarë të administratës;

b) Vendosi që z. Hilmi Zogjani, drejtor i Bibliotekës dhe Arkivit dhe z. Bedri Pllana, bibliotekar, me rastin e pensionimit t'u blihet nga një orë dore;

c) Mori vendimi për shpalljen e konkurseve për: Zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore dhe Zyrtar për transport;

e) U njoftua nga L. Pula për ndarjet buxhetore për vitin 2024 dhe e miratoi dokumentin e përgatitur nga Departamenti i Buxhetit dhe Financave të ASHAK-ut;

f) U njoftua nga L. Pula për marrëveshjen me Policinë e Kosovës. Ajo tha se më 29 dhjetor 2023 e ka njoftuar Kryesinë me email, por tani për korrektësi po e njofton edhe një herë në mbledhje;

g) E shqyrtoi kërkesën e SSHSH, për përkthimin dhe botimin në gjuhën angleze të librit: *Gjenocidi dhe masakrat serbe në Kosovë (1998-1999)*.

S. Hamiti në diskutimin e tij shtroi pyetjen se, nëse ndodh që edhe nga seksionet e tjera paraqiten kërkesa të tilla, a miratohen si kjo?!

Kryetari Kraja tha se si gjithnjë do të gjejmë forma dhe do t'i miratojmë edhe kërkesat e tjera të kësaj natyre. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe kërkesa u miratua nga të gjithë, me përjashtim të S. Hamitit, i cili abstenoj. Kryesia pas miratimit të kërkesës në fjalë vendosi që Znj. Arbenita Morina të caktohet përkthyes e dorëshkrimit nga gjuha shqipe në gjuhën angleze; Përgatitësi i botimit në shqipe, Frashër Demaj do t'i kryejë të gjitha punët për përgatitjen e botimit në gjuhën angleze;

h) Diskutoi për vlerësimin e punës së sekretares së Akademisë. Diskutuan të

gjithë anëtarët e pranishëm dhe të gjithë u shprehën që vlerësimi të jetë maksimal (shkëlqyeshëm), sepse sekretarja i ka kryer detyrat e saj me përkushtim, përgjegjësi dhe me kohë.

II. Në mbledhjen e mbajtur më 27 janar (XLIX), Kryesia u mor me organizimin e ceremonisë së varrimit të akademik Feriz Krasniqit dhe vendosi që gjatë homazheve të angazhohen tre interpretë: Gentian Aliu, Shkodran Aliu dhe Edrit Mala.

III. Mbledhja e radhës e Kryesisë (L) u mbajt më 1 shkurt. Në këtë mbledhje Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen CXIII të Kuvendit të Akademisë, më 28 shkurt 2024, me këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CXII të Kuvendit të Akademisë; Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2023; Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2023 dhe çështje vijuese.

Në vazhdim u miratua agjenda për aktivitetet parazgjedhore për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut, si në vijim:

AGJENDA E AKTIVITETEVE PËR ZGJEDHJEN E SEKRETARIT SHKENCOR TË ASHAK -ut

1. Mbledhja e Kryesisë së Akademisë, në të cilën thirret seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të Akademisë (së paku 30 ditë para mbajtjes së saj) u mbajt më 01.02.2024, ora 11:00;

2. Seanca zgjedhore e Kuvendit do të mbahet më 07.03.2024, ora 11:00

3. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI I

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 07.02.2024, ora 11:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 07.02.2024, ora 13:00;

III. Seksioni Shkencave të Natyrës, më 08.02.2024, ora 11:00;

IV. Seksioni Arteve, nuk ka kushte për mbajtjen e mbledhjes.

3. Mbledhja e Kryesisë – në të cilën Kryesia njoftohet me pasqyrën (rezultatet) e votimit I dhe atë ua dërgon seksioneve për votim II (përfundimtar). Kjo mbledhje e Kryesisë propozohet të mbahet më 13.02.2024, ora 11:00.

4. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI II (përfundimtar):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 20.02.2024, ora 11:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 20.02.2024 ora 13:00;

III. Seksioni Shkencave të Natyrës, më 21.02.2024, ora 11:00;

IV. Seksioni Arteve, nuk ka kushte për mbajtjen e mbledhjes.

VËREJTJE: Propozimet përfundimtare i dërgohen Kryesisë, së paku 15 ditë para seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë”.

Pas miratimit të agjendës Kryesia vendosi ta thërrasë seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e Sekretarit shkencor, më 7 mars 2024, me këtë rend të ditës: Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen

e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut; Votimi për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut dhe shpallja e rezultateve të votimit dhe çështje vijuese.

Në kuadër të pikë së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) E shqyrtoi kërkesën e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami për të marrë pjesë në takimin e EASA, në Salzburg dhe vendosi njëzëri që kërkesa të refuzohet me arsyetimin se ASHAK-u nuk ka marrëveshje ndër-institucionale me EASA, dhe se anëtarësimet e anëtarëve të ASHAK-ut atje janë individuale, sikundër edhe angazhimi i tij në organet e EASA-s;

b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të grupit punues për hartimin e dokumenteve për themelimin e Akademisë së të rinjve, në Tiranë më 21-23 janar;

c) E shqyrtoi kërkesën e Xhemshit Brajshorit për ndërrimin e zyrës. Kërkesa u refuzua dhe u tha që në zyrën nr. 402 deri në pranimin e drejtorit të ri të kalojë zyrtarja e arkivit;

d) U njoftua nga kryetari Kraja, se ditë më parë ai i ka dërguar një shkresë ministrit të MKRS-së, z. Hajrullah Çeku, në të cilën ka kërkuar që viti 2024 të shpallet viti i Shtjefën Gjeçovit dhe e ka njoftuar se ASHAK-u është i gatshëm të bashkëpunojë, meqë e ka përfshirë në programin e punës së saj mbajtjen e konferencës shkencore: *Për krijimtarinë e Shtjefën Gjeçovit*;

e) U njoftua nga kryetari Kraja se më 25 mars në ASHAK do të hapet ekspozita me botimet e huaja për Kosovën dhe një koncert për shënimin e 25-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Më pas, më 10 qershor do

të organizohet konferenca shkencore, në kuadër të së cilës për mysafirët do të mbahet një koncert me dirigjentin nga Tirana Eno Koço dhe grupin e tij.

IV. Më 13 shkurt u mbajt mbledhja e radhës (LI) e Kryesisë. Në këtë mbledhje:

- U shqyrtua raporti i punës të ASHAK-ut për vitin 2023. Kryetari Kraja tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta në të cilat i kanë shqyrtuar dhe miratuar raportet e punës së tyre për vitin 2023. Tani e kemi raportin përmbledhës në të cilin është paraqitur edhe puna e Kryesisë dhe e Kuvendit të Akademisë. Ai e hapi diskutimin dhe meqë diskutime nuk pati, Kryesia njëzëri e miratoi raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2023. Raporti është pjesë përbërëse e procesverbalit.

- U shqyrtua raporti financiar i ASHAK-ut për vitin 2023. Raporti u miratua njëzëri pa vërejtje.

- Kryesia u njoftua me propozimet e seksioneve për kandidatin për Sekretar shkencor të ASHAK-ut. L. Pula me kërkesë të Kryetarit njoftoi se SGJL ka propozuar anëtar korrespondent Bardh Rugovën, SSHSH ka propozuar anëtar korrespondent Frashër Demajn dhe SSHN ka propozuar akademik Fejzullah Krasniqin.

- U shqyrtua drafti i plotësimit të Statutit dhe Drafti i plotësimit të rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, të hartuara nga grupi punues i caktuar nga Kryesia e Akademisë.

Kryesia njëzëri u pajtua vetëm me plotësimet që kanë të bëjnë me funksionalizimin e Seksionit të Arteve, ndërsa ndryshimet në Statut për

procedurën e votimit të anëtarëve të rinj në Kuvend nuk u miratuan.

U tha që drafti i plotësimit të Statutit dhe drafti i plotësimit të Rregullores t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Akademisë në fillim të muajit mars (meqë tani janë dy kuvende dhe të mos ngarkohen anëtarët e Akademisë) dhe më pas t'u bëhet me dije të gjithë anëtarëve të Akademisë se vërejtjet dhe propozimet eventuale t'ia dërgojnë grupit punues. U tha që sekretarët e seksioneve të vendosin vetë secili që këto drafte t'i diskutojnë nëpër seksione.

- U diskutua për çështjen e ndarjes së zyrave për anëtarët e Akademisë, ato që janë të lira. Diskutuan S. Hamiti e J. Sh. Pula dhe pas diskutimeve u tha që kjo çështje të shtyhet për vendimmarrje në një mbledhje tjetër të Kryesisë.

V. Në mbledhjen (LII) që u mbajt më 27 shkurt, Kryesia e shqyrtoi propozimin e Këshillit të projektit *Enciklopedia Shqiptare* për caktimin e vlerës së pagesave për të angazhuarit në projekt, për vitin 2024. S. Hamiti në diskutimin e tij tha se pozita e sekretarit të Redaksisë vendore/qendrore duhet të rangohet te redaksia vendore, me vlerë 35%, sepse puna dhe përgjegjësia e kësaj pozite është e lartë. Kryesia njëzëri u pajtua me propozimin në fjalë.

Në vazhdim u diskutua për caktimin e vlerës së pagesës për anëtarët e Këshillit të projektit *Enciklopedia Shqiptare* për vitin 2024. Kryesia njëzëri u pajtua që pagesa për anëtarët e Këshillit të ESH, të jetë në masën 22 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 249.70€ bruto.

Pas pajtimit me propozimin e Këshillit të ESH dhe shqyrtimit dhe pajtimit për shkallën e pagesës për anëtarët e Këshillit të ESH, Kryesia bazuar në aktet normative përkatëse mori vendim:

“I. Caktohet vlera e pagesave për të angazhuarit në projektin *Enciklopedia Shqiptare*, si në vijim:

1. Zëvendëskryeredaktor në Redaksinë qendrore/ Kryeredaktor në Redaksinë vendore, në masën 50 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 567.50€ bruto.
2. Anëtar në Redaksinë qendrore (4 anëtarë) në masën 40 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitetit, apo 454.00€ bruto.
3. Anëtar në Redaksinë vendore (4 anëtarë) në masën 35 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 397.25€ bruto.
4. Anëtar i Këshillit të ESH (5 anëtarë), në masën 22 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 249.70€ bruto.
5. Redaktor përgjegjës në redaksinë e fushës (25 redaktorë përgjegjës) në masën 30 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 340.50€ bruto.
5. Anëtar në redaksinë e fushës në masën 22 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 249.70€ bruto.
6. Sekretari i Redaksisë vendore/ qendrore në masën 35 për qind të pagës neto të profesorit të rregullt në universitet, apo 397.25€ bruto”.

Më pas Kryesia diskutoi për disa çështje për veprimtarinë botuese të ASHAK-ut. Kryetari Kraja njoftoi se kontrata për shtypjen e botimeve nuk po mund të

përmbillet për shkak të vonesave në dorëzimin e dorëshkrimeve dhe propozoi që të bëhen disa zëvendësime, ashtu që të shtypen dorëshkrimet që janë të gatshme, të përmbillet kontrata aktuale dhe të fillojnë procedurat për shpalljen e tenderit të ri. Kjo për arsye se tenderi merr kohë, ndërsa ka dorëshkrime të gatshme që presin të shkojnë në shtyp. Ai tha se zëvendësimet mund të bëhen vetëm aty ku përputhen specifikat e përcaktuara.

Kryesia u pajtua njëzëri me propozimin e Kryetarit, përveç S. Hamitit i cili ishte kundër.

Më pas u mor ky vendim:

“I. Të bëhet zëvendësimi për botimin e dorëshkrimeve, si në vijim:

a) Në pozicionin e librit të Myzafere Limanit: *Akustika, të folurit dhe muzika* të shtypet libri i Isuf Krasniqit dhe Avni Alidemajt *Ndërprerësit e tensionit të lartë (110, 220 dhe 400) kV me gaz SF6 – proceset tranzitore*;

b) Në pozicionin e librit: *Këshilli ndërakademik për gjuhën shqipe*, të shtypet në gjuhën angleze libri *Gjenocidi dhe masakrat serbe në Kosovë (1998-1999)*;

c) Në pozicionin e librit të Isuf Krasniqi dhe Avni Alidemajt: *Ndërprerësit e tensionit të lartë (110, 220 dhe 400) kV me gaz SF6 – proceset tranzitore*, të shtypet libri i Hivzi Islamit dhe Prof.dr. Arsim Ejupit: *Gjeopolitika, territori konflikti - Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve*.

Në fund Kryesia:

a) Diskutoi për mbajtjen e konferencës për 25-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s

dhe çlirimit të Kosovës. Gj. Mushkolaj tha se u ka dërguar ftesa preliminare shumë personave të shquar që kanë dhënë kontribut për këtë çështje;

b) Vendosi që në mbledhjen e radhës të ALLEA-s, ASHAK-un ta përfaqësojë Gj. Mushkolaj;

c) Vendosi që S. Hamitit t'i ndahet zyra 210.

VI. Në mbledhjen (LIII) e mbajtur më 12 mars, Kryesia e shqyrtoi kornizën afatmesme të shpenzimeve- KASH 2025-2027. Dokumenti u miratua njëzëri nga Kryesia dhe u tha që do t'i dërgohet DBF-së për procedim të mëtejshëm.

Në vazhdim Kryesia diskutoi për caktimin e ushtruesit të detyrës të Sekretarit shkencor të ASHAK-ut, për periudhën gjashtëmujore. Kryetari Kraja tha se sot duhet të propozojmë një kandidat dhe ashtu siç është thënë në mbledhjen e fundit të Kuvendit të ASHAK-ut, do të fillohet me rend sipas seksioneve. Ai tha se tre kandidatët e propozuar të cilët nuk morën besimin e Kuvendit, nuk është mirë të propozohen, sepse Akademia u përket të gjithëve e jo vetëm një seksioni. Kryetari Kraja propozoi për u.d. Sekretar shkencor, anëtarin korrespondent Nysret Krasniqin. Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë. F. Podvorica tha se pajtohet me propozimin, por se nuk e ka të qartë procedurën e propozimit të Sekretarit shkencor, pra variantin e dalë nga Kuvendi. J. Sh. Pula shprehu dilemën e bazës ligjore. Ajo tha se në Statut shkruan mungesë e përkohshme dhe shtroi pyetjen se a është kjo mungesë e përkohshme. Kryetari Kraja tha se ushtruesin e detyrës do të caktojme për periudhë gjashtëmujore dhe i bie

që secili që caktohet ka një kufizim, tjetër zgjidhje tani për tani nuk kemi, nuk mund të thërrasim në këtë periudhë Kuvend zgjedhor, sepse kemi shumë aktivitete deri në qershor. Ai shtoi se më pas mund të vendosim në Kryesi që të thërrasim Kuvend zgjedhor. Gj. Mushkolaj tha se kufizimi që ata që nuk kanë mundur të zgjidhen në Kuvend tani të mos propozohen, mund të sjellë mospajtim në Seksionin e SHSH-së, por kryetari Kraja dhe S. Hamiti u shprehën se Akademia është e të gjithëve, anëtarët e saj kanë obligim statutar të zgjidhen dhe se seksionet duhet të reflektojnë që të bëhet zgjidhje e mirë dhe e pranueshme për të gjithë.

Më pas Kryesia njëzëri vendosi që anëtar korrespondent Nysret Krasniqi caktohet u.d. Sekretar shkencor i ASHAK-ut, për periudhën 1 prill deri më 30 shtator 2024. Atij i takon shtesa funksionale dhe shpenzimet e telefonisë mobile gjatë kësaj periudhe.

Kryesia në këtë mbledhje caktoi kuratorin dhe punëtorin teknik për kryerjen e punëve për përgatitjen e ekspozitës: *Kosova në gjuhët e botës - Ekspozitë e botimeve për Kosovën në gjuhë të huaja*, si në vijim: Z. Hilmi Zogjani, kurator dhe z. Skënder Xhukolli punëtor teknik.

Po ashtu u caktuan edhe interpretët që do të marrin pjesë në programin muzikor në kuadër të ekspozitës: znj.Syzana Jakupi, piano dhe znj. Alba Muçolli Dehiri, piano.

Në vazhdim Kryesia u njoftua nga kryetari Kraja se më 23-25 prill në Tiranë, në mjediset e ASHSH-së, do të mbahet *Panair mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor*, edicioni III dhe se të gjitha seksionet e ASHAK-ut do të

promovojnë nga dy botime të veta. S. Hamiti dhe F. Podvorica i paraqitën titujt e botimeve që do të promovohen, ndërsa Gj. Mushkolaj tha se do t'i paraqesë ditëve në vijim. Kryetari Kraja propozoi që nga SSHSH mund të paraqitet për promovim botimi i fundit i akademik Hivzi Islamit, meqë është libër autorial, por Gj. Mushkolaj tha se do ta bisedojë edhe një herë me anëtarët e Seksionit dhe do të njoftojë më pas.

Në fund u evidentuan titujt e botimeve që do të promovohen në panair, si në vijim:

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. *Kënga e cjamin*-Drama klasike shqipe, i autorit, akademik Kujtim Shala;

2. *Shqipja standarde sot*. – Materialet e Konferencës shkencore.

Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1 *Proceset dhe ciklet termodinamike*, i autorëve: akademik Fejzullah Krasniqi dhe prof.dr. Naser Sahiti.

2. *Proceset konvencionale membranore dhe të integruara (parimet dhe zbatimi)*, i autorit anëtar korrespondent Salih Gashi.

Në vazhdim të mbledhjes L. Pula me kërkesë të kryetarit njoftoi se ka përfunduar procedura e rekrutimit për pranimin e zyrtarit për transport dhe pasi të kalojë afati ligjor i ankesave, zyrтари fillon punën më 5 prill. Për pozitën tjetër zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore, procedura e rekrutimit është në proces. Më pas ajo propozoi që të bëhen disa ndryshime nëpër zyra ashtu që të sistemohen zyrtarët e rinj, si në vijim:

- Në zyrën nr. 107 të kalojë znj. Hasime Maliqi e cila do të jetë bashkë me znj. Vjollca Hykolli;

- Në zyrën 107 të sistemohet zyrтари për zotimin e mjeteve buxhetore, që do të jetë bashkë me znj. Lirijeta Bunjaku.

- Në zyrën nr. 111 të sistemohet zyrтари i ri për transport;

- Në zyrën nr. 401 të kalojë z. Alban Bytyqi.

Propozimi u miratua nga Kryesia edhe pse u tha që çështjet e tilla janë kompetencë e sekretares së Akademisë.

Në fund, Kryesia:

a) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të akademik Sabri Hamitit dhe anëtar korrespondent Nysret Krasniqit, për qëndrimin e tyre në Tiranë, më 1-2 mars, për konsultime dhe bashkëpunim për projektin *Historia e letërsisë shqipe*;

b) E miratoi kërkesën e SGJL-së për blerjen e biletës së aeroplanit për Prof. Matteo Mandala, që do të vijë në Prishtinë nga Italia, për pjesëmarrje në tryezën shkencore: *Në 90- vjetorin e lindjes së akademik Ali Aliut*;

c) E miratoi kërkesën e SSHN –së për blerjen e tri biletave të aeroplanit për të ftuarit nga jashtë që do të vijnë në Prishtinë, për pjesëmarrje në konferencën shkencore: Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura; U tha që F. Podvorica të paraqesë emrat e personave dhe destinacionet prej nga vijnë;

d) U njoftua nga L. Pula se gjatë marsit dhe prillit do të ketë shumë aktivitete dhe se të gjithë anëtarët e Kryesisë do të njoftohen me email nga znj. Dafina Kavaja me orarin e aktiviteteve.

VII. Mbledhja LIV e Kryesisë u mbajt më 26 mars. Në këtë mbledhje Kryesia diskutoi për ngritjen e strukturës së veçantë që ngarkohet për kryerjen e punëve të projektit *Enciklopedia Shqiptare*, në përputhje me aktet normative të projektit në fjalë dhe caktimi i vlerës së pagesave për ta. Kryetari Kraja njoftoi se nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë ndarë mjetet në kategorinë paga dhe shtesa për realizimin e pagesave për strukturën e veçantë të projektit. Ai tha se pjesë e kësaj strukture do të jenë i gjithë stafi i administratës, përveç Xhemshit Brajshorit i cili, në takimin të cilin e ka realizuar nënkryetarja dhe sekretarja e Akademisë me të, ka refuzuar të merret me punët shtesë të projektit të *ESH-së*. Vendimi për ngritjen e strukturës së veçantë dhe vlera e pagesave për të u miratua njëzëri nga Kryesia.

U tha që pagesat bëhen për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2024 dhe mund të ndryshojnë varësisht nga efikasiteti i punës; Vlerat e pagesave janë mujore, ndërsa realizimi i tyre bëhet çdo tre muaj; Të lartpërmendurit hartojnë raporte të punës çdo tre muaj për redaksinë vendore dhe sekretarin e Redaksisë vendore/qendrore; Për vitin vijues struktura e veçantë dhe vlera e pagesave caktohen me vendim të ri, dhe se të lartpërmendurit do të kryejnë edhe punë të tjera që kërkojnë nga Redaksia vendore dhe Sekretari i Redaksisë vendore/qendrore”.

Në vazhdim Kryesia diskutoi për përgatitjet për nisjen e aktivitetit të prokurimit për shtypjen e botimeve të ASHAK-ut për vitin 2024. Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u caktuan mbledhjet e seksioneve për

paraqitjen e specifikave për shtypjen e dorëshkrimeve për vitin 2024:

- SGJL, më 29 mars, ora 11:00;
- SSHSH, më 3 prill. Ora 13:00
- SSHN, më 4 prill, ora 11:00.

U tha që pas përfundimit të kontratës ekzistuese të fillojnë procedurat për nisjen e aktivitetit të ri të prokurimit dhe për njësi kërkuese u propozua F. Podvorica, ndërsa për menaxher të kontratës u propozua Burim Rexhepi.

Kryesia në këtë mbledhje vendosi që z.Bajram Morina të caktohet avokat për përfaqësimin e ASHAK-ut, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për çështje civile, Lënda C.nr. 103/22, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Zyrove Përmbartimore, si dhe para çdo gjykate dhe organi tjetër shtetëror kompetent lidhur me zgjidhjen e kontestit me paditësin Hivzi Islami. Detyrat të caktohen me kontratë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- a) Vendosi që punonjësit Valon Dula, zyrtar për transport i takojnë mbushjet e telefonisë mobile nga data 1 prill 2024;
- b) Vendosi të blihen kompjuterët sipas mjeteve të planifikuara (5,000.00€) për vitin 2024;
- c) E miratoi raportin e takimit të Redaksisë qendrore të projektit *Enciklopedia Shqiptare*, mbajtur në Vërmicë, më 17 dhe 18 mars 2024;
- d) E miratoi kërkesën e akademik Rexhep Ismajlit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për në

Vjenë. Gj. Mushkolaj tha se është mirë që Kryesia i miraton kërkesat e anëtarëve të Akademisë për udhëtime të tilla, por propozoi që edhe anëtarët e tjerë të njoftohen me mundësinë e realizimit të takimeve në kuadër të Protokollit me Akademien e Austrisë. S. Hamiti reagoi dhe tha se të gjithë në Akademi janë në dijeni për Protokollin në fjalë, por akademik Ismajli ka paraqitur kërkesë me shkrim gjë që mund ta bëjnë edhe të tjerët që kanë interesim;

e) Mori vendim për shpalljen e konkursit për pozitën Asistent administrativ.

f) E miratoi listën për arkiv me afate të ruajtjes së dokumenteve të krijuara nga ASHAK-u. U tha që listën ta nënshkruajë sekretarja e Akademisë;

g) Diskutoi për çështjen e mjeteve financiare të planifikuara për shtypjen e botimeve të ASHAK-ut. U tha që janë paraqitur shumë dorëshkrime të cilat duhet të shtypen me ngjyra dhe se çmimi i tregut është rritur dukshëm, prandaj mund të ketë nevojë për shtimin e mjeteve financiare. Kryesia vendosi të shtohen mjetet, sepse shtypja e botimeve duhet të kryhet, ndërsa mjetet të merren aty ku ka mundësi.

Në fund J. Sh. Pula njoftoi se nga UAI ka ardhur një memorandum për ndryshimin e tarifave të pagesës së anëtarësisë. U tha që pagesa të realizohet sipas faturës përkatëse.

VIII. Mbledhja e radhës e Kryesisë (LV) u mbajt më 29 prill. Në këtë mbledhje kryetari Kraja njoftoi Kryesinë se Redaksia Vendore në mbledhjen e saj ka vendosur që Fetah Podvorica të caktohet anëtar i redaksisë vendore të

ESH, në vend të akademik Nexhat Dacit, ndërsa akademik Daci të caktohet anëtar i Këshillit të ESH-së. Ai po ashtu njoftoi se janë bërë edhe disa ndryshime në redaksitë e fushave. Propozimet u miratuan edhe nga Kryesia. Marrë parasysh këto ndryshime u tha që për personat që fillojnë angazhimin në projektin e ESH-së pas muajit mars hartohen kontratat përkatëse për periudhën kur fillon angazhimi e deri më 31 dhjetor 2024. Për ndryshimet që bëhen në strukturën redaksionale hartohen kontratat e reja dhe shfuqizohen kontratat ekzistuese.

Më pas Kryesia:

- Mori vendim që z. Hilmi Zogjani të caktohet bashkëpunëtor për realizimin (vazhdimin) e projektit: *Kosova në gjuhët e botës* dhe detyrat e punës së tij të specifikohen në marrëveshjen përkatëse e cila do të lidhet për periudhën gjashtëmujore, 1 maj-31 tetor 2024, me mundësi të vazhdimit, varësisht nga punët që do të realizohen për periudhën e lartcekur. U vendos po ashtu që z. Zogjani t'i realizohet pagesa, pas kryerjes së punës dhe pas miratimit të raportit të punës së tij nga Kryesia.

- Mori vendim të shpallen konkurset për dy pozita të reja: drejtor i bibliotekës dhe arkivit dhe zyrtar i lartë i personelit. Konkursët shpallen në përputhje me mjetet buxhetore në kategorinë paga dhe shtesa.

Dhe në fund, Kryesia:

a) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Kryetarit të Akademisë me bashkëpunëtorë, për qëndrimin në Tiranë, më 13-14 mars 2024;

b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtares korrespondente

Gjyljeta Mushkolaj për qëndrimin në Berlin, më 19-22 mars 2024;

c) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Akademisë dhe zyrtarëve të Administratës, për qëndrimin në Tiranë në Panairin e librit akademik dhe shkencor, më 22-26 prill 2024;

d) Diskutoi për çështjen e darkave pritëse me rastin e mbajtjes së aktiviteteve shkencore e artistike. Kryetari Kraja tha se kjo çështje tani më është zgjidhur, nuk ka darka pritëse. Kjo për arsye se shumica e mysafirëve janë nga Tirana dhe pjesëmarrësve tanë atje nuk iu shtrohet darkë pritëse, prandaj duhet të sillemi njëjtë;

e) Diskutoi për rregullimin e veturës së ASHAK-Peugeot. U tha që vetura është dëmtuar dhe duhet të rregullohet në tërësi. Nëse mjetet e planifikuara nuk mjaftojnë të bëhet zgjidhje duke marrë mjetet në ndonjë kategori tjetër;

f) E propozoi E. Bashën dhe M. Limanin për anëtar të Komisionit të vlerësimit për tenderin shtypja e botimeve 2024 të ASHAK-ut. U Tha që anëtari i tretë të caktohet nga administrata.

Në këtë mbledhje u diskutua edhe çështja e bashkëpunimit ndërkombëtar të ASHAK-ut. Kryetari Kraja tha se kanë ardhur disa ftesa dhe kërkoi që ato t'i shqyrtojë Këshilli. J. Sh. Pula tha se do të provojë edhe kësaj radhe ta mbledhë Këshillin dhe nëse prapë disa anëtarë nuk vijnë në mbledhjen e radhës së Kryesisë, do të kërkojë ndryshimin e përbërjes së Këshillit, përkatësisht caktimin e anëtarëve të rinj.

IX. Në mbledhjen (LVI) e mbajtur më 31 maj, Kryesia e shqyrtoi kërkesën e

akademik Vasil Tole për përfshirjen e dorëshkrimit të tij: *Partiturë e koncertit për violinë dhe orkestër*, në programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2025. U tha që Kryesia nuk ka kompetencë të marrë vendim për këtë çështje, sepse i përket Seksionit të Arteve. Seksioni i Arteve nuk është funksional. Me ndryshimet që pritet të bëhen në Statut dhe Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, pritet që do të bëhet zgjidhje për funksionalizimin e SA. Pasi të kryhen këto procedura kërkesa shqyrtohet.

Kryesia e shqyrtoi edhe kërkesën e profesor Esat Vallës për përfshirjen e dorëshkrimit të tij: *Esat Valla-monografi*, në programin e punës të ASHAK-ut për vitin 2025. Edhe për këtë kërkesë u tha që do të trajtohet pas funksionalizimit të Seksionit të Arteve.

Në vazhdim Kryesia e shqyrtoi programin punës të ASHAK-ut për vitin 2025. Kryetari Kraja tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta dhe i kanë miratuar programet e punës së tyre. Tani rendi është të shqyrtohet edhe nga Kryesia. Nuk pati vërejtje dhe programi i punës u miratua pa vërejtje dhe si i tillë do t'i dërgohet për miratim përfundimtar Kuvendit të Akademisë.

Programi i punës për vitin 2025 paraqitet në këtë Vjetar- 2024.

Më pas Kryesia:

- Vendosi ta thërrasë mbledhjen CXV të Kuvendit të Akademisë, më 18 qershor 2024 dhe miratoi këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve CXIII dhe CXIV të Kuvendit të Akademisë; Shqyrtimi dhe miratimi i programit të punës të ASHAK për vitin 2025; Shqyrtimi dhe miratimi i

plotësimit të Statutit të ASHAK-ut dhe Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë; Çështje vijuese.

- E shqyrtoi propozimin për ndarjen e buxhetit sipas Qarkores I buxhetore 2025/01. Propozimi u miratua me një ndryshim:

Në kodin 13510 mbesin 1,000.00, ndërsa 3,500.00€ kalojnë te kodi 14220.

- E shqyrtoi kërkesën e akademike Justina Sh. Pula për çështjen e Këshillit për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Kryetari Kraja tha se J. Sh. Pula ka bërë një propozim, por njëri nga anëtarët e propozuar (akademik Fejzullah Krasniqi) ka hequr dorë. Ai e propozoi anëtare korrespondente Myzafer Limanin për anëtare të Këshillit. Propozimi u miratua dhe Kryesia e caktoi Këshillin e ri me këtë përbërje:

1. Akademike Justina Sh. Pula, kryesuese;
2. Akademik Eqrem Basha, anëtar;
3. Anëtare korrespondente Myzafer Limani, anëtare;
4. Anëtar korrespondent Besnik Krasniqi, sekretar;
5. Akademik Rauf Dhomi, anëtar.

- Vendosi të mbahet koncerti festiv për nder të 25-vjetorit të ditës së çlirimit të Kosovës në të cilin do të performojë ansambli muzikor Academia Albanica. Koncerti do të mbahet më 10 qershor, ora 19:00, në mjediset e ASHAK-ut.

- Vendosi që znj. Rejhane Islami, Zyrtare e lartë për bibliografi dhe hulumtim shkencor të caktohet u. d. i Drejtorit të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit- DBA; E

lartpërmendura caktohet u.d. drejtor i DBA për periudhën gjashtëmuajore, 1 qershor 2024-31 dhjetor 2024; Ushtrimi i detyrave dhe i përgjegjësive nga ana e ushtruesit të detyrës bëhet në përputhje me detyrat e pozitës së drejtorit të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit.

Obligohet Departamenti për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi sipas Ligjit të Pagave.

Caktimi i u.d.bëhet për shkak të pamundësisë së shpalljes së konkursit, meqë mungojnë mjetet financiare.

Në fund Kryesia:

a) U njoftua nga L. Pula për ndryshimet në Rregulloren e re të organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASHAK dhe përshkrimin e vendeve të punës. U vendos që Rregullorja të plotësohet sipas kërkesave që dalin nga Rregullorja e re për përshkrimin e vendeve të punës;

b) U njoftua nga L. Pula me rekomandimet e auditorit të brendshëm. Ajo njoftoi se auditori i brendshëm ka bërë rekomandim për çështjen e përfshirjes së shpërblimeve të anëtarëve të Akademisë te kategoria subvencione dhe transfere dhe tha se Ministrisë së Financave duhet t'i dërgohet një kërkesë që të merren me çështjen në fjalë. U tha që të veprohet sipas rekomandimit të auditorit të brendshëm;

c) Vendosi të organizojë ekspozitën me vepra të artit pamor të autorit Fatmir Krypa. Kurator i ekspozitës u caktua akademik Eqrem Basha, dizajner z. Zeni Ballazhi dhe fotograf z. Enver Bylykbashi;

d) U njoftua se kontrata me operatorin që e ka dizajnuar uebfaqen e ASHAK-ut, përfundon në tetor dhe tani duhet të nisen procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e faqes. Anëtare korrespondente Myzafere Limani u caktua njësi kërkuese. Njëherësh u vendos që sekretari shkencor i ASHAK-ut të caktohet mbikëqyrës për mirëmbajtjen e faqes. Z. Xhemshit Brajshori u tha të përkthejë materialet që ia cakton sekretari shkencor;

e) U vendos të blihen tre printerë për punët e projektit *Enciklopedia Shqiptare*;

f) Caktoi z. Xhavit Beqiri lektor për lekturimin e dorëshkrimeve të ASHAK-ut.

X. Mbledhja (LVII) e Kryesisë u mbajt në formë elektronike, më 5 qershor. Në këtë mbledhje Kryesia mori vendim që z. Bajram Morina të caktohet avokat për përfaqësimin e ASHAK-ut, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Zyra e Përmbartimit, si dhe para çdo gjykate dhe organi tjetër shtetëror kompetent lidhur me zgjidhjen e të gjitha kontesteve për ASHAK-un.

XI. Më 6 qershor u mbajt mbledhja e radhës (LVIII) e Kryesisë. Në këtë mbledhje u vendos për organizimin e ceremonisë mortore për akademik Rexhep Ferrin, në të cilën angazhohen gjatë homazheve tre interpretë: Entela Qarkagjija, Edrit Mala dhe kori i burrave për interpretim në ceremoninë e varrimit.

XII. Në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor (LIX), Kryesia e shqyrtoi informatën e Këshillit për përzgjedhjen

e kandidatëve për Çmimin stimulues në kuadër të Seksionit të Shkencave të Natyrës. F. Podvorica njoftoi për ecurinë e punës dhe mënyrën e përzgjedhje së kandidatëve. Kryesia u pajtua që të organizohet ceremonia për ndarjen e çmimit, më 28 qershor 2024, ora 11:00. Me këtë rast u vendos që të organizohet një program i shkurtër artistik me Syzana Jakupi, piano dhe Alba Muçolli Dehiri, piano. Në vazhdim, para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, kryetari Kraja diskutoi për konferencën: *25 vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekulli shtetndërtim, arritje dhe sfida-qasje multidisiplinare*, që u mbajt më 10 qershor 2024. Ai tha se konferenca nuk e ka arritur qëllimin e saj siç është menduar. Ka pasur neglizhencë dhe vonesë në dërgimin e njoftimeve. Ai tha se vendimi është marrë diku në nëntor të vitit të kaluar, disa herë gjatë këtij viti, ai tha se e ka ftuar në takim Gj. Mushkolajn dhe ka apeluar që të dërgohen ftesat. Ia ka shprehur gatishmërinë dhe interesimin që konferenca të bëhet në mënyrën më të mirë.

Gj. Mushkolaj në fjalën e saj tha se pajtohet me kryetarin dhe se për konferencën dhe për të gjitha pengesat do të bëjë raport me shkrim.

Diskutoi më pas S. Hamiti, i cili tha se organizimi i konferencave kërkon kohë dhe përkushtim dhe se më mirë të planifikohen më pak konferenca dhe ato të përgatiten dhe të kryhen me sukses.

Kryesia më pas:

a) E miratoi raportin e Gj. Mushkolajt për qëndrimin e saj në Berlin, më 22 dhe 23 maj, me qëllim të pjesëmarrjes në Kuvendin e përgjithshëm të ALLEA-s.

Ajo tha se është zgjedhur kryetari i ri dhe tha se është mirë që atij t'i bëhet një urim nga ASHAK-u. U pajtuan të gjithë dhe u tha që njoftimi t'i përcillet nënkretares J. Sh. Pula;

b) E miratoi raportin e qëndrimit të anëtarëve të Redaksisë vendore të projektit të *ESH-së*, në Tiranë, më 2-4 qershor 2024, me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e dy redaksive vendore, Prishtinë-Tiranë;

c) E miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Vjenë-Austri, më 29 prill-12 maj 2024;

d) Vendosi të punohet vula e brendshme për përdorim në Bibliotekën e ASHAK-ut. Forma e vulës nuk ndryshon nga ajo e mëparshmja, por meqë vula është vjetruar duhet të punohet e reja;

e) E miratoi kërkesën e Universitetit të Arteve –Tiranë për dhurimin e botimeve të ASHAK-ut, përkatësisht të Seksionit të Arteve për pasurimin e bibliotekës së tyre;

f) U njoftua nga L. Pula se tani është koha e pushimeve vjetore të stafit të administratës dhe se duhen planifikuar pushimet ashtu që të mos ketë pengesa në punë. U tha që pjesa më e madhe e pushimeve të shfrytëzohet prej gjysmës së korrikut dhe gjatë gushtit, meqë në shtator e tutje ka aktivitete të shumta në Akademi dhe stafi duhet të jetë në punë.

XIII. Në mbledhjen (LX) e datës 5 korrik, Kryesia e shqyrtoi kërkesën (nr. 907, dt. 01.07.2024) të anëtarit korrespondent Salih Gashi, për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare shkencore për energjinë e gjelbër, tokën dhe *shkencat e mjedisit* në Amsterdam. Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë

dhe pas diskutimeve u tha që kërkesa miratohet, por pasi S. Gashi të paraqesë dëshmi se i pranohet punimi dhe konfirmohet me të pjesëmarrja në konferencë. U tha që pjesëmarrja e tij atje ka rëndësi dhe se duhet t'i mbulohen të gjitha shpenzimet.

Në vazhdim kryetari Kraja diskutoi për çështjen e dokumenteve për themelimin e Akademisë së të rinjve. Ai tha se kryesuesja e grupit GJ. Mushkolaj nuk ka paraqitur asnjë njoftim, prandaj duhet të mendojmë për ndryshimin e përbërjes së grupit. Diskutuan të gjithë anëtarët e pranishëm dhe u tha që kjo çështje të diskutohet pasi të jetë prezent Gj. Mushkolaj.

Kryetari Kraja po ashtu bëri vërejtje për mosprezencën e Gj. Mushkolaj në mbledhje të Kryesisë. Ai tha se nuk është korrekte kjo sjellje. Të gjithë anëtarët e Kryesisë marrin shtesë për funksionin e tyre. Është fakt që aktet tona nuk parashohin sanksione për raste të tilla, por ne duhet të jemi të përgjegjshëm për obligimet tona. Ai edhe kësaj radhe përmendi dështimin e konferencës për 25-vjetorin e çlirimit të NATO-s dhe tha se nuk e ka caktuar ai këshillin organizativ, por vetëm ia ka deleguar sekretares së SSHSH organizimin e konferencës.

Në fund Kryesia i miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare, si në vijim:

- Raportin e takimit për projektin *Enciklopedia Shqiptare*, në Durrës, më 19-21 qershor 2024;

- Raportin e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami, për qëndrimin e tij në Ankara, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Akademia e Turqisë, më 26-30 qershor 2024;

- Raportin e Justina Sh. Pulës për qëndrimin e saj në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në ceremoninë e varrimit të akademik Ismail Kadaresë, më 3 korrik 2024.

Kryesia njëherësh u njoftua se znj. Rejhane Islamit, e caktuar u.d. drejtor i DBA i realizohet kompensimi i mbushjeve të telefonisë mobile.

XIV. Mbledhja e radhës e Kryesisë (LXI) u mbajt më 30 gusht. Në këtë mbledhje Kryesia u mor me shqyrtimin e një varg çështjesh.

Në këtë mbledhje:

- U mor vendimi për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Akademisë dhe u miratua Qarkorja për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, si në vijim:

“Në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Ligji Nr. 05/L -038) neni 19, 20, 21, 22 e 23, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 831, të 18.06.2024, neni 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 e 32 nënparagrafi 1.4, Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në mbledhjen e saj të 30.08.2024 vendosi të shpallë

QARKOREN PËR PROPOZIMIN E KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË AKADEMISË

Duke pasur parasysh karakterin dhe rolin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rastin e dhënies së propozimeve është e domosdoshme të merren parasysh:

1. Në mbledhjet e organeve përkatëse të institucioneve, që me Statutin e ASHAK-ut janë të autorizuar të japin propozime, duhet të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme çështja se cilët

shkencëtarë, respektivisht artistë i plotësojnë kushtet për t’u propozuar anëtarë të Akademisë, në mënyrë që, në bazë të rezultateve të shqyrtimit dhe të vlerësimit të krijimtarisë shkencore a artistike të kandidatëve, të paraqiten propozimet e arsyetuara për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

2. Në Ligjin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 20, përkatësisht në Statutin e ASHAK-ut neni 20 është precizuar, se:

“Anëtar korrespondent i Akademisë mund të zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit, shtetas i Kosovës, i cili ka krijuar vepra shkencore ose artistike të një rëndësie të veçantë”.

3. Në Statutin e ASHAK-ut, neni 18 paragrafi 4, (4.1, 4.2 dhe 4.3), është precizuar, se:

“4. Anëtarë korrespondentë të Akademisë zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeçare”.

“4.1. Kandidatët të cilët në ditën e mbylljes së afatit për paraqitjen e propozimeve mbushin 65 vjeç nuk mund të hyjnë në procedurën e zgjedhjeve”;

“4.2. Afati i mbylljes së paraqitjes së propozimeve përcaktohet me Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë (në tekstin e mëtejshmë: Qarkorja)”; dhe

“4.3. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit të cekur në nënparagrafin 4.1 të këtij neni, nuk do të merren parasysh”.

Propozimet e më së paku 2 (dy) recensentëve duhen të jenë të arsyetuara me shkrim dhe duhen të përmbajnë:

- Të dhënat e hollësishme për punën shkencore ose për veprat artistike të kandidatit të propozuar;

- Vlerësimet e plota të propozuesve për rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar; dhe

- Të dhënat për recensionet e mëparshme të rezultateve të krijimtarisë shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.

4. Dokumentacioni i nevojshëm i kandidatit që propozohet:

- Propozimet e më së paku 2 (dy) recensentëve, të nënshkruara, të vulosura dhe të protokolluara nga Institucioni që propozon;

- Kopja e letërnjoftimit;

- Ekstrakti lindjes original, jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj;

- CV-ja e plotë

- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës, origjinal;

- Bibliografia e saktë e punimeve bashkë me fotokopjen e faqes së parë dhe të fundit të revistës, përmbajtjes dhe punimit ku është publikuar punimi;

- Kopja e librit/librave, ballina, faqet e të dhënave të librit, përmbajtja, faqja e CIP-it, dhe faqja e fundit;

5. Propozimet e arsyetuara bashkë me dokumentacionin e cekur në pikën 5 të kësaj Qarkoreje dërgohen vetëm në formë elektronike në formatin PDF deri më 15 tetor 2024 në adresën zyrtare të Akademisë: zgjedhjet2024@ashak.org.

6. Në dokumentacionin e kandidatëve duhet të paraqitet vegza (linku) i punimeve.

7. Pranohen vetëm propozimet që vijnë nga adresat elektronike të

organeve përkatëse të institucioneve, që me Statutin e ASHAK-ut janë të autorizuar të japin propozime, të cilave iu dërgohet Qarkorja.

8. Organet përkatëse të institucioneve, që me Statutin e ASHAK-ut janë të autorizuar të japin propozime, njoftohen me email se propozimi/propozimet e tyre është/janë pranuar dhe regjistruar në protokollin zyrtar të ASHAK-ut.

9. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit, të cekur në pikë pikën 6, nuk do të merren parasys.

10. Baza juridike e ASHAK-ut mund të shihet në faqen ueb të ASHAK-ut në <http://www.ashak.org>. “.

- U miratua agjenda e aktiviteteve parazgjedhore, si në vijim:

AGJENDA E VEPRIMEVE PARAZGJEDHORE 2024

30 gusht 2024

1. Mbledhja e Kryesisë:
2. Marrja e vendimit për shpalljen e zgjedhjeve
3. Caktimi i komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të propozimeve
4. Caktimi i Komisionit të përkohshëm për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj
5. Caktimi datës së mbajtjes së zgjedhjeve (mbledhja e Kuvendit zgjedhor), **më 23 dhjetor 2024**

2 shtator 2024

1. Shpallja e zgjedhjeve

2. Dërgimi i Qarkores fakulteteve dhe instituteve publike

15 tetor 2024

1. Afati i fundit për paraqitjen e propozimeve

16 tetor 2024

1. Pasqyra e propozimeve për anëtarë të rinj

21 tetor 2024

1. Mbledhja e Kryesisë:
2. Njoftimi me propozimet që kanë arritur
3. Caktimi i orarit të mbledhjeve të seksioneve, **(më 24 dhe 25 tetor)**
4. Dërgimi i listave të propozimeve seksioneve për kandidatët përkatës
5. Kryesia kërkon prej seksioneve të shfaqin mendimin e tyre për secilin kandidat veç e veç (me recension nga së paku 2 anëtarë të vet). Afati për paraqitjen e recensioneve është 15 ditë (përmbillet më 11 nëntor 2024)

24 - 25 tetor 2024

1. Mbledhjet e seksioneve:
2. Shqyrtimi i propozimeve nga jashtë
3. Dhënia e propozimeve nga Seksioni
4. Propozimet për avancimin e anëtarëve korrespondentë të seksionit
5. Caktimi i recensentëve për të gjithë kandidatët e propozuar
6. Propozimi i kandidatëve për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit
7. Propozimi i numrit të anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga

- seksioni (përpjesëtimi midis seksioneve)

29 tetor 2024

1. Mbledhja e Kryesisë:
2. Njoftimi me propozimet e seksioneve
3. Analiza e gjendjes
4. Përcaktimi i numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen - duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve
5. Shqyrtimi i propozimeve të seksioneve për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi
6. Propozimet për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi
7. Caktimi i recensentëve për anëtarët e propozuar (të jashtëm dhe nderi)

11 nëntor 2024

1. Afati i fundit për dorëzimin e recensioneve të recensentëve bashkë me propozimet nga jashtë

18 nëntor 2024

1. Përgatitja e materialeve për shikim nga Opinioni publik
2. Dërgimi i njoftimit për opinionin publik

19 – 25 nëntor 2024

1. Ekspozimi i materialeve në mjediset e Akademisë

27 nëntor 2024

1. Mbledhja e Kryesisë;
2. Pranimi dhe shqyrtimi kundërshtimeve eventuale
3. Caktimi i mbledhjeve të seksioneve (2 dhe 3 dhjetor 2024)

2 dhe 3 dhjetor 2024

1. Mbledhjet e seksioneve:
2. Shqyrtimi i vërejtjeve eventuale
3. Votimi për kandidatët e propozuar.

9 dhjetor 2024

1. Kryesisë i dërgohen propozimet e pranuar në seksione

9 dhjetor 2024

1. Anëtarëve të Kuvendit u dërgohen recensionet për të gjithë kandidatët

23 dhjetor 2024

Kuvendi zgjedhor

- U vendos të thirret seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e anëtarëve të saj, më 23 dhjetor 2024, ora 11:00 me këtë rend të ditës:

miratimi i procesverbalit të mbledhjes CXV të Kuvendit të Akademisë; Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë; Paraqitja e arsyetimeve të shkurtra të sekretarëve të seksioneve për secilin kandidat (për anëtar të rregullt, për anëtar korrespondent dhe për anëtar të jashtëm); Votimi dhe shpallja e rezultateve të votimit dhe çështje vijuese.

- U caktua Komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit të propozimeve për anëtarë të Akademisë, me këtë përbërje: anëtar korrespondent Nysret Krasniqi, anëtar korrespondent Besnik Krasniqi dhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë. Komisioni ka për detyrë të verifikojë rregullsinë e propozimeve të paraqitura dhe përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore të ASHAK-ut.

- U caktua Komisioni i përkohshëm për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve për propozimin dhe

zgjedhjen e anëtarëve të rinj, me këtë përbërje: akademike Justina Sh. Pula, akademik Tahir Emra, akademik Rauf Dhomi, akademik Eqrem Basha dhe anëtar korrespondent Nysret Krasniqi. Komisioni do t'i kryejë të gjitha punët që i përkasin Seksionit të Arteve për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të ASHAK-ut.

- U caktua anëtar korrespondent Besnik Krasniqi, ushtrues i detyrës së Sekretarit shkencor të ASHAK-ut për periudhën gjashtëmujore, 1 tetor 2024-31 mars 2025.

- U caktua anëtar korrespondent Mehmet Halimi, anëtar të Këshillit të *Enciklopedisë Shqiptare*, nga data 1 tetor 2024.

- U shqyrtua më pas kërkesa e znj. Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit për marrjen e pushimit pa pagesë për periudhën 1 tetor-31 dhjetor 2024. U tha që kërkesa miratohet në parim dhe se sekretarja e Akademisë të vazhdojë procedurat e parapara ligjore.

Dhe në fund Kryesia:

a) I miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare: Raportin e mbledhjes së Redaksisë qendrore në Tiranë, më 7-9 korrik 2024 dhe raportin e kryetarit Kraja për qëndrimin e tij në Ulqin, më 2-6 gusht 2024.

b) Diskutoi për shpërblimin mbështetës të ASHAK-ut, i cili ka disa vjet që është ndërprerë. Kryetari Kraja tha se ky shpërblim është ndarë nga donacionet që janë kërkuar jashtë ASHAK-ut. Ai propozoi që të kërkohej mjetet financiare nga MFPT, në kategorinë subvencione dhe transfere dhe më pas të vazhdojnë procedurat

për shpërblimin në fjalë. Propozimi u miratua njëzëri nga Kryesia.

c) E miratoi kërkesën e Besnik Krasniqit, për blerjen e dy biletave të aeroplanit për pjesëmarrësit në Konferencën shkencore ndërkombëtare në ndërmarrësi dhe menaxhment.

d) Diskutoi për çështjen e Akademisë së të rinjve-ASHAK. U tha se ka pasur vonesa dhe se duhet të vazhdojë puna. Gj. Mushkolaj, kryesuese e grupit punues tha se më 3 shtator do ta thërrasë mbledhjen e grupit dhe do të vazhdojnë me punë.

e) Vendosi të bëhet kompensimi i mbushjeve të telefonisë mobile për znj. Rejhane Islami, nga data 1 shtator 2024.

XV. Më 24 shtator, Kryesia në mbledhjen (LXII) e radhës diskutoi për Panairin e librit në Tiranë që do të mbahet më 13-17 nëntor 2024. U vendos që në Panair të shkojnë të gjithë anëtarët e Akademisë dhe stafi mbështetës i administratës.

Anëtarët e Akademisë qëndrojnë më 14-16 nëntor. Atyre u mbulohen shpenzimet e akomodimit për dy net (14 dhe 15 nëntor) dhe mëditjet ditore për tri ditë (14,15,16 nëntor). Shpenzimet e udhëtimit mbulohen nga vetë anëtarët.

Stafi i administratës do të qëndrojë sipas kalendarit që përcaktohet në përputhje me nevojat e organizimit në Panair.

U vendos po ashtu që librat në Panair të shiten me 30% zbritje.

Në Panair do të promovohen botimet e ASHAK-ut. Titujt dhe orari do të

caktohen ditëve në vijim, në koordinim me sekretarët e seksioneve.

Në vazhdim, Kryesia diskutoi për mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve të ASHAK-ut për shqyrtimin e shkallës së realizimit të programit të punës për vitin 2024.

U vendos që mbledhjet të mbahen si në vijim:

1. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 16 tetor 2024, ora 13:00;
2. Seksioni i Shkencave të Natyrës, më 17 tetor 2024, ora 11:00;
3. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 18 tetor 2024, ora 11:00.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) E miratoi kërkesën e anëtarit korrespondent Nysret Krasniqi, sekretar organizativ i konferencës shkencore: *Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit-150-vjetori i lindjes*, për kompensimin e biletës së aeroplanit për një pjesëmarrës nga Italia;

b) U njoftua me kërkesën e zyrtares Valbona Olluri për ndërprerjen e pagesës për punët e projektit *ESH*, për periudhën tetor- dhjetor 2024. U tha se Kryesia nuk merr vendime parciale. Kjo çështje shqyrtohet kur t'i vijë radha për vendimin e ri.

Njëherësh, në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës, kryetari Kraja kërkoj nga sekretarët e seksioneve t'i bëjnë njoftimet për web faqen e ASHAK-ut, me rastin e daljes nga shtypi të botimeve përkatëse.

XVI. Më 7 tetor u mbajt mbledhja (LXIII) e Kryesisë për organizimin e ceremonisë mortore me rastin e

ndarjes nga jeta të akademik Tahir Emrës dhe në të u vendos si në vijim:

Organizohet ceremonia mortore për akademik Emrën. Shpenzimet e varrimit i mbulon ASHAK-u dhe gjatë homazheve do të angazhohen: dy interpretë, Entela Qarkagjia dhe Edrit Mala, si dhe kori i burrave nën udhëheqjen e akademik Rauf Dhomit.

XVII. Mbledhja e radhës e Kryesisë (LXIV) që u mbajt më 21 tetor u mor me një varg çështjesh.

Kryesia u njoftua me propozimet që kanë arritur për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë. Komisioni i caktuar nga Kryesia ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka konstatuar si në vijim:

“Kandidatët e propozuar për anëtarë të rinj të ASHAK-ut:

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

1. Abdulla Rexhepi – Fakulteti i Filologjisë
2. Muhamet Hamiti – Fakulteti i Filologjisë
3. Lindita Tahiri - Fakulteti i Filologjisë
4. Rrahman Paçarizi – Fakulteti i Filologjisë
5. Begzad Baliu - Fakulteti i Edukimit – Prishtinë
6. Naser Pajaziti - Fakulteti i Edukimit - Prishtinë

Seksioni i Shkencave Shoqërore

1. Gazmend Qorraj - Fakulteti Ekonomik
2. Nail Reshidi - Fakulteti Ekonomik
3. Muhamet Mala - Fakulteti Filozofik

4. Ibrahim Gashi - Fakulteti Filozofik
5. Mirlinda Batalli- Fakulteti Juridik
6. Rexhep Gashi - Fakulteti Juridik
7. Iset Morina - Fakulteti Juridik
8. Visar Morina - Fakulteti Juridik
9. Arber Hadri - Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë
10. Bedri Muhadri - Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë
11. Naser Zabeli - Fakulteti i Edukimit – Prishtinë

Seksioni i Shkencave të Natyrës

1. Gani Bajraktari – Fakulteti i Mjekësisë
2. Kreshnik Hoti – Fakulteti i Mjekësisë
3. Mentor Sopjani – Fakulteti i Mjekësisë
4. Merita Koçinaj Berisha - Fakulteti i Mjekësisë
5. Bajram Berisha - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
6. Imer Rusinovci - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
7. Blerim Rexha - Fakulteti Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
8. Enver Hamiti - Fakulteti Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
9. Arbnor Pajaziti - Fakulteti Inxhinierisë Mekanike
10. Naser Kabashi - Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit
11. Avni Berisha - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
12. Behxhet Mustafa - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

13. Faton Berisha - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

14. Naim Braha - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

15. Qëndrim Gashi - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

16. Flurije Sheremeti Kabashi - U.Mitrovicës – Fakulteti i Gjeoshkencave

17. Islam Fejza - U.Mitrovicës – Fakulteti i Gjeoshkencave

Seksioni i Arteve

1. Syzana Jakupi – Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”

2. Eshref Qahili - Fakulteti i Arteve

3. Ismet Jonuzi - Fakulteti i Arteve

4. Mentor Zymberaj - Fakulteti i Arteve

5. Muhamet Ahmeti - Fakulteti i Arteve

6. Valton Beqiri - Fakulteti i Arteve

7. Visar Mulliqi - Fakulteti i Arteve

8. Zake Prelvukaj - Fakulteti i Arteve

Azem Hajdari – F. Juridik – Recensionin nuk e ka të protokolluar nga Fakulteti.

Shpend Elezi – F. i Mjekësisë – i mungon Certifikata e shtetësisë.

Propozimet për këta kandidatë nuk janë bërë sipas Ligjit, Statutit dhe Qarkores për zgjedhjet 2024.

Jeton Kelmendi – Biblioteka publike – Gjakovë

Nijazi Halili – letër rekomandim nga Gjon Boriçi

Linda Salihu – F. i Edukimit’.

Në vazhdim u konfirmua orari i mbledhjeve të seksioneve: SGJL, më

24.10.2024, ora 11:00; SSHSH, më

24.10.2024, ora 13:00, SSHN,

25.10.2024 ora 11:00, ndërsa u bë një ndryshim të mbledhja e komisionit për SA. Kjo mbledhje mbahet më 24.10.2024, ora 09:00.

U tha që seksioneve të ASHAK-ut iu dërgohen listat vetëm për kandidatët përkatës.

Kryesia më pas vendosi që të bëhet zëvendësimi i një anëtari në Komisionin e përkohshëm për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj, ashtu që në vend të akademikut të ndjerë Tahir Emra, caktohet anëtare korrespondente Myzaferë Limani.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia e shqyrtoi shkallën e realizimit të programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2024. U tha që programi i punës është realizuar në shkallë të mirë dhe se pritet që deri në fund të vitit të realizohen edhe pikat e mbetura.

Në vazhdim Kryesia:

- Mori vendim të realizohen pagesat për të angazhuarit për organizimin e ekspozitës personale të autorit Fatmir Krypa: Eqrem Basha, Zeni Ballazhi, Enver Bylykbashi, autori dhe punëtori teknik.

- Propozoi akademik Rexhep Ismajlin anëtar përfaqësues të ASHAK-ut për Këshillin qendror të studimeve të doktoratës, në Universitetin e Prishtinës. U tha që akademik Ismajli të njoftohet me propozimin dhe të merret pëlqimi i tij. Në rast të mospranimit eventual të tij, Kryesia do të bëjë propozim të ri.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të nënkryetares së ASHAK-ut, akademike J. sh. Pula dhe znj. Lendita Pula, për qëndrimin në Berlin, më 29 shtator deri më 3 tetor, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën e organizuar nga Akademia Nazionale Gjermane e Shkencave-Leopoldina;

b) E miratoi raportin e takimit të projektit Enciklopedia Shqiptare, në Vërmicë, më 10-12 tetor 2024, në të cilin morën pjesë dy redaksitë vendore dhe redaktorët përgjegjës të fushave Prishtinë-Tiranë.

XVIII. Në mbledhjen (LXV) që u mbajt më 29 tetor, Kryesia:

a) U njoftua me propozimet e seksioneve, për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, si në vijim:

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK në mbledhjen e mbajtur më 24.10.2024:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;
2. Ka propozuar nga Seksioni prof. dr. Kujtim Manin për anëtar korrespondent;
3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Bardh Rugova, Mehmet Halimi, Nysret Krasniqi dhe Shkumbin Munishi;
4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;
5. Nuk ka propozuar kandidatë për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi;
6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga Seksioni të jetë tre (3).

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore në mbledhjen e mbajtur më 24.10.2024:

Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-ut në mbledhjen e mbajtur më 24.10.2024:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;
2. Nuk ka paraqitur propozime nga brenda;
3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Besnik Krasniqi, Frashër Demaj dhe Gjyljeta Mushkolaj;
4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;
5. Nuk ka propozuar kandidatë për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi;
6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga Seksioni të jetë dy (2).

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

Seksioni i Shkencave të Natyrës i ASHAK-ut në mbledhjen e mbajtur më 25.10.2024:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;
2. Nuk ka paraqitur propozime nga brenda;
3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Arsim Morina, Fetah Podvorica, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Ka propozuar këta kandidatë për anëtarë të jashtëm: akademik Jorgaq Kaçani dhe akademik Arben Merkoçin dhe recensentët për ta:

a) Jorgaq Kaçani-recensentë Fejzullah Krasniqi dhe Isuf Krasniqi

b) Arben Merkoçin- recensentë Isuf Krasniqi dhe Fejzullah Krasniqi

6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga Seksioni të jetë tre (3).

IV. Komisioni i përkohshëm për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve

Komisioni për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve në mbledhjen e mbajtur më 24.10.2024:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;

2. Nuk ka paraqitur propozime nga brenda;

3. Ka propozuar për avancim: anëtarin korrespondent Xhevdet Xhafa dhe anëtarin korrespondent Luan Mulliqi-post mortem;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Ka propozuar për anëtar nderi sopranon Ermonela Jaho;

6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga Seksioni i Arteve të jetë tre (3).

U tha që anëtar korrespondent Luan Mulliqi nuk mund të propozohet post mortem për avancim, sepse nuk ka

bazë ligjore, aktet normative të ASHAK-ut nuk e parashohin.

b) Analizoi gjendjen sipas seksioneve. Kryetari Kraja tha se në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë ai ka ngritur një problematikë dhe më pas është zhvilluar debat i gjerë. Ai tha se ka propozuar që dy kandidatë të propozuar: Muhamet Hamiti dhe Lindita Aliu Tahiri të mos hyjnë në procedurën e zgjedhjeve, sepse ka konflikt interesi, meqë anëtarë të atij Seksioni i kanë të afërm. Marrë parasysh faktin se aktet normative të ASHAK-ut nuk përmbajnë dispozita për çështje të tilla dhe Ligji për konfliktin e interesit është i paqartë sa i përket natyrës së institucionit tonë, Seksioni ka vendosur t'i procedojë të dy kandidatët. Ai tha se, ashtu siç ka thënë në Seksion, e përsëritë edhe tani, se nëse këta kandidatë arrijnë të kalojnë në Kuvend, është i obliguar t'i drejtohet me shkresë Agjencionit Antikorrupsion për trajtimin e kësaj çështjeje.

c) Diskutoi për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen - duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve. Në diskutimin e saj Gj. Mushkolaj tha se në Seksionin e SHSH është diskutuar çështja e kuotës dhe Seksioni ka kërkuar të respektohet kuota e rekomanduar 2+2+2+3. F. Podvorica njoftoi se Seksioni i SHN ka kërkuar kuotën tre, sepse gjendja në Seksion nuk është e mirë. Dy anëtarë janë në gjendje jo të mirë shëndetësore, një anëtarë e kemi humbur (akademik Feriz Krasniqi), si dhe në zgjedhjet e fundit nuk kemi pasur as pranime të reja e as avancime. Ai tha se këtë kërkesë e ka bërë edhe herë të tjera në Kryesi. Kryetari Kraja duke iu përgjigjur Gj. Mushkolajt dhe duke iu referuar Statutit dhe

Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, tha se nuk kemi rekomanduar asnjë kuotë. Në Qarkoren buxhetore e kemi propozuar numrin 9 për pranimin e anëtarëve të rinj, por kjo çështje vendoset nga Kryesia, seksionet vetëm propozojnë.

Ai tha se sot duhet të vendosim, por meqë anëtarët e Seksionit të SHSH nuk po pajtohen që Seksionit të SHN t'i lejohej kuota tre dhe nuk kemi kuorum, propozoi që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër. U vendos që më 4 tetor, ora 11: 00 të mbahet mbledhja e Kryesisë vetëm me këtë pikë të rendit të ditës. Propozimi u miratua njëzëri.

d) Shqyrtoi propozimet e Seksionit të SHN për anëtarë të jashtëm (Jorgaq Kaçani dhe akademik Arben Merkoçi) dhe propozimin e caktimit të recensentëve për ta. Propozimet u miratuan.

Më pas shqyrtoi propozimin e Komisionit të përkohshëm për ushtrimin e të gjitha funksioneve të Seksionit të Arteve për anëtar nderi (Ermonela Jaho). Propozimi nuk u miratua, sepse kandidatja i përket fushës së artit muzikor riprodhues dhe aktet normative të ASHAK-ut nuk e lejojnë.

e) Nuk paraqiti propozime për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi;

Në kuadër të kësaj mbledhjeje kryetari Kraja njoftoi Kryesinë se është njoftuar me shkresën e akademik Hivzi Islamit i cili ka bërë vërejtje rreth publikimit të Statutit të Akademisë që u miratua në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë, më 18 qershor 2024. Ai tha se e ka lexuar edhe njoftimin e Arsim Bajramit,

në të cilin ai sqaron se nuk ka asnjë shkelje ligjore. Gj. Mushkolaj tha se nuk pajtohet me sqarimin e A. Bajramit dhe se kjo çështje duhet të trajtohet dhe të ndryshohet procedura. Ajo tha se është dashur të bëhet vendim për ndryshimin e përkohshëm të Statutit. M. Kraja ndërhyri dhe tha se ndryshimi i Statutit nuk është i përkohshëm dhe nuk qëndron konstatimi i H. Islamit se ndryshimi është bërë përkohësisht vetëm për funksionalizimin e Seksionit të Arteve. Në Statut thuhet seksionet e jo Seksioni i Arteve. Kraja vazhdoi duke thënë se në Kuvend rendi i ditës është miratuar njëzëri, A. Bajrami ka referuar për mënyrën se si janë hartuar dhe proceduar draftet. As A. Bajrami e as Gj. Mushkolaj nuk kanë kërkuar që të merret vendim e jo miratim i Statutit. Materialet e njëjta (që i kam nënshkruar) i kanë pasur në dispozicion të gjithë anëtarët e Akademisë. Gjatë shqyrtimit nuk ka paraqitur askush vërejtje. Këta që sot bëjnë vërejtje, është dashur t'i bëjnë në Kuvend. Statuti është miratuar njëzëri, nuk e kuptoj tani këtë reagim.

L. Pula me kërkesë të Kryetarit sqaroi se drafti i Statutit dhe i Rregullores është hartuar nga grupi punues, kryesues i të cilit ka qenë A. Bajrami dhe Gj. Mushkolaj ka qenë anëtare, si dhe vetë ajo. Draftet janë proceduar në Kryesi, tek të gjithë anëtarët e Akademisë dhe janë miratuar në Kuvend. Ajo më pas të njëjtat i ka proceduar për nënshkrim, siç ka vepruar gjithnjë në raste të tilla. Sa i përket çështjes se është dashur të ketë vendim, ajo tha se rendi i ditës për mbledhjen e Kuvendit është miratuar në Kryesi dhe i njëjti edhe në Kuvend. Në Kryesi dhe në Kuvend Gj. Mushkolaj e ka miratuar atë rend dite dhe nuk ka

paraqitur vërejtje për ndryshimin e tij, ashtu që të theksojë se plotësimi duhet të bëhet me vendim të përkohshëm. Ajo tha po ashtu se, gjithnjë prej që është në Akademi ka ndjekur të njëjtën procedurë. Çdo akt normativ që është plotësuar, ka hyrë në fuqi dhe e ka shfuqizuar të mëparshmin.

Pas diskutimeve, kryetari Kraja tha se nuk ka asnjë interes që të jetë apo jo nënshkruar i Statutit, prandaj propozoi që A. Bajrami dhe Gj. Mushkolaj (meqë i përkasin SSHSH, që ka bërë vërejtjen përkatëse) të paraqesin një raport dhe kërkesë për ndryshimin e publikimit. Kërkesën ia procedojmë Kuvendit dhe nëse Kuvendi e miraton e bëjmë ndryshimin. Propozimi u miratua.

Në fund u miratua raporti i z. Hilmi Zogjani për punët e kryera për projektin Kosova në gjuhët e botës. U vendos që z. Zogjanit t'i vazhdohet kontrata edhe për tre muaj, 1 nëntor 2024-31 janar 2025, meqë ai i ka kryer punët e tij, por disa gjëra duan ende kohë, kjo për arsye objektive.

XIX. Më 4 nëntor u mbajt mbledhja (LXVI) e radhës e Kryesisë. Në këtë mbledhje fillimisht u miratua me një plotësim procesverbali i mbledhjes LXIV i Kryesisë së Akademisë.

Plotësimi u bë te fjala e Gj. Mushkolajt: si në vijim:

“Gj. Mushkolaj tha se nuk pajtohet me sqarimin e A. Bajramit dhe se kjo çështje duhet të trajtohet dhe të ndryshohet, bazuar në procedurën e përcaktuar më herët dhe vendimin e marrë paraprakisht, që ishte ekskluzivisht për plotësimin e Statutit ekzistues, e jo për nxjerrjen e Statutit të ri dhe shfuqizimin e Statutit të vjetër. Ajo tha se Kuvendi e ka miratuar

vetëm ndryshimin / plotësimin e Statutit ekzistues. Kjo mund të vërtetohet nga Rendi i ditës i mbledhjes së Kuvendit dhe votimi i bazuar në Rendin e miratuar të ditës dhe emërtimin e vetë dokumentit që është votuar. E njëjta gjë vlen edhe për Rregulloren.”

Lidhur me procesverbalin diskutoi S. Hamiti. Ai tha se, meqë nuk ka qenë në mbledhje tani ka një vërejtje për diskutimin e kryetarit Kraja, faqe 3, pika b, rreshti i shtatë: “ Seksioni ka vendosur t'i procedojë të dy kandidatët. Ai tha se, ashtu siç ka thënë në Seksion, e përsërit edhe tani, se nëse këta kandidatë arrijnë të kalojnë në Kuvend, është i obliguar t'i drejtohet me shkresë Agjencionit Antikorrupsion për trajtimin e kësaj çështjeje”.

S. Hamiti tha se nuk e konteston procesverbalin, sepse aty është paraqitur fjala e kryetarit në këtë mbledhje, por tha se nuk pajtohet me konstatimin e kryetarit siç u cek më lart ndër thonjëza, sepse Seksioni nuk ka marrë asnjë vendim dhe vazhdoi duke thënë se, nëse duhet drejtuar shkresë AAK, ajo duhet të bëhet që tani, të mos humbet kohë dhe atë le ta bëjë sekretarja e Akademisë. L. Pula tha se shkresën ajo e bën pa vonesë, por paraprakisht i duhet vendimi i Kryesisë. Gj. Mushkolaj tha se sekretares nuk i duhet vendimi, sepse është detyrë e saj dërgimi i shkresës. Kryetari Kraja tha se sekretarja nuk ka kompetencë, sepse nuk është personi më i lartë udhëheqës, nëse duhet të bëhet shkresa; për të së pari duhet të vendosë Seksioni, më pas Kryesia e shqyrton shkresën e Seksionit dhe merr vendim për procedim të saj. Kryesia u pajtua me propozimin e Kryetarit dhe S. Hamiti tha se do ta mbajë edhe një

mbledhje të Seksionit dhe vendimin e Seksionit do t'ia paraqesë për miratim Kryesisë. J. Sh. Pula në fund tha se si Kryesi duhet të jemi të gatshëm ta shqyrtojmë vendimin e SGJL-së sapo të jetë gati, pra të mbledhemi pa vonesë.

Në vazhdim të mbledhjes u diskutua për së dyti për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen - duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve. Kryetari Kraja duke iu referuar nenit 10 të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë tha se rregullorja precizon se Kryesia duhet të vendosë. Seksioni i SHN-së ka propozuar/kërkuar t'u lejohet kuota 3. Ai tha se e përkrah propozimin e SSHN-së, marrë parasysh që dy anëtarë të tij nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, një anëtar nuk e kemi më (akademik Feriz Krasniqi), pra Seksioni po shkon drejt një situatë jo të mirë. Ai më pas kërkoi nga të gjithë të deklarohen me argumente a janë për apo kundër. F. Podvorica e arsyetoi propozimin e Seksionit duke iu referuar diskutimit të kryetarit dhe shtoi se kërkesën për 3 veta e ka parashtruar disa herë në mbledhje të Kryesisë, me rastin e miratimit të Qarkores buxhetore po ashtu e ka parashtruar të njëjtën kërkesë. Ai tha se kërkesa për Qarkore nuk paraqet problem se gjithnjë ka hapësirë për raste të tilla. Numri 3 është më se i nevojshëm dhe i arsyeshëm, sepse kemi më së shumti prurje.

F. Podvorica e dorëzoi tekstin integral të diskutimit të tij i cili do t'i bashkëlidhet dosjes së kësaj mbledhjeje.

Gj. Mushkolaj tha se është kundër numrit 3 për SSHN, sepse në Seksionin e SHSH ne kemi biseduar dhe jemi

dakorduar për numrin 2. Ajo tha se e përfaqëson qëndrimin e Seksionit, sepse është sekretare e atij Seksioni.

J. Sh. Pula tha se mbetet pranë qëndrimit që e ka shprehur në mbledhjen e kaluar, pra për numrin 2.

B. Krasniqi tha se në këtë rast duhet ndjekur praktika e mëhershme dhe duhet të veprojme sipas Qarkores buxhetore dhe të mbetet numri 2.

Kryetari Kraja tha se arsyetimi i Gj. Mushkolajt është i paqëndrueshëm, pavarësisht që ajo përfaqëson Seksionin, duhet të dijë që një Seksion nuk është Akademia, një Seksion nuk mund të vendosë për seksionet e tjera. Sa u përket argumenteve J. Sh. Pulës dhe B. Krasniqit, ai tha se qëndrimet e tyre janë joserioze. Kryetari po ashtu tha se tani më është e qartë që SSHSH-ja do që ta sundojë Akademinë, por habitet se si nënkryetarja dhe u.d. sekretari shkencor i bashkëngjiten veprimeve të tilla, marrë parasysh që janë anëtarë të Kryesisë dhe e kanë për detyrë ta shtyjnë përpara procesin e jo ta bllokojnë atë. Ai më pas kërkoi të votohet dhe pas votimit M. Kraja dhe F. Podvorica votuan pro propozimit të SSHN, J. Sh. Pula abstenoj, ndërsa Gj. Mushkolaj dhe B. Krasniqi votuan kundër. S. Hamiti nuk ishte pjesë e votimit, meqë kishte dalë më herët nga mbledhja. Meqë nuk u arrit të merret vendimi, kryetari Kraja propozoi të mbahet edhe një tjetër mbledhje. Propozimi u miratua dhe u vendos që mbledhja e radhës të mbahet më 8 tetor 2024, ora 10:00.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës u miratua raporti i udhëtimit zyrtar të F. Podvoricës, në Tiranë, më 28 tetor -1 nëntor, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën

ndërkombëtare të nanoteknologjisë:
Nanoballkan 2024.

XX. Në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor (LXVII) u diskutua për së treti me radhë për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen - duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve. Kryetari Kraja duke iu referuar nenit 10 të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë tha se mbetet pranë qëndrimit të tij për miratimin e propozimit të Seksionit të Shkencave të Natyrës për përcaktimin e kuotës 3. Është hera e tretë që po diskutojmë për këtë pikë dhe kjo është e tepërt dhe prej që jam në Akademi një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë më parë. Motivet për këtë pengesë tani më janë të qarta dhe unë si Kryetar nuk i kuptoj spekulimet që po bëhen. Sido që të jetë, ai tha se nuk do të bëhet pjesë e atyre që duan ta bllokojnë procesin dhe meqë nuk ka zgjidhje tjetër, tha se përkundër qëndrimit të tij, ai do ta japë votën te shumica, pra për variantin 2+2+2+3. Ai përsëriti edhe një herë se nuk është e drejtë jonë të shtyjme procese që dëmtojnë Akademinë.

F. Podvorica në diskutimin e tij tha se sot ka mbajtur në mëngjes një mbledhje të SSHN-së; ai e falënderoi kryetarin në emër të Seksionit për mbështetjen. Si Seksion jemi në situatë të pakëndshme për arsyet që i kemi bërë të njohura disa herë deri më tani. Jemi të ofenduar dhe konsiderojmë se është e padrejtë që një seksion të ndërhyjë te një seksion tjetër, por meqë kemi ardhur në këtë situatë, SSHN-ja është deklaruar që i respekton aktet normative të ASHAK-ut dhe vepron në të mirë të institucionit e jo për dëmtimin e tij.

Më pas me 4 vota për (M. Kraja, J. Sh. Pula, B. Krasniqi dhe Gj. Mushkolaj) dhe një votë kundër (F. Podvorica), Kryesia e caktoi numrin e anëtarëve të rinj që do të zgjidhen, si në vijim: SGJL, 2 anëtarë, SSHSH, 2 anëtarë, SSHN, 2 anëtarë dhe SA, 3 anëtarë.

Më pas Kryesia diskutoi për çështjen e tre kandidatëve të propozuar nga UP-ja për anëtarë korrespondentë të ASHAK-ut, Lindita Aliu Tahiri, Muhamet Hamiti dhe Visar Morina, të cilët kanë të afërm anëtarë të Akademisë të seksioneve përkatëse (dy të parët në SGJL dhe i treti në SSHSH). Marrë parasysh që aktet normative të ASHAK-ut nuk përmbajnë dispozita që rregullojnë çështje të kësaj natyre, Kryesia njëzëri mori vendim që kjo çështje t'i adresohet Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë për të kërkuar sqarim/këshillë se a mund të vazhdohet procedura e zgjedhjeve për këta tre kandidatë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës L. Pula ua ndau anëtarëve të Kryesisë një shkresë të cilën e ka përpiluar zyrtari Taulant Veseli, i cili ka detyrë shtesë punët e zyrtarit për qasje në dokumente zyrtare. Në shkresë janë listuar dokumentet që Agjencia për Informim dhe Privatësi, në bazë të ligjit përkatës i kërkon të vendosen në webfaqen e ASHAK-ut dhe lista e dokumenteve që i prodhon ASHAK-u. Ajo tha se këto çështje janë obligim ligjor i institucioneve të Kosovës dhe Kryesia duhet të jetë në dijeni.

XXI. Më 27 nëntor në mbledhjen e saj (LXVIII), Kryesia u njoftua se gjatë afatit shtatëditor të ekspozimit të materialeve për të gjithë kandidatët e propozuar për anëtarë të Akademisë, është paraqitur vetëm një shkresë e cila apostrofon emrat e tre kandidatëve

të propozuar nga UP-ja për anëtarë korrespondentë për SGJL. U tha që kjo shkresë i dërgohet për shqyrtim Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Në vazhdim Kryesia konfirmoi mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve të ASHAK-ut, më 2 dhe 3 dhjetor.

Në fund Kryesia:

- a) U njoftua me kërkesat/ankesat e dy zyrtarëve të administratës (Nitë Krasniqi dhe Alban Bytyqi). U tha se këto çështje nuk i përkasin Kryesisë;
- b) I miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare: raportin e pjesëmarrjes së anëtarëve të Akademisë dhe stafit të administratës në panairin e librit në Tiranë, më 14-16 nëntor 2024, si dhe raportin e anëtarit korrespondent Salih Gashi për qëndrimin e tij në Amsterdam, më 17-19 nëntor 2024, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën shkencore ndërkombëtare: *Green energy, earth and environmental science 2024*;
- c) Diskutoi për çështjen e drekave zyrtare me rastin e promovimit të botimeve të ASHAK-ut. Kryetari Kraja tha se kohë më parë Kryesia ka marrë vendim që në drekë pas promovimeve të shkojnë panelistët (autori dhe ata që flasin për librin) dhe sekretari i seksionit përkatës. Por duke i parë raportet financiare, ai tha se ka vërejtur se Seksioni i Shkencave Shoqërore nuk e respekton këtë vendim dhe në drekë shkojnë i gjithë seksioni. Është për keqardhje, sepse vendimin e ka marrë Kryesia njëzëri, ku ka qenë edhe nënkryetarja dhe sekretarja e SSHSH-së, që i përkasin këtij SSHSH dhe janë pjesë e Kryesisë. Ai tha që nga viti i ardhshëm ndërpriten drekat pas

promovimeve. Me këtë u pajtuan edhe anëtarët e pranishëm të Kryesisë;

d) Diskutoi për kërkesën e Muzeut të Kosovës që për nder të 17 - shkurtit të organizohet një ekspozitë për akademik Fehmi Aganin. Kryetari Kraja tha se ASHAK-u nuk ka asnjë detyrim, pos t'ua vërë në dispozicion sallën organizatorit. Kërkesa u miratua.

XXII. Mbledhja e fundit e Kryesisë (LXIX) për vitin 2024 u mbajt më 13 dhjetor. Në këtë mbledhje Kryesia e shqyrtoi propozimin e Këshillit të projektit *Enciklopedia Shqiptare*. Propozimi u miratua dhe Kryesia vendosi që të realizohen pagesat për të angazhuarit në projektin Enciklopedia Shqiptare, për vitin 2025, si në vijim:

1. Zëvendëskryeredaktor në Redaksinë qendrore/ Kryeredaktor në Redaksinë vendore, në vlerë prej 567.50€ bruto.
2. Anëtar në Redaksinë qendrore, në vlerë prej 454.00€ bruto.
3. Anëtar në Redaksinë vendore, në vlerë prej 397.25€ bruto.
4. Anëtar i Këshillit të ESH, në vlerë prej 249.70€ bruto.
5. Redaktor përgjegjës në redaksinë e fushës, në vlerë prej 340.50€ bruto.
5. Anëtar në redaksinë e fushës, në vlerë prej 249.70€ bruto.
6. Sekretari i Redaksisë vendore/ qendrore, në vlerë prej 397.25€ bruto.
7. Vlera e pagesave është mujore. Realizimi i tyre fillon nga muaji janar 2025 dhe bëhet çdo tre muaj, deri më 31 dhjetor 2025.
8. Për të angazhuarit të hartohen kontratat me afat njëvjeçar.

9. Për sekretarin e Redaksisë vendore/qendrore pagesa realizohet nga kategoria paga dhe shtesa, sipas procedurave përkatëse.

10. Personi që është i angazhuar në projekt në disa pozita, paguhet vetëm në njërën prej tyre.

Kryesia vendosi edhe për realizimin e pagesave për strukturën e veçantë për projektin në fjalë. M. Kraja propozoi që të ndryshojnë vlerat e pagesave për vitin 2025, sepse është vërtetuar gjatë vitit 2024 se stafi i financave (Vjollca Hykolli, Hasime Maliqi, Lirijeta Bunjaku dhe Petrit Bashota), Dafina Kavaja dhe Valbona Olluri kanë pasur më shumë angazhim. Kryesia u pajtua njëzëri me propozimin e Kryetarit. U tha që: Pagesat bëhen për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025 dhe mund të ndryshojnë varësisht nga efikasiteti i punës; Vlerat e pagesave janë mujore, ndërsa realizimi i tyre bëhet çdo tre muaj; Të lartpërmendurit hartojnë raporte të punës çdo tre muaj për redaksinë vendore dhe sekretarin e Redaksisë vendore/qendrore; Për vitin vijues vlera e pagesave caktohet me vendim të ri, dhe se të lartpërmendurit do të kryejnë edhe punë të tjera që kërkohen nga Redaksia vendore dhe Sekretari i Redaksisë vendore/qendrore”.

Në vazhdim Kryesia:

- Vendosi për caktimin e znj. Rejahne Islami u.d. drejtor të departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit vetëm edhe për një periudhë gjashtëmujore, 1 janar-30 qershor 2025.

- E shqyrtoi kërkesën e prof.dr. Avni Berisha për qasje në dokumente zyrtare, nr.1053, dt. 05.12.2024. U tha që përkundër faktit që nuk ka

përfunduar ende procesi zgjedhor, prof. Berishës t’i ofrohen dokumentet e kërkuara bashkë me shkresë përcjellëse nga Kryesia e Akademisë. Shkresa është bashkëlidhur procesverbalit.

- E shqyrtoi dhe e miratoi menaxhimin e rrezikut për vitin 2024, i cili gjendet bashkëlidhur procesverbalit.

-Bazuar në Marrëveshjen ASHAK-IZUM, mori vendim që t’i vazhdohet kontrata zyrtares znj. Arta Kqiku, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025. U shqyrtua edhe raporti i punës së znj. Kqiku dhe u kërkuar që raporti të plotësohet me disa shënime shtesë lidhur me bibliografitë.

Dhe në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) Mori vendim për blerjen e veprës artistike të autorit Fatmir Krypa, grafikë: Shkëmbinjtë e bashkuar, dimensionit 100x70 cm, akuatintë me ngjyrë, 2021;

b) E shqyrtoi ankesën e prof.dr. Behxhet Mustafa nr. 1509, dt. 06.12.2024. U tha që t’i kthehet përgjigje nga Kryesia. Përgjigja për prof. Mustafën është bashkëlidhur procesverbalit;

c) E shqyrtoi edhe reagimin/ankesën, nr. 1588, dt. 12.12.2024, të profesorëve Eshref Qahili dhe Muhamet Ahmeti. U tha që edhe këtyre t’u kthehet përgjigje. Përgjigja i është bashkëlidhur procesverbalit.

PROJEKTI ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2024

Pas përcaktimit të numrit të fushave, emërtimit dhe ndarjes së tyre gjatë vitit 2023; pas hartimit të “Udhëzuesit për *Enciklopedinë shqiptare*”, që është një doracak dedikuar autorëve dhe redaktorëve për hartimin e artikujve enciklopedikë; pas konstituimit të Redaksisë vendore për Kosovën dhe të 29 redaksive të fushave, gjatë vitit 2024, me vendim të Redaksisë qendrore ka filluar puna intensive për hartimin e fjalësit të *Enciklopedisë shqiptare*, i cili tashmë pothuajse është përfunduar dhe së shpejti do të procedohet për miratim. Fjalësit janë hartuar për 29 fusha, të cilat mbulojnë të gjitha dijet shkencore, duke filluar nga albanologjia, arkeologjia, ekonomia, fushat politike-juridike, historia dhe shkencat sociale, artet, letërsia, trashëgimi kulturore, shkencat e natyrës, shkencat teknike, përfshirë trashëgiminë kulturore, sportin dhe diasporën. Gjatë vitit 2024 është arritur të kryhet faza përfundimtare e koordinimit dhe unifikimit të fjalësve në mes të redaksive të fushave për Kosovën dhe Shqipërinë, punë që ka zgjatur deri në dy muajt e parë të vitit 2025.

Takimet e janarit 2024 me redaksitë e fushave

Me qëllim të realizimit më efikas të punëve rreth projektit *Enciklopedia shqiptare*, gjatë muajit janar 2024 janë mbajtur takime me redaksitë e fushave për Kosovën sipas kësaj radhe: më 17 janar 2024 janë takuar fushat që mbulojnë periudha të ndryshme të historisë: Arkeologjia dhe Lashtësia,

Mesjeta, Bizanti dhe Periudha Osmane, Rilindja Kombëtare, Historia e shek. XX dhe Lufta e viteve 1998-1999; më 19 janar janë takuar redaktorët dhe anëtarët e redaksive të fushave Albanologjia dhe Letërsia; më 24 janar janë takuar redaksitë e fushave: Gjeografia fizike, Gjeografia sociale, Arsimi, Ekonomia dhe financat, Sistemet politike dhe drejtësia, Shkencat shoqërore (sociologjia, filozofia, psikologjia) dhe Religjioni; më 29 janar janë takuar fushat që mbulojnë artet dhe disa fusha të tjera: Artet pamore, Muzika, Artet skenike dhe Filmi, Trashëgimi kulturore, Ngulimet historike dhe diaspora, Informimi dhe Sportet; më 31 janar 2023 janë takuar redaksitë e fushave të natyrës dhe të shkencave teknike: Shkencat e natyrës (biologjia, kimia, matematike, fizika), Mjekësia dhe shëndeti, Shkencat e mjedisit, Bujqësia dhe blegtorja; Industrinë dhe teknologjitë, Energjitikë dhe energjetika, Gjeologjia dhe minierat, Inxhinieritë, Ndërtimtaria dhe Arkitektura.

Qëllimi i takimeve ka qenë avancimi i punëve rreth projektit *Enciklopedia shqiptare*, veçmas detyrat që dalin rreth hartimit të fjalësit të artikujve sipas fushave përkatëse. Në këto takime është kërkuar që lista preliminare e artikujve nga secila fushë të hartohet deri në fund të muajit mars të viti 2024, në mënyrë që në periudhën vijuese të harmonizohen këto lista me redaksitë e fushave të Shqipërisë dhe fushat me njëra-tjetrën. Gjithashtu është kërkuar që secili redaktor i fushës të bëjë raport me shkrim për punën e bërë, në të cilin përfshihet edhe raportet e anëtarëve të redaksive të fushave përkatëse.

Takimet e përbashkëta Prishtinë-Tiranë

Ndërkaq, po në gjysmën e parë të vitit 2024 vëmendja është përqendruar te hartimi i fjalësit të zërave të të gjitha fushave dhe për këtë qëllim janë zhvilluar takime të ndara me të gjitha redaksitë e fushave, takime këto që janë realizuar nga 29 prilli deri me 3 maj 2024.

Ashtu siç kemi rënë dakord në mbledhjen e fundit të Redaksisë Qendrore të *Enciklopedisë shqiptare*, gjatë këtyre takimeve dhe në vazhdim janë bërë përgatitjet e nevojshme për mbledhjet e përbashkëta të redaksive të fushave të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilat, sipas marrëveshjes, kësaj radhe janë mbajtur në Tiranë. Nga redaktorët e fushave, ndërkohë, është kërkuar raport për zhvillimin e këtyre takimeve, si dhe versioni i parë i fjalësit të harmonizuar Kosovë – Shqipëri. Për shkak të vonësive të palës së Shqipërisë, versionet e para të harmonizuara të fjalësve të fushave nuk janë realizuar nga të gjitha redaksitë, prandaj kjo vonesë u diskutua në mbledhjen e radhës të Redaksisë Qendrore, e cila u mbajt më 9 korrik 2024 në Tiranë.

Ndërkohë, më 30 maj 2024 u organizua mbledhja e Redaksisë vendore për Kosovën e *Enciklopedisë shqiptare*, në të cilën janë shqyrtuar të gjitha raportet dhe fjalësit e zërave të të gjitha fushave. Raportet e anëtarëve të Redaksisë vendore rreth fushave që mbulojnë ata, janë shqyrtuar edhe në takimin e përbashkët të dy redaksive vendore, mbajtur në Tiranë më 3 qershor 2024.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave që dalin nga projekti i *Enciklopedisë shqiptare*, kryeredaktori për Kosovën ka moderuar takimin e përbashkët të

redaktoreve të 29 fushave, si dhe të anëtarëve të Redaksisë vendore të Kosovës që u mbajt më 18-21 qershor në Durrës. Në takim kanë marrë pjesë edhe pala e Shqipërisë, në krye me akademik Shaban Sinanin, kryeredaktor i Redaksisë vendore të Shqipërisë i *Enciklopedisë shqiptare*.

Koordinimi Prishtinë-Tiranë

Në verën e vitit 2024, ndonëse është periudhë kur aktivitetet e Akademisë reduktohen ndjeshëm për shkak të pushimeve vjetore, puna rreth projektit *Enciklopedia shqiptare* ka vazhduar në mënyrë intensive. Edhe gjatë kësaj periudhe është përqendruar vëmendja te hartimi i fjalësit të zërave të të gjitha fushave dhe për këtë qëllim është analizuar shkalla e realizimit të të gjitha redaksitë e fushave, duke marrë për bazë analizat që janë bërë në Redaksinë Qendrore dhe në redaksitë vendore në takimet e mbajtura gjatë muajit qershor.

Ashtu siç ishte paraparë edhe me agjendën e miratuar nga dy redaksitë vendore, gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me sekretaren e Redaksisë vendore/qendrore të *Enciklopedisë*, znj. Lendita Pula, kemi iniciuar dhe koordinuar përgatitjet e nevojshme për mbledhjet e përbashkëta të redaksive të fushave të Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilat, sipas marrëveshjes, janë mbajtur në Prishtinë në datat 16-26 shtator 2024. Në këtë kuadër, kemi menaxhuar përgatitjet për këto takime, duke bërë shkresa dhe njoftimi dhe duke kërkuar nga anëtarët e Redaksisë vendore dhe redaktorët e fushave përgatitjet e nevojshme, që takimet të kenë sukses dhe të japin rezultatet e pritshme.

Ndërkohë, në komunikim me anëtarët e Redaksisë vendore të Kosovës, është kërkuar që versionet e integruara të fjalësve të të gjitha fushave të *Enciklopedisë shqiptare* të marrin formë të përmbyllur deri më 30 shtator 2024, në mënyrë që në muajt vijues të arrihet hartimi i fjalësit të plotë dhe i harmonizuar i të gjitha fushave të Enciklopedisë, i cili ishte paraparë të miratohej nga Redaksia Qendrore në dhjetor të vitit 2024, ose në janar të vitit 2025.

Me qëllim të përmbylljes së detyrave që dalin nga projekti i *Enciklopedisë shqiptare*, janë zhvilluar takime të ndara me redaktorët e redaksive të fushave dhe me anëtarët e Redaksisë vendore të Kosovës të *Enciklopedisë shqiptare* dhe është komunikuar vazhdimisht me përgjegjësit e redaksive përkatëse të Tiranës, me qëllim të koordinimit të agjendave dhe harmonizimit të çështjeve me interes për realizimin e projektit.

Faza përmbyllëse e fjalësit

Periudha në tre muajt e fundit të vitit 2024 ka qenë me aktivitete të ngjeshura, për shkak të afateve të paracaktuara më herët, që fjalësi i *Enciklopedisë shqiptare* të marrë formë përfundimtare pikërisht në këtë periudhë.

Me qëllim të hartimit të një fjalësi sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës, të koordinuar mes redaksive të fushave Kosovë-Shqipëri, ka qenë e domosdoshme të zhvillohen takime dhe të shkëmbehen mesazhe me përgjegjësit e Redaksisë vendore dhe Redaksisë qendrore nga pala e Shqipërisë. Po për këtë qëllim janë zhvilluar edhe një sërë takimesh dhe mbledhjesh me anëtarët e Redaksisë

vendore të Kosovës dhe, në disa raste, edhe me redaktorët e fushave të veçanta. Kështu, më 7 tetor 2024 është mbajtur mbledhja e Redaksisë vendore për Kosovën, në të cilën janë shqyrtuar fjalësit e fushave pas takimeve të përbashkëta të redaksive Kosovë-Shqipëri, që u mbajtën gjatë shtatorit në Prishtinë. Kjo mbledhje ishte njëkohësisht edhe parapërgatitje për takimin e përbashkët të redaktorëve të fushave dhe redaksive vendore Kosovë-Shqipëri, që u mbajt në Vërmicë më 10-12 tetor 2024.

Në takimin e Vërmicës u shqyrtuan të gjithë fjalësit e fushave dhe u identifikuan një sërë problemesh që lidhen me regjistrat, në mënyrë që të evitohen mangësitë dhe mungesat eventuale në secilin fjalës veç e veç. Po në këtë takim u kërkuar që redaksitë e fushave të hartojnë fjalësit e integruar deri më 15 nëntor 2024, duke evituar dallimet dhe mospërputhjet ndërmjet redaksive përkatëse Kosovë-Shqipëri. Ndërkohë, janë dorëzuar fjalësit e integruar dhe më 25 nëntor 2024 Redaksia vendore e Kosovës i ka shqyrtuar të gjithë fjalësit, duke nxjerrë përfundimin se disa fusha nuk i kanë bërë përmirësimet e nevojshme.

Me qëllim të përmbylljes së fjalësve të integruar, gjatë dhjetorit janë mbajtur në Tiranë takime të ndara redaksionale për disa fusha. Seria e parë e takimeve u mbajt në periudhën 19-21 dhjetor 2024 dhe në diskutime dhe shqyrtime morën pjesë redaktorët e fushave përkatëse nga Kosova dhe Shqipëria. Takimi i dytë i po këtij formati u mbajt më 20-23 janar 2025 po në Tiranë, në të cilën, në praninë e redaktorëve të fushave, u shqyrtuan fjalësit e fushave dhe u bënë vërejtjet dhe korrigjimet përkatëse.

Këto takime konsiderohen fazë
përmbyllëse e punës për koordinimin
dhe përfundimin e fjalësve të fushave
të *Enciklopedisë shqiptare*.

Kryeredaktori për Kosovën i
Enciklopedisë shqiptare

Akademik Mehmet Kraja, d.v.

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. *Historia e Letërsisë Shqipe*. - Jemi në vitin e dytë të punës intensive në projektin Historia e Letërsisë Shqipe të Akademisë sonë. Tashmë kanë përfunduar punët rreth strukturimit të pjesëmarrësve për realizimin e kësaj vepre të rëndësishme për kulturën shqiptare.

Redaksia e këtij projekti: Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Persida Asllani, Ali Aliu, Dhurata Shehri, Kujtim Shala, Nysret Krasniqi, ka bërë konstituimin e redaksive të veçanta dhe përgjegjësit për Kaptinat e mëdha të Historisë së Letërsisë Shqipe.

Janë përcaktuar artikujt themelorë, duke u bashkërenduar në sistemin e një vepre fundamentale për letërsinë dhe për kulturën shqiptare.

Vijon të ruhet parimi themelor i shkrimit të kësaj vepre: trajtimi i letërsisë shqipe që nga fillimet deri në kohën tonë dhe trajtimi i kësaj letërsie duke u nisur nga leximi estetik i letërsisë, duke pasur në vëmendje dhe një kohëtorë të kësaj letërsie.

Në një proces të njohjes dhe të kërkimit, shkruarit e Kaptinave të mëdha të kësaj Historie, gjatë vitit kanë vijuar kërkimet personale në qendra kulturore shqiptare, brenda dhe jashtë botës shqiptare.

Ky vit përmbillet me një intensitet të madh të punës, duke pasë mbaruar thuaja se gjysma e materies në fazën e deritashme të historishkrimit shqip. Në këtë punë janë përfshirë një mori autorësh të zgjedhur, përtej anëtarëve

të redaksisë, të cilët mbajnë detyrimet themelore të studimit dhe të koordinimit të bashkëpunëtorëve.

Ka pasur një koordinim ekselent ndërmjet Kryeredaktorit dhe anëtarëve të Redaksisë rreth punëve të veçanta dhe të strukturimit të tyre të përbashkët në një sistem studimi.

Përpos komunikimeve të përhershme individuale rreth shkrimit të Historisë së Letërsisë Shqipe, janë mbajtur edhe dy mbledhje të Redaksisë, në Prishtinë dhe në Tiranë, për të harmonizuar kërkimet në proces e sipër.

Na mban shpresa se me një ritëm të dëshiruar të punës, brenda vitit që vjen do të kemi të mbaruar lëndën e këtij Projekti të madh studimor të Akademisë sonë.

Raporti vjetor i projektit është miratuar në mbledhje të rregullt të Seksionit dhe më pas është miratuar edhe nga Kryesia e Akademisë.

2. *Leksikonët e termave të gjuhësisë*. - Projekti ka vazhduar edhe në vitin 2024, me hartimin e Leksikonit të termave të gramatikës. Deri tash janë identifikuar më shumë se 1300 zëra. Janë caktuar edhe hartuesit e zërave dhe po vijon puna e hartimit të tyre. Vazhdon puna në puna në projekt edhe gjatë vitit vijues. Drejtues të këtij projekti janë Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi.

3. *Arbnishtja e Zarës - rreziku i zhdukjes dhe gjasat e rimëkëmbjes*. - Arbnishtja e Zarës është një varietet i rrezikuar i shqipes. Kjo gjendje e bën këtë varietet përfundimisht të rrezikuar të zhduket. Gjasat për rimëkëmbjen e këtij varieteti varen nga gjasat që fëmijët e komunitetit të nisin ta mësojnë ta flasin. Arbneshët e Zarës janë një

komunitet që ka migruar nga zonat shqiptare të territoreve përreth liqenit të Shkodrës e që tash gjenden brenda kufijve shtetërorë të Malit të Zi. Komuniteti është i vendosur në një pjesë të Zarës dhe, sipas regjistrimeve jozyrtare, ka rreth 2000 pjesëtarë. Sipas vlerësimeve të mbështetura në vëzhgimet në terren rreth 250 syresh ende e flasin arbnishten, kryesisht si gjuhë komuniteti dhe për nevoja të amvisërisë. Të gjithë folësit e arbnishtes janë, së paku, bilingjë (kroatishtja) ose trelingjë (kroatishtja dhe italishtja). Mbas kërkimeve në Zarë dhe në Arkivin e Vjenës dhe vjeljes së materialeve është kryer puna kërkimore. Projekti pritet të përfundojë me një studim. Bartës të projektit janë Bardh Rugova e Rexhep Ismajli.

Pritet që Studimi dhe Fjalori i arbnishtes së Zarës të jetë i gatshëm për botim në vitin 2025.

4.Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. - Projekti do të vazhdojë edhe në vitin 2024. Duhet të krijohet sa më parë grupi për hartimin e Fjalorit të shqipes së shkruar në Kosovë në shekullin XX.

Është krijuar grupi për hartimin e *Fjalorit të lematizuar të shqipes së shkruar në Kosovë, në shek. XX* dhe pritet të jetë i gatshëm në vitin 2025. Kërkohet që grupi i punës të parqesë raport.

TUBIME SHKENCORE

1.Konferencë shkencore ndërkombëtare: *Për krijimtarinë e Shtjefën Gjeçovit*, duke shënuar 150-vjetorin e lindjes së autorit dhe kërkuesit të rrallë të botës shqiptare.

Konferenca shkencore ndërkombëtare: *Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit* është mbajtur më 14 tetor 2024, në Prishtinë. Janë paraqitur 24 studiues të njohur nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Italia. Materialet konferencës do të botohen në vitin 2025.

2. Tryezë shkencore: *Krijimtaria e Ali Aliut* është mbajtur më 2 prill 2024, në Prishtinë. Kanë marrë pjesë 10 studiues, nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Italia.

BOTIME

1. Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi: *Leksikoni i termave të gramatikës*. Është kjo vepra më e rëndësishme nga seria e Leksikoneve të termave të gjuhësisë. Vepra mbështetet në përkufizimin, shpjegimin dhe interpretimin e termave të gramatikës. Krijimi i Leksikonit në vështrimin enciklopedik, duke e pasur në rend të parë gjuhësinë shqiptare, ndihmon shumë normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe.

Leksikoni i termave të gramatikës është paraparë të botohet në vitin 2025.

2. Nazim Lleshi, Bardh Rugova: *Fjalor i turqizmeve në gjuhën shqipe*- Është një libër reference, me gjithsej 10.800 zëra - fjalë, që kanë hyrë në shqipen përmes turqishtes. Në këtë rrafsh janë futur edhe fjalë arabe e perse, por për nga analiza fonetike dalin të kenë hyrë përmes turqishtes. Në Fjalor janë përfshirë, si aneks, edhe emra patronime. Dorëshkrimi ka 600 faqe. Ky dorëshkrim, "Fjalori i turqizmeve në gjuhën shqipe", është më gjithëpërfshirës dhe më i plotë se veprat pararendëse të këtij lëmi.

Nazim Lleshi, Bardh Rugova: *Fjalor i turqizmeve në gjuhën shqipe* është botuar në dhjetor të vitit 2024. Libri ka 479 faqe.

3. Muhamet Hamiti: *Bota letrare*. Libri që ka 452 faqe është botuar në qershor 2024.

4. *Arbnishtja e Zarës*.- Botimi pritet të dalë në vitin 2025.

5. *Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Evropës Veriore*. Vëllimi me materialet e konferencës që ka 519 faqe ka dalë në qershor 2024.

6. *Krijimtaria letrare e Ali Aliut*. Libri i tryezës shkencore është botuar në qershor 2024 dhe ka 117 faqe.

7. *Studime, nr.30*. - Revista Studime që boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera, del një herë në vjet. Përmbillet në fund të vitit kalendarik dhe del në muajt e parë të vitit. Përgatitet nga redaksia e drejtuar nga kryeredaktori Zejnullah Rrahmani.

Është botuar revista *Studime nr. 30* dhe ka 363 faqe.

PROMOVIME

1. Promovimi i kolanave të botimeve të ASHAK-ut: *Të huajt për shqiptarët*, në pesë vëllime dhe *Letëria shqipe, fillimi i shekullit XXI*, në katër vëllime është bërë në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës, më 23 prill 2024;

2. Promovimi i botimeve të ASHAK-ut: Kujtim Shala-Kënga e cjamin dhe *Shqipja standarde sot*, në Panairin e librit akademik dhe shkencor, në Tiranë, më

23 prill 2024;

3. Promovimi i botimeve: Muhamet Hamiti- *Bota letrare dhe Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Evropës Veriore*, është bërë më 16 tetor, në mjediset e ASHAK-ut;

4. Promovimi i botimeve: Krijimtaria letrare e Ali Aliut, Muhamet Hamiti- *Bota letrare dhe Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Evropës Veriore*, është bërë në Panairin e librit 2024 në Tiranë.

Sekretari i Seksionit

Akademik Sabri Hamiti, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHQËRORE

PROJEKTE

1. *Gjendja dhe kontributi i shkencave ekonomike në Kosovë* - Projekti ka përfunduar dhe dokumenti i projektit do të printohet këtë vit. Promovimi i projektit do të bëhet pasi të jetë gati edhe pala e ASHSH-së.

Bartës të projektit janë: akademike Justina Shiroka Pula; anëtar korrespondent Besnik Krasniqi dhe akademik Isa Mustafa.

2. *Kosova 1966-2008*.- Projekt dyvjeçar, i paraparë të përfundojë në vitin 2024, është në përfundim e sipër. Bartës të projektit janë: akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj. Bashkëpunëtor në projekt: dr. Fehmi Rexhepi.

3. *Barazia gjinore, sfidë e shoqërisë kosovare*. - Projekti ia ka filluar me vonesë dhe paraqitja e Raportit *Barazia gjinore, sfidë e shoqërisë kosovare* do

të bëhet gjatë vitit 2025 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave dhe institucioneve që merren me studimin dhe përparimin e barazisë gjinore.

TUBIME SHKENCORE

1. Simpozium shkencor: *Konferenca e Bujanit dhe shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore* është mbajtur me datë 05 prill 2024. Këshilli organizues i Konferencës: Jusuf Bajraktari, kryetar, Frashër Demaj, sekretar, Marenglen Verli, anëtar, Arsim Bajrami, anëtar Beqir Meta, anëtar dhe Marenglen Kasmi, anëtar.

2. Simpozium shkencor: *Ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe konkurrueshmëria*. - është mbajtur me datë 18 prill 2024. Këshilli organizues i simpoziumit: Akademik Isa Mustafa, Prof. dr. Muhamet Mustafa, Anëtar korrespondent Besnik Krasniqi.

3. Konferenca shkencore: *25 vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe i çlirimit të Kosovës: një çerek shekulli shtet ndërtim, sfida dhe arritje – qasje multidisiplinare* është organizuar me datë 10 qershor 2024 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në përvjetorin historik të fitores së NATO-s, aleancës më të madhe dhe më të suksesshme ushtarake dhe të vlerave të përbashkëta të anëtarëve të saj, paqes, demokracisë, lirisë dhe sundimit të ligjit.

Konferenca është organizuar në kuadër të Protokollit për zbatimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor shkencor dhe artistik ndërmjet ASHAK-ASHSH (për periudhën 2024 -2025)

Hapja e Konferencës ishte solemne. Me fjalë përshëndetëse pjesëmarrësve iu

drejtuan Akademik Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK-ut dhe Akademik Skënder Gjinushi, Kryetar i AshSh-së dhe me një fjalë rasti Kryeministri i Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Albin Kurti. Në sesionin solemn të Konferencës u paraqitën me kumtesa ish- presidenti i Shqipërisë Alfred Moisiu dhe ish- Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu. Në punimet e Konferencës morën pjesë me kumtesa katërmëdhjetë studiues.

4. Konferenca shkencore *Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024* e paraparë në kuadër të Protokollit për zbatimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor shkencor dhe artistik ndërmjet ASHAK-ASHSH (për periudhën 2024 -2025), është organizuar më 2 korrik 2024, në përvjetorin e Deklaratës Kushtetuese të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2 korrik 1990. Hapja e Konferencës ishte solemne dhe me nga një fjalë rasti iu drejtuan pjesëmarrësve protagonistët e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, Z. Ilaz Ramajli, Z. Muharrem Shabani dhe me kumtesë të veçantë, prof. dr. Ismet Salihu. Në punimet e Konferencës u paraqitën me kumtesa 15 studiues.

5. Konferenca shkencore ndërkombëtare: *Çështjet bashkëkohore të biznesit dhe ekonomisë*, është mbajtur me titull: *Përballja me ndryshimet në një botë dinamike* më 4 tetor 2024. Këshilli organizues i Konferencës: anëtar korrespondent Besnik Krasniqi, akademik Isa Mustafa dhe akademike Justina Shiroka Pula.

6. Tryeza shkencore Akademik Fehmi Agani – *personalitet shumëdimensional (me rastin e 25-vjetorit të vrasjes)* u mbajt më 18 dhjetor 2024, në

organizim të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

BOTIME

1. Valbon Bytyqi: *Ujërat dhe popullsia në Kosovë (Shpërndarja territoriale e ujit dhe e popullsisë në Kosovë)* është botuar dhe gjithashtu është organizuar paraqitja e botimit me datë 9 tetor 2024. Botimi ka 604 faqe (40 tabakë shtypi).
2. Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi: *Gjeopolitika, territori konflikti - Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve* është botuar dhe është bërë paraqitja e botimit me datë 22 maj 2024. Botimi ka 570 faqe (36 tabakë shtypi).
3. Materialet e simpoziumit shkencor: *Ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe konkurrueshmëria* që është mbajtur më 18 prill 2024, janë botuar. Botimi ka 263 faqe (16,5 tabakë shtypi).
4. Materialet e konferencës shkencore: *Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë, Shqipëri dhe Rajon*, që është mbajtur me datë 6 dhe 7 tetor të vitit 2023, është botuar si përmbledhje e veçantë. Botimi ka 701 faqe (48 tabakë shtypi).
5. Materialet e simpoziumit shkencor: *Konferenca e Bujanit dhe shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore*, të mbajtur me datë 05 prill 2024, është botuar dhe ka 175 faqe.
6. Materialet e Projektit dyvjeçar: *Kosova 1966-2008* pritet të dorëzohet për botim gjatë vitit 2025. Botimi do të ketë 550 faqe (31 tabakë shtypi).

7. Materialet e konferencës shkencore: *Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë, Shqipëri dhe Rajon*, që është mbajtur me datë 6 dhe 7 tetor të vitit 2023, është botuar si përmbledhje e veçantë. Botimi ka 701 faqe (48 tabakë shtypi).

8. Materialet e konferencës shkencore: *25 vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekulli shtet ndërtim, sfida dhe arritje – qasje multidisiplinare*, të organizuar me datë 10 qershor 2024, është botuar dhe ka 263 faqe.

9. Materialet e konferencës shkencore *Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024* të mbajtur më 2 korrik 2024, është botuar dhe ka 348 faqe.

10. Materialet e tryezës shkencore Akademik Fehmi Agani – personalitet shumëdimensional (me rastin e 25-vjetorit të vrasjes), një pjesë janë botuar në revistën *Studime shoqërore* 11 dhe pjesa tjetër do të botohen në revistë *Studime shoqërore* 12.

11. Revista *Studime shoqërore*, nr. 11 - Revistë vjetore është botuar dhe i ka 377 faqe.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Projekti: *Trajtimi i sistemeve ujore me procese të integruara/hibride*, i paraqitur nga akademik Salih Gashi, ishte projekt 2 - vjeçar (2023-24), në

kuadër të fushës së shkencave të natyrës dhe mjedisit dhe është realizuar në tërësi. Objektivi kryesor i projektit ishte: kombinimi i proceseve të ndryshme për të eliminuar ndotësit e ndryshëm nga sistemet ujore. Në kuadër të këtyre proceseve së pari janë përdorur substanca të ndryshme me prejardhje bimore të cilët kanë shërbyer si ndajthithës për eliminim paraprak të substancave inorganike dhe organike. Gjetja e ndajthithësve efikas, të cilët kanë kosto të lirë është një kontribut i rëndësishëm në kuadër të projektit. Në kuadër të rezultateve të fituara të projektit në revistën *Desalination and Water Treatment* në vitin 2024 është botuar punimi me titull “*A versatile study of single and binary removals of Pb(II) and Cd(II) ions from aqueous solutions using pine cone as biosorbent*” i autorëve B.S. Thaçi, S.T. Gashi, N.M. Daci, F. I. Podvorica, F. Sopaj.
<https://doi.org/10.1016/j.dwt.2024.100465>

Më tutje për eliminim të plotë të substancave që janë ndotës të ujërave janë përdorur proceset membranore. Ato kanë përparësi ndaj teknologjive ekzistuese konvencionale për shkak të selektivitetit, shpenzimit të vogël të energjisë, produktivitetit të lartë, kostonë së moderuar të raportit të performancës dhe ndërtimi modular kompakt, por që kanë sfida kryesore shtupimin ose mbylljen e poreve të tyre. Rezultatet janë publikuar në punimin në vazhdim:

G. Hasani, F. I. Podvorica, A. Abdelkader, S. T. Gashi, B. S. Thaçi. Impact of modified coal with alkyl or mixed alkyl-aryl layer on the performance of heterogeneous Cellulose Acetate Membranes. *Pol. J. Environ. Stud.* Vol.X,

No.X, 2024.

<https://doi.org/10.15244/pjoes/193911>

Rezultatet e fituara të gjithë projektit janë paraqitur në raportin vjetor të projektit për vitin 2024.

2. Vazhdim i projektit: *Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë-Shqipëri*” Projekt i përbashkët dyvjeçar në mes ASHAK-ut dhe ASHSH-së në sektorin e energjisë për vitet 2022-2024. Dy akademitë kanë vazhduar të punojnë në këtë projekt të përbashkët për të hulumtuar dhe analizuar në shkallë të gjerë kapacitetet prodhuese energjetike në të dy vendet së bashku me ekspertët e lëmenjve të ndryshëm dhe me institucionet relevante qeveritare me qëllim të përgatitjes së një platforme të përbashkët energjetike për zhvillim të qëndrueshëm të sistemit energjetik në të dy vendet.

Megjithatë puna nuk ka avancuar shumë për shkak të ngecjeve në sigurim të informacioneve të shkallës së gjerë në mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me institucionet relevante në Shqipëri. Në fund të këtij viti ishte paraparë të organizohet një Simpozium shkencor për energjinë në Tiranë, si edhe një takim i grupeve punuese, në Tiranë, por ky Simpozium u shty për datën 7 shkurt 2025. Nga materiali i siguruar deri tani, si dhe duke u bazuar në konkluzionet e Simpoziumit të Energjisë i cili u mbajt më 7 shkurt 2025 dhe nga një takim përmbledhës i dy grupeve punuese që do të mbahet në Prishtinë do të fillojë përgatitja e draftit të raportit i cili mendohet të kompletohet deri në fund të muajit mars 2025.

TUBIME SHKENCORE

1. Konferenca shkencore: Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ASHAK) në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 27 dhe 28 maj 2024 e bashkorganizuan Konferencën shkencore: *Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura*. Këshillin organizativ të kësaj Konference e përbënin: akad. Salih Gashi kryetar i këshillit organizues shkencor, akad. Fejzullah Krasniqi, akad. Neki Frashëri, akad. Ilirjan Malollari, prof. Fetah Podvorica, prof. Myzafere Limani, prof. Besnik Baraj, prof. Roza Allabashi dhe prof. Valbona Kolaneci. Në kuadër të konferencës u paraqitën me prezantime 32 pjesëmarrës. Në ditën e parë u paraqiten 19 kumtesa. kurse në ditën e dytë u paraqitën 13 kumtesa.

BOTIME

1. Isuf Krasniqi dhe Avni Alidemaj: Ndryprerësit e tensionit të lartë (110, 220 dhe 400) kV me gaz SF₆ – proceset tranzitore. Libri është botuar në prill 2024.

2. Myzafere Limani: Akustika, të folurit dhe muzika”- Ky libër i përmban shtatë kapituj.

Libri është botuar në tetor 2024.

3. Fetah I. Podvorica: Veshja elektrokimike e sipërfaqeve të materialeve me molekula organike.

Libri është botuar në tetor 2024.

4. Revista Research-Kërkime nr. 28.

Aktualisht është bërë gati botimi i numrit 28 të kësaj reviste, i cili do të dërgohet për botim deri në fund të muajit shkurt 2025. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

5. Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë-Shqipëri. Ky raport pritet të përfundojë deri më 31 mars 2025.

AKTIVITETE TË TJERA

1. Organizim dhe kontribut në kuadër të konferencës ndërkombëtare për nanoteknologji me titull: *NanoBalkan 2024* të organizuar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Institutit NanoAlb dhe nga Institutet kryesore të nanoteknologjisë në Barcelonë (ICREA - ICN2 – BIST), si dhe Fondacioni Phantoms. Konferenca është mbajtur prej 28 tetor deri më 1 nëntor 2024 në Tiranë. Prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut ka mbajtur ligjëratën me titull “Chemical grafting of coal surface with mixed alkyl-aryl layers”, si dhe ligjëratën me titull “Tethering lignite surface with organic layer” në kuadër të seminarit të 5-të të përbashkët trilateral Shqipëri – Japoni – Spanjë si pjesë e programit të konferencës.

2. Seksioni i Shkencave të Natyrës e ka ndarë Çmimin stimulues nga lëmi i shkencave të natyrës i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në mesin e 26 kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurs, nga Këshilli janë përzgjedhur njëzëri:

Prof. asoc. Armond Daci, (I lindur më 18 nëntor 1988)

Prof. ass. Bukuriye Hoxha, (e lindur më 28 qershor 1996)

Ceremonia solemne e ndarjes së Çmimit stimulues nga lëmi i shkencave të natyrës. është bërë më 28 qershor 2024 në lokalet e ASHAK-ut.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica,
d.v.

ansambli muzikor *Academia Albanica* i udhëhequr nga maestro Eno Koço.

SEKSIONI I ARTEVE

1. *Rauf Dhomi: Vepra kamerale.*-
Dorëshkrimi është botuar.

EKSPOZITA

2. Më 26 nëntor u hap ekspozita e autorit Fatmir Krypa. Ekspozita u hap para një auditoriumi të gjerë. Fjalën e hapjes e mbajti akademik Mehmet Kraja, kryetar i ASHAK-ut, ndërsa për ekspozitën foli akademik Eqrem Basha. Në fund, autori Fatmir Krypa mbajti një fjalë rasti dhe falënderoi ASHAK-un për organizimin e Ekspozitës.

KONCERTE

1.Koncert me vepra autoriale të Rauf Dhomit, në Tiranë. Koncerti ka qenë i paraparë në Protokollin paraprak të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, por ka mbetur i parealizuar nga ASHSH-ja. Edhe këtë vit nuk ka njoftim për mbajtjen e koncertit.

2. Më 10 qershor 2024, në mjediset e ASHAK-ut u mbajt koncerti festiv për nder të 25-vjetorit të Ditës së Çlirimit të Kosovës. Në koncert performoi

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2024

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit Nr.08/L-260 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ka qenë në vlerë totale prej 1,697,045.00 €.

(Shihni tabelën Nr.1 të ndarjeve buxhetore në kategori ekonomike)

Buxheti fillestar i ASHAK-ut sipas Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (1,672,045.00 €)			
Pagat dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe Transfere
181,886.00	770,000.00 €	5,000.00 €	715,159.00 €

Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/193 të dates 13.03.2024, ASHAK-ut i janë aprovuar mjete financiare financiare shtesë në kategorinë paga dhe shtesa në vlerë prej 25,000.00 €, për pagesën e strukturës së veçantë për realizimin e projektit “ Enciklopedia Shqiptare”.

(Shihni tabelën Nr.2 të ndarjeve buxhetore në kategori ekonomike)

Buxheti i ASHAK-ut pas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/193 të datës 13.03.2024 (1,697,045.00 €)			
Pagat dhe shtesa	Mallra e shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe Transfere
206,886.00 €	770,000.00 €	5,000.00 €	715,159.00 €

Buxheti final i alokuar në SIMFK për vitin 2024, ka qenë gjithsej 1,678,661.40 €. Në kategorinë paga dhe shtesa me Vendimin Qeverisë së Kosovës Nr.03/239 i datës 24.12.2024 ASHAK -ut i janë zvogëluar 18,383.60 €.

(Shihni tabelën Nr.3 të ndarjeve finale buxhetore në kategori ekonomike)

Buxheti i ASHAK-ut pas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/193 të datës 13.03.2024 (1,678,661.40 €)			
Pagat dhe shtesa	Mallra e shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere
188,502.40 €	770,000.00 €	5,000.00 €	715,159.00 €

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, ASHAK-u ka pasur në dispozicion edhe mjete financiare nga donatori *Salbating Internacional* të bartura nga viti 2024 në vlerë prej 8,636.99€, si dhe depozita të reja nga donatori IZUM Slloveni në vlerë prej 6,000.00€ për pagesën e punonjësës së angazhuar rreth programit COBISS. (Shihni tabelën Nr.4)

Mjetet në dispozicion - të përfituara nga donacionet		
Salbating International	8,636.99€	4,636.99 € - për blerjen e librave; 4,000.00€ - për ndarjen e Shpërblimeve mbështetëse;
IZUM - Slloveni	6,000.00€	Biblioteka e ASHAK-ut – kompensimi financiar për punonjësën e angazhuar rreth Programit COBISS

Po ashtu gjatë vitit 2024 ASHAK-u ka realizuar të hyra nga shitja e botimeve të saj në vlerë prej 5,183.41 €, të cilat janë depozituar në llogarinë e Thesarit të Kosovës.

Duhet të theksojmë se realizimi i buxhetit, me gjithë shtimin e obligimeve nga MFPT-ja, vështirësive rreth realizimit të honorareve dhe pagesave të tjera, me gjithë mungesën e stafit në Departamentin për Buxhet dhe Financa, fal nivelit të lartë profesional, angazhimit dhe përkushtimit maksimal të stafit administrativ, e sidomos të Departamentit për Buxhet dhe Financa, buxheti i ASHAK-ut arriti shkallën e realizimit prej 95.5%.

Të gjitha ndryshimet në vlerat fillestare të planifikuara për shpenzimet sipas kodeve ekonomike, janë realizuar sipas udhëzimeve të Menaxhmentit të ASHAK-ut.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2025



PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2025

PROJEKTI ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE

Është projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i financuar nga qeveritë përkatëse të të dy vendeve. Projekti është afatmesëm dhe synohet të realizohet për pesë vjet.

Pas hartimit dhe miratimit të protokolleve dhe të rregulloreve për mënyrën e financimit dhe për ngritjen e redaksive qendrore, vendore dhe redaksive të fushave, gjatë vitit 2023 u përmbyll pjesa kryesore e punëve organizative (me një përfshirje prej 116 vetash në redaksitë për Kosovën), teksa më 2024 filloi puna për hartimin e fjalësve të artikujve shkencorë të Enciklopedisë Shqiptare, nga 29 fushat që mbulojnë të gjitha dijet shkencore, duke filluar nga albanologjia, arkeologjia, ekonomia, fushat politike-juridike, historia dhe shkencat sociale, artet, letërsia, trashëgimi kulturore, shkencat e natyrës, shkencat teknike, përfshirë trashëgiminë kulturore dhe diasporën. Deri së fundi është arritur të kryhet faza e parë e koordinimit dhe unifikimit të fjalësve në mes të redaksive të fushave për Kosovën dhe Shqipërinë, punë që do të zgjasë deri në mbarim të vitit 2024.

Në vitin vijues, 2025, parashihet të bëhet kategorizimi i artikujve dhe të caktohen autorët, që do të jenë hartuesit e afërsisht 10 mijë artikujve nga të gjitha redaksitë e fushave, në Kosovë dhe në Shqipëri. Në këtë vit

priten të realizohen artikujt e parë, kryesisht të tillët që janë kategorizuar si artikuj të vegjël, për të vazhduar më tej me artikuj të mesëm, të mëdhenj, artikuj përmbledhës dhe monografikë. Gjatë vitit 2025 do të identifikohen ekipet e redaktorëve, të cilët që në fillim do të merren me unifikimin metodologjisë së shkrimit dhe me argumentimin shkencor të artikujve, përfshirë rregullsinë e citimeve dhe të referencave.

50-VJETORI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Në dhjetor të vitit 2025 bëhen 50 vjet nga themelimi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, institucionit më të rëndësishëm dhe më të lartë të dijes shkencore dhe të krijimtarisë artistike. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka qenë dhe është simbol i ngritjes së Kosovës në periudhën më të re të historisë së saj, simbol i emancipimit të përgjithshëm, i ngritjes diturore dhe prosperitetit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, përfshirë edhe pavarësimin e saj dhe konsolidimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Këtë përvjetor Akademia, ndër të tjera, do ta shënojë me një botim të veçantë, në të cilin do të përfshihen të gjitha të dhënat relevante lidhur me këtë institucion dhe me anëtarët e saj, që

nga themelimi deri në ditët e sotme. Botimi do të përgatitet nga një redaksi e veçantë, e përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha seksioneve dhe në të do të përfshihen tekste autoriale, biografi dhe bibliografi të anëtarëve, zhvillimet më të rëndësishme për institucionin dhe ngjarje që kanë shënuar 50 vjet të punës së Akademisë.

Gjithashtu, në dhjetor të vitit 2025 do të mbahet një mbledhje solemne e Kuvendit të Akademisë, në të cilën do të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve drejtuese të vendit dhe përfaqësues të Akademive, me të cilët ASHAK-u ka marrëdhënie më të ngushta: përfaqësuesi i ALLEA-s, përfaqësuesi i Leopoldina-s, dhe përfaqësues të akademive të Austrisë, Sllovenisë, Kroacisë, Italisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Bullgarisë dhe Turqisë.

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. *Historia e Letërsisë Shqipe*. Në vitin 2025 vijon puna në Projektin afatmesëm Historia e letërsisë shqipe (nga fillimet deri më sot) me angazhimin e kapaciteteve të plota të redaksive të periudhave letrare dhe të bashkëpunëtorëve të zgjedhur. Synohet që brenda këtij viti të përfundojnë shkrimet për autorët dhe periudhat, për të vijuar me redaktimin përfundimtar të teksteve. Po ashtu, do të punohet për përgatitjen përfundimtare të Projektit për botim. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e bën financimin e Projektit. Në këtë fazë të punës duhet të

parashihen mjete shtesë për sigurimin e materialeve plotësuese për përgatitjen përfundimtare të botimit. Drejtues i këtij Projekti është Akademik Sabri Hamiti.

2. *Leksikonet e termave të gjuhësisë*. Ky Projekt vazhdon në vitin 2025 me hartimin e *Leksikonit të termave të gramatikës*, që është pjesa më e rëndësishme e Projektit. Synohet që kjo punë të kryhet brenda vitit 2025. Drejtues të Projektit janë: Akademik Rexhep Ismajli dhe Anëtarët korrespondentë Bardh Rugova e Shkumbin Munishi.

TUBIME SHKENCORE

1. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare: *Studimet albanistike te sllavët e jugut*. Konferenca do të mbahet në muajin tetor të vitit 2025 në Prishtinë, me pjesëmarrje të gjerë të studiuesve shqiptarë dhe të studiuesve të huaj. Konferenca do të zgjatë dy ditë. Materialet e kësaj Konference do të botohen në Akademinë tonë, ashtu si janë botuar të gjitha materialet e konferencave të këtij niveli të lartë të studimeve. Konferenca do të mbahet në Prishtinë dhe në të parashihet të marrin pjesë rreth 60 pjesëmarrës, prej tyre rreth 30 nga jashtë Kosovës.

2. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare: *Disidenca letrare shqipe*. Kjo Konferencë do të zgjatë dy ditë. Pjesëmarrës janë, studiues të njohur të fenomenit të “disidencës letrare” dhe të “disidencës letrare-politike” në botën shqiptare, duke studiuar fenomenin dhe reflektimin e tij në letërsinë bashkëkohore shqipe. Konferenca do të mbahet në Prishtinë në muajin qershor 2025. Parashihet të

marrin pjesë rreth 30 pjesëmarrës, prej tyre rreth 10 nga jashtë Kosovës.

BOTIMET

1. Norbert Jokl: Vepra IV, vëllimi që përgatitet nga Akademik Rexhep Ismajli do të ketë rreth 500 faqe. Ky do të jetë vëllimi përmbyllës i botimit të veprave të albanologut të madh.

2. *Këshilli ndërkademi për gjuhën shqipe* (materiale e dokumente). E përgatit akademik Rexhep Ismajli. Dorëshkrimi do të ketë rreth 250 faqe.

3. Bardh Rugova, Mehmet Halimi, Shkumbin Munishi, Nebih Caka: *Fjalor i lematizuar i shqipes së shkruar në Kosovë në shek XX*. Dorëshkrimi do të rreth 700 faqe.

4. Bardh Rugova dhe Rexhep Ismajli: *Arbnishtja e Zarës*: Studim. Kërkimet në projekt kanë përfunduar. Pritet botimi gjatë vitit 2025 dhe do të ketë 250 faqe.

5. Françesko Altimari: *Studime arbëreshe (dhe përreth) në udhëkryqin italo-ballkanik*. Është vepër e re e studiuesit të njohur arbëresh, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. Vepra përfshin studime për gjuhësinë, letërsinë dhe kulturën arbëreshe në kontekstin shqiptar dhe ballkanik. Vepra është recensuar dhe ka rreth 300 faqe. Pritet që autori të përkthejë në shqip disa studime që janë vetëm në italishte.

6. Sabri Hamiti: *Kanoni – (Ese për letërsinë shqipe)*. Dorëshkrimi trajton fenomene karakteristike të letërsisë shqipe brenda sistemit të saj dhe në komunikim me letërsi të tjera. Nëpër kapituj të veçuar tematizohen çështje letrare të krijimit dhe të komunikimit, të cilat kapërcejnë përkufizimet

kohore. Dorëshkrimi, botimi, komunikimi, vlerësimi në sistem tematizon Historinë, Rrëfimin, Dëftimin, Realen, Kategorinë, Transformimin, Gjuhën, Kanonin. Përfundimisht: shkrimin letrar sithurje estetike lidhur me njohjen humane për të synuar veprën që komunikon me kohët dhe hapësirat shpirtërore. Dorëshkrimi është i gatshëm dhe ka rreth 350 faqe.

7. Rexhep Ismajli: *Historia dhe prejardhja e gjuhës shqipe (titull pune)*. Dorëshkrimi diskuton në nivel shkencor rrjedhat dhe argumentimet për prejardhjen e gjuhës shqipe të studiuesve të ndryshëm. Autori sublimon idetë dhe kërkimet e tij për këtë temë. Një libër që pritet me interesim të gjerë shkencor. Dorëshkrimi do të ketë rreth 300 faqe.

8. Kujtim Shala: *Metonimia*. Dorëshkrim me studime për poetikën historike shqipe, bazuar te dukuri thelbësore, si: raporti i letërsisë shqipe me të vërtetën historike, natyra e ideologjisë letrare, si dhe vepra përfaqësuese të këtyre dukurive dhe të letërsisë shqipe në përgjithësi. Vepra është strukturuar në tri pjesë tematike: I. E vërteta e letërsisë; II. Ideologjia e letërsisë; III. Metonimia. Dorëshkrimi ka rreth 480 faqe dhe do të jepet për botim në shtator 2025.

9. *Konferenca shkencore ndërkombëtare: Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit në 150 – vjetorin e lindjes së tij. Parashihet* që studimet e paraqitura do të përfshihen në një vëllim rreth 400 faqesh.

10. *Studime 21*. Revistë vjetore e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që vijon të botojë artikuj kritikë e studimorë për fenomenet e letërsisë

dhe të gjuhës shqipe; edhe në komunikime me letërsitë e tjera. Më 29 mars 2024 është zgjedhur Redaksia e re e revistës, me mandat trevjeçar, me këtë përbërje: Akademik Zejnullah Rrahmani, kryeredaktor; Akademik Françesko Altimari, anëtar; Akademik Kujtim Shala, anëtar; Anëtar korrespondent Bardh Rugova, anëtar; dhe anëtar korrespondent Nysret Krasniqi, anëtar.

PROMOVIMI I BOTIMEVE

Promovimet e botimeve të Seksionit bëhen në ASHAK, në panairin vjetor të botimeve shkencore dhe akademike dhe në panairot e tjera.

Sekretari i Seksionit

Akademik Sabri Hamiti, d.v.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

TUBIME SHKENCORE

1.Konferencë shkencore ndërkombëtare: *Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon (II)*.

Kjo Konferencë është paraparë me Protokollin për Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2025.

Konferenca planifikohet të mbahet në muajin tetor 2025 në Tiranë.

BOTIMET

1.Arsim Bajrami: *Konferenca e Rambujesë dhe intervenimi i NATO-s në Kosovë*. Konferenca e Rambujesë, paraqet një ngjarje të rëndësishme në proceset e shtet-krijimit dhe pavarësisë së Kosovës. Konferenca e Rambujesë paraqet ngjarjen e parë historike në të cilën bashkësia ndërkombëtare përmes Grupit të Kontaktit vendosi që të gjejë një zgjidhje për statusin e Kosovës. Pas padrejtësive historike 86 vite më herët, kur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër me 1913, fuqitë e mëdha copëtuan trojet etnike shqiptare, Konferenca e Rambujesë ishte rasti i parë kur shqiptarët e Kosovës ishin thirrur në një konferencë për të vendosur për fatin e tyre. Pra kemi të bëjmë me përpjekjen për të përmirësuar gabimet dhe padrejtësitë historike ndaj shqiptarëve të Kosovës, për t'ua njohur të drejtat e mohuara për një shekull për të pasur shtetin e tyre në territoret etnike shqiptare. Edhe pse kjo Konferencë nuk solli pavarësinë, falë rezistencës shekullore, luftës heroike të UÇK-së dhe bombardimeve në NATO-s, drejtësia e mohuar ua ktheu shqiptarëve si popull autokton dhe liridashës.

Synimi kryesor i Konferencës ishte ndalja e gjenocidit serb dhe luftës përmes një marrëveshjeje të përkohshme paqësore midis Kosovës dhe Serbisë. Kjo konferencë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për tri arsye kryesore. E parë: ajo mundësoi ndërhyrjen ndërkombëtare të NATO-s në Kosovë në një fazë të hershme të luftës, pra një intervenim preventiv të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë përmes një fushate masive të bombardimeve, që për shtatëdhjetë e tetë ditë e detyruan Serbinë të

kapitullojë dhe të pranojë Marrëveshjen e Kumanovës. E dyta, ajo mundësoi çlirimin e plotë të Kosovës dhe largimin e të gjitha forcave militare, paramilitare serbe nga Kosova. E treta, kjo konferencë krijoi një partneritet historik midis Perëndimit dhe Kosovës, midis NATO-s dhe UÇK-së, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Bashkimit Evropian dhe Kosovës në rrugën e lirisë dhe në rrugën drejt pavarësisë. Shikuar nga prizmi i sotshëm, Konferenca e Rambujesë në fakt ka qenë krijimi i një partneriteti strategjik me bashkësinë ndërkombëtare, e cila ka bërë një revolucion në të drejtën ndërkombëtare, duke afirmuar të drejtën e vetëvendosjes përkundëjt teorisë sovjetike të integritetit territorial.

Ajo ka promovuar doktrinën e intervenimit ushtarak kudo në botë ku shkelen të drejtat e njeriut, ku shkelet e drejta humanitare, dhe kjo padyshim ka pasur efekte zinxhirore në të gjitha proceset që kanë ndodhur më vonë. Në fakt, Konferenca e Rambujesë edhe ishte menduar asisoj, pra që të përfundonte me një pajtim të palës kosovare, me një refuzim të palës serbe, në mënyrë që të fillojë bombardimi i Serbisë dhe i Jugosllavisë pa një miratim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ishte hera e parë pas Luftës së Dytë Botërore kur zhvillohej një fushatë e bombardimeve e paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit. Kjo në qarqe juridike zgjoi debate të shumta të juristëve pro dhe kundër. Një pjesë e juristëve që ishin nën ndikimin e doktrinës sovjetike mendonin se është shkelur e drejta ndërkombëtare, kurse pjesa tjetër e

juristëve me qasje pragmatike, pohonin se jo vetëm që nuk është shkelur, por është afirmuar dhe është zhvilluar e drejta ndërkombëtare humanitare bazuar në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Intervenimi ushtarak sipas tyre, ka treguar se në botë askush nuk mund të bëjë vepra të gjenocidit, të krimit kundër njerëzimit pa u ndëshkuar nga bashkësia ndërkombëtare, nga NATO-ja e cila i mbron këto vlera në mënyrë universale.

Ky studim po bëhet në 25 - vjetorin e mbajtjes së Konferencës së Rambujesë dhe bombardimeve të NATO-s në Kosovë, që mundësoi çlirimin dhe, më vonë, pavarësinë e Kosovës. Duke qenë personalisht pjesëmarrës në këtë Konferencë në Rambuje dhe Paris, në cilësinë e këshilltarit ligjor, do të bëj përpjekje të vë në pah prapaskenat e saj dhe kryqëzimin e politikave ndërkombëtare në raport me Kosovën. Krahas përpjekjes për të parandaluar përpjekjet e Serbisë për të zbatuar gjenocidin e dytë në Kosovë, pas atij në Bosnjë, Konferenca e Rambujesë shënoi fillimin e një rendi të ri botëror, i cili legjitimon përdorimin e forcës së NATO-s, kudo që shkelen të drejtat e njeriut, kryhen krimet kundër njerëzimit, spastrim etnik dhe politikat e gjenocidit. Kjo u bazua në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, i cili lejon intervenimi humanitare për t'i mbrojtur këto vlera.

Distanca kohore prej tre dekadash është e mjaftueshme sipas metodologjisë shkencore për të nxjerrë gjykime dhe konstatime të sakta, për të përshkruar periudhën nëpër të cilën ka kaluar ky proces historik i lindjes së shtetit të Kosovës dhe për të treguar rrethanat e brendshme dhe ato

ndërkombëtare të zhvillimit të kësaj Konference. Kjo ishte arsyeja parësore, të filloj hartimin e një studimi shkencor për Konferencën e Rambujesë, si një ngjarje të rëndësishme në proceset e shtet-krijimit dhe pavarësisë së Kosovës.

Ky studim është i gatshëm për botim, pas procedurave të lekturimit, recensioneve dhe redakturës.

Libri do të dorëzohet për shtyp në Janar 2025

Botimi do të ketë rreth 30 tabakë shtypi.

2. Isa Mustafa: *Konvergjencia ekonomike e Kosovës me Bashkimin Evropian*.

Beteja ekonomike e vendeve të pazhvilluara dhe atyre në zhvillim për të kapërcyer diferencat me vendet e zhvilluara, zhvillohet pandërprerë. Synimi për të zënë hapin në zhvillim me vendet e zhvilluara përmban në vete nevojën e rritjes së standardit dhe mirëqenies së popullatës, zvogëlimin e varfërisë dhe të papunësisë. Kosova e paraluftës për një periudhë të gjatë ka bërë përpjekje për ngushtimin e diferencave në zhvillim, por politikat, masat dhe instrumentet ekonomike të cilat janë zbatuar ndaj Kosovës janë treguar joefektive.

Roli dhe rëndësia e konvergjencës ekonomike ka hasur në trajtim të politikave ekonomike në ekonomitë botërore. Rezultatet e arritura të konvergjencës, divergjencës, kohezionit, barazisë, në teori zakonisht interpretohen në korrelacion me sistemet politike dhe ekonomike, kushtet specifike të shteteve të ndryshme, strukturën e potencialit prodhues dhe të shërbimeve,

madhësinë e tregut, produktivitetin, ambientin ligjor, kulturën ekonomike.

Konvergjencia e ekonomisë së Kosovës me Bashkimin Evropian në këtë botim trajtohet si synim për të arritur zhvillim ekonomik, nivel më të lartë të mirëqenies dhe prosperitet demokratik. Një zhvillim i cili siguron dinamikë të nevojshme të rritjes ekonomike, të punësimit dhe të faktorëve të tjerë të inkluzivitetit ekonomik të popullatës; ndryshime të strukturës ekonomike të bazuara në produktivitet dhe inovacione, në konkurrueshmëri dhe në integrimin ekonomik ndërkombëtar. Trajtimet përfshijnë edhe synimet e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor për të dinamizuar zhvillimin ekonomik, për t'u përafruar dhe anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Botimi trajton koncepte të ndryshme të sistemeve dhe politikave ekonomike në të cilat ka kaluar Kosova, tranzicionin politik dhe ekonomik të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në decenien e fundit të shekullit të kaluar, pozitën specifike të Kosovës në këtë periudhë dhe në periudhën e liberalizimit të tregut, privatizimit dhe ristrukturimit ekonomik; të filluar nën administrimin e OKB-së dhe të vazhduar pas shpalljes së pavarësisë.

Sfidat e përafrimit ekonomik me Bashkimin Evropian janë boshti i trajtimit të këtij botimi duke filluar nga struktura ekonomike e vendit, ambienti i të bërit biznes, konkurrueshmëria, qëndrueshmëria ekonomike, ekonomia e gjelbër, shkathtësitë, konjunktiviti dhe infrastruktura, digjitalizimi. Prezantohen indikatorë, sipas kritereve të OECD-së, EBRD-së, Indeksit të konkurrueshmërisë (të Forumi

Ekonomik Botëror dhe ASHAK-ut), të cilët konvergjojnë me metodologjitë e institucioneve relevante evropiane.

Botimi do të ketë rreth 250 faqe.

Do të jetë gati për botim në vjeshtë të vitit 2025.

Libri përmban tabela dhe figura, prandaj është e nevojshme të parashihet botimi në kolor.

3. Muhamedin Kullashi: *Rimendimi i filozofisë të Nietzsches*.

Në këtë libër synojmë të vëmë në pah *mëvetësinë* e mendimit filozofik të Friedrich Nietzsches (1844-1900). Libri ndahet në tri kaptina: *Interpretimi, analiza të teksteve dhe dialogë*.

Këtu kemi parasysh evoluimin dhe unitetin e mendimit të tij kryesisht në veprat *Agu i mëngjesit* (1881) dhe *Dija e gëzuar* (1882-1887). Mëvetësinë e filozofisë së Nietzsches e kemi zhvilluar nëpërmjet ballafaqimit reciprok të interpretimeve pertinente që artikulojnë në studimet e disa filozofëve të shquar francezë dhe gjermanë mbi Nietzschën; në radhë të parë, ato të Philipe Renaud dhe Peter Putz, por edhe ato të Michel Foucault-së dhe Martin Heidegger.

Dua të rikujtoj se gjatë disa viteve kam ligjëruar në Departamentin e Filozofisë të Universitetit “Parisi 8” lidhur me disa probleme e tema të filozofisë së Nietzsches.

Mëvetësinë e ligjërimit të tij filozofik, të Nietzsches e kemi theksuar në titull me termin “*Rimendimi*”: është fjala për *rishqyrtimin* kritik dhe *reformulimin* e konceptioneve filozofike të filozofisë antike greke, të filozofisë së Renesancës, të filozofisë karteziene dhe ato të filozofisë klasike gjermane

(në veçanti ato të Kantit dhe Hegelit), por edhe ato të Schopenhauerit.

Dorëshkrimi shoqërohet me një bibliografi të veprave të Nietzsches dhe të librave të studiuesve të shquar në gjuhën franceze dhe angleze.

Libri do të dorëzohet për shtyp në janar të vitit 2025

Botimi do të ketë rreth 20 tabakë shtypi.

4. Anton Berishaj: *Gruaja ndërmjet pabarazisë zakonore dhe civilizimit të vdekjes*.

Historia njihet shumë pak dukuri shoqërore, të jenë dëshmuar më rezistente ndaj faktorëve objektivë dhe subjektivë që i nxisin lëvizjet shoqërore, faktorë këta që në kohë dhe në hapësirë i imponojnë ndryshimet spontane, evolutive apo revolucionare të trendëve historikë, socialë, ekonomikë e kulturorë, sesa është dëshmuar dukuria e raporteve gjinore, përkatësisht, e pabarazisë gjinore. Si duket, pikërisht kjo e shpjegon edhe faktin se, me këtë dukuri lidhen edhe nocione e fenomene të shumta, siç janë: pabarazia, diskriminimi, nënshtrimi, xhelozia, përçmimi e poshtërimi, dhuna e përdhunimi, përjashtimi social... e deri te femicidi, si forma më e vrazhdë e komunikimit ndërgjinor, respektivisht e trajtimit të gruas në botën moderne.

Shekulli i fundit shënoi lëvizje feministe, që e synojnë barazinë gjinore, por ajo nuk po ndodh, pasi kemi të bëjmë me një dukuri historike e cila po dëshmohet shumë më komplekse sesa konsiderohej gjatë shekujve. Marrë parasysh faktin se gruaja është e pafuqishme të ndryshojë skenën dhe vetëdijen shoqërore,

sidomos kur në aksion niset e vetmuar, çlirimi i saj po dëshmohej se nuk është akt, por një proces, madje i gjatë.. Si përfaqësuese e gjinisë së saj, pavarësisht të drejtës natyrore të pakontestuar që të angazhohet për liri e barazi, figura e saj e vetmuar, aq lehtë merr ngjyrimet e ndryshme denigruese – që variojnë nga koloriti i problemeve të identitetit të saj seksual e gjer te blasfemia e shkëljes së vullnetit të “Krijuesit”, që seriozisht e pengojnë rrugëtimin e saj drejt barazisë.

Në përpjekjet e saj që të ndryshojë skenën shoqërore, historikisht të etabluar, gruaja po has në shumë pengesa, madje edhe në trajtime që nuk përkojnë me nivelin e civilizimit dhe kohën. Ajo, është vënë në shënjestër të burrave dhe trajtimi diskriminues i saj gjatë historisë po vazhdon, ndërsa përpjekjet e saj për barazi dhe jetë të dinjitetshme, po penalizohet, madje po merr përmasa femicidale.

Në këtë atmosferë pasigurie, e vetme, ajo thyhet e dorëzohet, vazhdon ta vuajë pabarazinë, ose vritet. Mjetet e informimit publik botëror publikojnë lajme alarmante që frikësojnë, për fatin e grave që marrin guximin për aksione dhe vullnet për të ndryshuar statusin social në piramidën stratifikative shoqërore.

Libri do të dorëzohet për shtyp në janar 2025

Botimi do të ketë rreth 270 faqe.

5. Revista *Studime shoqërore*, nr. 12 - Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2025. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime,

recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

PROMOVIMI I BOTIMEVE

Promovimet e botimeve të Seksionit bëhen në ASHAK, në panairin vjetor të botimeve shkencore dhe akademike dhe në panairot e tjera.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente, Gjyljeta Mushkolaj, d.v.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. *Degradimi i fenolit dhe i disa ngjyrave me anë të metodave elektrokimike të oksidimit të avancuar*, projekt njëvjeçar i paraqitur nga anëtari korrespondent Fetah Podvorica. Ky projekt është në kuadër të kimit të kimisë së materialeve dhe kimisë së mjedisit.

- Qëllimet kryesore të projektit janë:

Në kuadër të këtij projekti së pari do të gjenden kushtet optimale për të detektuar praninë e përqendrimeve të vogla të fenolit me anë të voltametrisë ciklike e më pastaj do të testohet zbërthimi i tij i plotë me metodat elektrokimike të oksidimit të avancuar. I njëjti proces synohet të realizohet edhe për molekulat e ngjyrosësve, bromofenolit blu, metilit blu dhe bromtimolit blu. Në rastin e fenolit, pas gjetjes së vlerave optimale të parametrave kyç që e mundësojnë shndërrimin e tij në dioksid karboni dhe ujë, do të vazhdohet trajtimi i tij nga mostrat reale nga deponitë e hirit në

termocentralet e Kosovës A dhe B. Me të njëjtën procedurë pastaj do të bëhet hulumtimi i zbërthimit të bromofenolit blu, metilit blu dhe bromtimolit blu edhe kur ndodhen bashkërisht në tretësirë.

Realizimi i projektit do të bëhet në Departamentin e Kimisë të FSHMN-së. Gjetja e kushteve optimale të degradimit të fenolit dhe të disa ngjyrave, bromofenolit blu, metilit blu dhe bromtimolit blu, do të mundësojë që të propozohet kjo metodë si model për zbërthim të plotë të tyre për dallim të metodave të ndryshme të ndarjes të cilat vetëm e bëjnë largimin prej sistemit. Rezultatet e fituara do të botohen në revistën *Research* (Kërkime) apo në ndonjë revistë tjetër shkencore, si dhe në një konferencë shkencore që i trajton tematikat e ngjashme.

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve

- Përdorimi i metodave elektrokimike për detektim dhe të metodave të avancuara të oksidimit për zbërthim të molekulave model
- Marrja e mostrave reale të fenolit nga terreni, nga deponitë e hirit në KEK, dhe analiza me anë të voltametrisë ciklike
- Studimi i degradimit të fenolit me anë të metodës Fenton, elektro-Fenton dhe me anë të oksidimit anodik
- Studimi i degradimit të disa ngjyrave me anë të metodës Fenton, Elektro-Fenton dhe me anë të oksidimit anodik

TUBIME SHKENCORE

Konferenca shkencore: *Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura.*

Konferenca e parë u mbajt më 27-28 maj 2024 në ASHAK, në të morën pjesë me prezantime 33 pjesëmarrës dhe u bashkorganizua nga ASHAK-u dhe ASHSH-ja. Konferenca e dytë e bashkorganizuar tani nga ASHSH-ASHAK-u do të mbahet në Tiranë, në vitin 2025.

Ndryshimet klimatike që janë shkaktuar si rezultat i aktiviteteve antropogjene kanë ndikim edhe në ndryshimin e sasive të të reshurave në regjione të caktuara, gjatë stinëve të ndryshme me ç'rast shfaqen periudha të theksuara të thatësisë, rritjen e numrit të valëve të nxehtësisë, si dhe shfaqjen e të reshurave me intensitet shumë të theksuar në vende të caktuara.

Menaxhimi i resurseve ujore në të ardhmen paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të një vendi, sepse ai ndikon drejtpërdrejt në kualitetin e jetës së njerëzve në hapësira urbane dhe jourbane, si dhe në rendimentin e të ardhurave bujqësore dhe në biodiversitetin në përgjithësi.

Si rezultat i aktiviteteve të ndryshme humane duke përfshirë edhe aktivitetet industriale ndodh ndotja e ujit, nëpër lumenjtë e Kosovës, në shkallë mjaft të gjerë. Zvogëlimi i shkallës së ndotjes dhe trajtimi i ujërave të tillë dhe atyre që hidhen në hapësirat urbane me teknologjitë bashkëkohore paraqet një sfidë, por edhe kërkesë imediate në mënyrë që në të ardhmen të sigurohen sasi të mjaftueshme të ujit të pijes dhe për shfrytëzim për qëllime të tjera.

Në kuadër të simpoziumit do të trajtohen këto problematika:

Burimet ujore në Kosovë dhe potenciali i shfrytëzimit të tyre, shkaktarët kryesorë të ndotjes së ujërave në Kosovë, ndotësit organikë dhe inorganikë, metodat e ndryshme për detektimin dhe eliminimin e ndotësve prej ujërave të ndotura, sensorët e ndryshëm, teknologjitë e avancuara, proceset e oksidimit të avancuar, shfrytëzimi i ujërave të përpunuara për qëllime të ndryshme.

Konferenca do të organizohet në muajin maj 2025. Këshilli organizues nga ASHAK-u: Anëtar korrespondent Salih Gashi, Akademik Fejzullah Krasniqi, anëtar korrespondent Fetah Podvorica dhe anëtare korrespondente Myzafer Limani.

2. Konferencë shkencore ndërkombëtare: *Siguria kibernetike*. Konferencë dyditore e organizuar së bashku me Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Propozuar nga anëtare korrespondente Myzafer Limani.

Siguria kibernetike është një fushë me zhvillim të shpejtë, me kërkime intensive gjithnjë e më kritike. Në një fushë kaq të gjerë si siguria kibernetike, trajtimi i temave interesante në një konferencë është e një rëndësie të veçantë. Siguria kibernetike paraqet fushën e aplikimit të teknologjive, proceseve dhe kontrolleve për të mbrojtur sistemet, rrjetet, programet, pajisjet dhe të dhënat nga sulmet kibernetike dhe synon të zvogëlojë rrezikun e sulmeve kibernetike dhe të mbrojtë sistemet, rrjetet dhe teknologjitë ndaj shfrytëzimit të paautorizuar dhe sulmeve kibernetike. Sulmet kibernetike vazhdojnë të rriten e të bëhen më të sofistikuar, me sulmuesit që përdorin një

shumëllojshmëri të taktikave gjithnjë e më të avancuara. Është gabim të besohet se nuk na interesojnë sulmuesit dhe sulmet kibernetike. Të gjithë ne që jemi të lidhur në internet kemi nevojë për siguri kibernetike. Kjo për shkak se shumica e sulmeve kibernetike janë të automatizuara dhe synojnë të shfrytëzojnë dobësitë e zakonshme dhe jo faqet e internetit ose organizatat specifike.

Këshilli organizativ: Myzafer Limani (ASHAK); Prof. dr. Blerim Rexha (UP, FIEK), bashkëkryesues; Fejzullah Krasniqi (ASHAK), anëtar; Fetah Podvorica (ASHAK), anëtar; Prof. dr. Edlira Martiri (Universiteti i Tiranës), anëtar; Prof. dr. Artan Luma (SEUU), anëtar.

Konferenca do të organizohet në muajin maj 2025, me 30-40 pjesëmarrës nga SHBA-ja, Norvegjia, Austria, Luksemburgu, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova. Materialet e konferencës do të përmblihen në një botim që parashihet gjithashtu me programin e punës për vitin 2026. Mjetet e planifikuara financiare rreth 7500 euro.

BOTIME

1. Akademik Fejzullah Krasniqi: *Eksergjia* si botim i veçantë i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut për vitin 2025. Aktualisht ky libër është dorëzuar i përgatitur deri në rreth 90 % dhe i njëjti do të ketë rreth 30 tabakë shtypi sipas formatit të librave të ASHAK-ut.

Duke konsideruar se eksergjia paraqet pjesën e organizuar (konvertibile) të energjisë e cila nuk u bindet ligjeve të ruajtjes së energjisë, analiza eksergjetike

është bërë sot ndër problemet më aktuale. Ajo gjatë zhvillimit të proceseve termodinamike irreversible pjesërisht shkatërrohet, përkatësisht pëson humbje duke kaluar në ambientin rrethues (në energji). Në këtë aspekt analiza eksergjëtike e pajisjeve energjetike e bënë të mundur identifikimin e humbjet më të mëdha të energjisë. Meqë kjo paraqet sfidë për komunitetin inxhinierik në rrafshin shkencor dhe profesional, e kam konsideruar të rëndësishme të merrem me këtë problematikë dhe të bëj një propozim për një libër me titull *Eksergjia*.

2. Botimi i librit të punimeve të konferencës shkencore: *Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura* e cila u mbajt më 27-28 maj 2024 në Prishtinë. Libri do të përfshijë punimet e përzgjedhura nga këshilli organizues shkencor i konferencës dhe parashihet të ketë rreth 130 faqe.

3. Revista *Research-Kërkime* nr. 29

Aktualisht është në përgatitja e botimit të numrit 28 të kësaj reviste, i cili do të botohet deri në gjysmën e dytë të vitit 2024. Numri 29 i revistës “Research-Kërkime” mendohet të botohet në gjysmën e dytë të vitit 2025. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

PROMOVIMI I BOTIMEVE

Promovimet e botimeve të Seksionit bëhen në ASHAK, në panairin vjetor të botimeve shkencore dhe akademike dhe në panairët e tjera.

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, d.v.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

Seksioni i Arteve për vitin 2025 do të zhvillojë aktivitete artistike, që do të përqendrohen kryesisht në format manifestuese dhe prezantuese nga fusha e arteve pamore dhe të muzikës.

EKSPOZITA

2. Parashihet që gjatë vitit 2025 në mjediset e ASHAK-ut të organizohet një ekspozitë e arteve pamore me autorë që nuk janë pjesë e Akademisë. Ekspozita do të pajiset me materialin përcjellës promovues, përfshirë edhe katalogun, ndërsa Akademia me anë të komisionit të saj do të bëjë pasurimin e fondit të veprave artistike përmes përzgjedhjes profesionale. Autorit të ekspozitës do t’i paguhen shpenzimet në vlerë deri në 1,000.00€.

KONCERTE

2. Gjatë vitit 2025 duke vazhduar traditën e nisur, do të organizohen në mjediset e ASHAK-ut dy koncerte me vepra artistike të autorëve tanë dhe të huaj dhe me solistë të përzgjedhur brenda dhe jashtë vendit. Koncerti i parë parashihet të mbahet pjesën e parë të vitit, ndërsa koncerti i dytë, parashihet të mbahet në vigjilje të festave të fundvitit. Vlera e mjeteve financiare për organizimin e një koncerti do të jetë rreth 8,000.00€.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CXIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 28 shkurt 2024, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Sabri Hamiti dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani dhe Qamil Haxhibeqiri.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, i cili fillimisht e ftoi Kuvendin për një minutë heshtje në nderim të veprës së akademik Feriz Krasniqi i cili ndërroi jetë më 26 janar 2024.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CXII të Kuvendit të Akademisë;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2023;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2023;

4. Çështje vijuese.

Ad-1.

Procesverbali i mbledhjes CXII i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad-2.

Kuvendi e shqyrtoi raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2023. Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta në të cilat i kanë shqyrtuar dhe i kanë miratuar raportet e punës së tyre. Më pas edhe Kryesia e ka shqyrtuar raportin e përgjithshëm dhe materialet për këtë mbledhje janë ndarë me kohë.

Kuvendi më pas filloi shqyrtimin e raportit me radhë duke filluar nga Kuvendi, Kryesia dhe seksionet e ASHAK-ut. Gjatë shqyrtimit të raportit të punës së seksioneve kryetari kërkoi nga sekretarët e seksioneve të deklarohen në rast të ndonjë plotësimi eventual. Sekretarët u deklaruan se nuk kanë asgjë për të shtuar.

Kuvendi njëzëri e miratoi raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2023 i cili do të botohet në revistën "Vjetari 2023".

Ad-3.

Në vazhdim u shqyrtua dhe u miratua njëzëri edhe raporti financiar i ASHAK-ut për vitin 2023.

Ad-4.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës kryetari Kraja diskutoi për çështjen e dorëshkrimeve, përkatësisht të botimeve dhe të projekteve. Ai tha se kemi probleme me dorëshkrime, sepse po hyjnë në program të punës dorëshkrime të papërfunduara dhe më pas ato po paraqiten edhe në tenderin e vitit përkatës, po ashtu të papërfunduara. Pengesa po ka edhe më tutje, sepse nuk po përputhen specifikat e dorëshkrimeve të dorëzuara me specifikat e paraqitura për tenderim. Edhe vonesa e dorëzimit të dorëshkrimeve është problem shtesë. Ai apeloi që asnjë dorëshkrim të mos përfshihet në program të punës pa qenë i gatshëm.

Kryetari Kraja më pas foli edhe për projektet e ASHAK-ut. Ai tha se ka disa projekte të cilat figurojnë për vite me radhë në programet e punës së ASHAK-ut, por nuk ka punë në to dhe nuk ka asnjë raport. Bartësit e tyre duhet të hartojnë raport me shkrim në të cilin duhet të paraqitet puna e bërë dhe një arsyetim për mbylljen e punës. Nuk mund të lejojmë më që projektet të na figurojnë nëpër programe të punës e të mos ketë asnjë punë.

Në vazhdim kryetari e njoftoi Kuvendin se Kryesia e Akademisë ka ngritur dy grupe punuese, një për plotësimin e Statutit dhe të Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë dhe një tjetër për hartimin e akteve normative për themelimin e Akademisë së të rinjve.

Grupi i parë ka kryer punën dhe nga nesër të gjithë anëtarët e Akademisë do t'i marrin të dy draftet. Do t'u lihet në dispozicion rreth një muaj kohë për të paraqitur vërejtje, propozime e

sugjerime, të cilat më pas i dërgohen grupit punues. Grupi i shqyrton dhe më pas të dy draftet do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit në qershor.

Grupi punues ka marrë mandat nga Kryesia për plotësimin e Statutit dhe Rregullores, vetëm për funksionalizimin e Seksionit të Arteve dhe eventualisht edhe ndonjë seksioni tjetër që për ndonjë arsye, nuk mund të jetë funksional.

Sa i përket grupit të dytë ai tha se themelimi i akademisë së të rinjve është kërkesë e kahershme e ALLEA-s, por tani duhet të nisim punën. Të gjitha dokumentet që hartohen, do t'u dërgohen të gjithëve për shqyrtim si drafte.

Në vazhdim diskutoi H. Islami. Ai tha se në një nga mbledhjet e kaluara kryetari Kraja e ka akuzuar padrejtësisht për donacionet e projektit "Vendbanimet e Kosovës". Ai tha se me qëllim të njoftimit të drejtë të anëtarëve të Akademisë e ka mbledhur të gjithë materialin dhe se në të janë të gjitha dokumentet, duke filluar nga marrëveshjet me dy ministrinë MAPL dhe MKRS, dëshmitë e mbajtjes së punëtorive, faturat për të gjitha shpenzimet etj...dhe se të gjitha është i gatshëm t'i prezantojë një nga një.

Kryetari Kraja tha se ai ka folur në bazë të asaj çfarë ka lexuar në raportin e punës, por tani është mirë që janë të gjitha dokumentet përkatëse dhe u sqarua kjo çështje.

Në vazhdim diskutoi M. Kullashi. Ai shprehu indinjatën e tij të cilën, siç tha ai, ia ka shprehur disa herë SSHSH, si dhe përmes komunikimit elektronik Kryesisë së Akademisë, për

mospjesëmarrjen e ASHAK-ut në asamblenë e UAI, në Filadelfia. Ai tha se mospjesëmarrja e ASHAK-ut atje nuk na bën nder, sepse bashkëpunimi me ta ka qenë në nivel dhe frytdhënës.

M. Kullashi po ashtu shprehu indinjatë për mosnënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Akademinë e Linceit.

Lidhur me diskutimin e M. Kullashit për mospjesëmarrjen e ASHAK-ut në asamblenë e UAI, M. Kraja tha se për këto punë është kompetent Këshilli për Bashkëpunim Ndërkombëtar i ASHAK-ut. M. Kullashi është anëtar i Këshillit dhe në bazë të informatave që kam ai asnjëherë nuk ka marrë pjesë në mbledhje të Këshillit, edhe pse ka pasur ftesë të rregullt.

Sa i përket marrëveshjes me akademinë e Linceit M. Kraja tha se ajo marrëveshje është sjellë disa vjet nëpër Akademi, më pas kur ka ardhur zyrtarisht nga Akademia e Linceit, unë e kam nënshkruar. Më pas u kemi dërguar atyre me nënshkrim, e kanë pranuar dhe e kanë nënshkruar. Marrëveshja pra është e nënshkruar dhe tani jemi në pritje të përcaktimit të pikave të bashkëpunimit.

Në fund, diskutoi J. Sh. Pula. Ajo tha se seksionet i kanë propozuar anëtarët e Këshillit në mbledhje të rregullta. Më pas Kryesia me vendim të veçantë, në bazë të propozimeve të seksioneve e ka ngritur Këshillin. Tani atë Këshill e udhëheq nënkryetari i Akademisë. Unë i kam ftuar me rregull mbledhjet e Këshillit, por nuk ka pasur kuorum për mbajtjen e tyre, sepse nuk kanë ardhur anëtarët në mbledhje. Akademik Kullashi tani po deklaron që është tërhequr, por ai nuk ka paraqitur me shkrim asgjë. Ajo i luti anëtarët e Këshillit që të marrin pjesë në

mbledhje. Nëse dikush do që të tërhiqet për çfarëdo arsye, të njoftojë me shkrim, ashtu që sa më parë të zëvendësohen dhe Këshilli të funksionalizohet.

Mbledhja u mbyll në orën 11:55.

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Sekretare e Akademisë

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CXIV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 7 mars, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut;
2. Votimi për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të ASHAK-ut dhe shpallja e rezultateve të votimit;
3. Çështje vijuese.

Ad-1.

Procesverbali i mbledhjes CXIII i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad-2.

Kryetari Kraja fillimisht kërkoi nga L. Pula të japë sqarime për kuorumin.

L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 29 anëtarë të Akademisë nga 35 (pa akademik Rexhep Qosja) sa janë gjithsejtë. Sekretar shkencor i Akademisë mund të zgjidhet kandidati që merr 18 vota.

Kryetari më pas propozoi Komisionin e zgjedhjeve më këtë përbërje: Eqrem Basha, Besnik Krasniqi dhe Fetah Podvorica. Propozimi u miratua njëzëri.

Para fillimit të procesit të votimit diskutoi H. Islami. Ai propozoi që të mos përfshihen në kuorum disa anëtarë të Akademisë të cilët nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, ashtu që të krijohet mundësia e zgjedhjes së Sekretarit shkencor dhe të mos përsëritet situata si në Kuvendin e kaluar. Ai tha se jemi në gjendje jo të mirë, meqë nuk po mund të bëjmë zgjidhje. Ndoshta është dashur Kryesia të ndër marrë veprime, duke biseduar me të tre kandidatët që të tërhiqet njëri. Ka edhe mundësi tjetër, të përdoret shorti në mes të tre

kandidatëve, është një gjë normale që mund të aplikohet në raste të tilla. Pas fjalës së H. Islamit, kryetari Kraja tha se në kuorum mund të mos përfshihet vetëm akademik Rexhep Ferri, meqë vetëm për të kemi njoftim zyrtar që nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Akademisë, për të tjerët nuk kemi njoftime zyrtare. Sa i përket shortit, ai tha se as Ligji e as Statuti i Akademisë nuk parasheh diçka të tillë dhe propozoi të shpërndahen fletëvotimet.

Me pajtimin e Kuvendit u shpërndanë fletëvotimet.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të Akademisë: votuan 29 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe asnjë e pavlefshme.

Anëtar korrespondent Bardh Rugova mori 9 vota

Akademik Fejzullah Krasniqi mori 10 vota

Anëtar korrespondent Frashër Demaj mori 10 vota.

Meqë asnjëri nga kandidatët nuk mori numrin e nevojshëm të votave, në përputhje me Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 12, paragrafi 3, votimi u përsërit për kandidatët me numër më të madh, përkatësisht kandidatët me numër të njëjtë të votave. U bënë gati fletëvotimet për votimin e dytë.

Pas votimit të dytë u mbledh Komisioni i zgjedhjeve dhe pas numërimit të votave konstatuan se votimi i fshehtë dha të njëjtin rezultat:

Votuan 29 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 27 fletëvotime të vlefshme dhe dy të pavlefshme.

Akademik Fejzullah Krasniqi mori 14 vota

Anëtar korrespondent Frashër Demaj mori 13 vota.

Në fund kryetari Kraja tha se edhe kësaj radhe dështoi zgjedhja e Sekretarit shkencor. Statuti i Akademisë, neni 35, paragrafi 3 parasheh një zgjidhje në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit shkencor dhe saktëson: “Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit shkencor, Kryesia me vendim të veçantë cakton ushtruesin e detyrës së Sekretarit shkencor”. Meqë muajt në vijim ka shumë aktivitete shkencore e artistike të parapara me programin e punës për vitin 2024, nuk kemi mundësi të thërrasim pandërprerë mbledhje të Kuvendit, prandaj Kryesia në bazë të nenit 35, paragrafi 3 do të caktojë ushtruesin e detyrës për periudhë gjashtë mujore. Do të ndjekim parimin e renditjes së seksioneve: SGJ, SSHSH dhe SSHN dhe sigurisht që kandidatët e njëjtë do të jetë mirë të mos përfshihen. Në ndërkohë mund të mendojmë prapë si Kryesi për thirrje të mbledhjes zgjedhore, pasi të përmbylлим fazën e aktiviteteve dhe të Kuvendit të punës të qershorit.

Mbledhja u mbyll në orën 11:50.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Sekretare e Akademisë

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CXV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 18 qershor, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Mehmet Kraja, Muhamedin Kullashi, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Zejnullah Rahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Gjyljeta Mushkolaj, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja i cili fillimisht e ftoi Kuvendin për një minutë heshtje në nderim të veprës së akademik Rexhep Ferrit i cili ndërroi jetë më 6 qershor 2024.

Ai më pas tha se në sallë janë të pranishëm 24 anëtarë të Akademisë, kuorum ka dhe mbledhja mund të fillojë.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve CXIII dhe CXIV të Kuvendit të Akademisë;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2025;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të Statutit të ASHAK-ut dhe Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë;

3. Çështje vijuese.

Ad-1.

Procesverbalet e mbledhjeve CXIII dhe CXIV Kuvendit të Akademisë u miratuan pa vërejtje.

Ad-2.

Kuvendi filloi shqyrtimin e programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2025. Kryetari Kraja tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet e rregullta dhe i kanë miratuar programet e punës së tyre. Programi i punës më pas është shqyrtuar nga Kryesia e Akademisë dhe sot jemi këtu për ta miratuar atë. Ai i ftoi sekretarët e seksioneve të raportojnë nëse kanë diçka për të shtuar. Meqë nuk pati asnjë diskutim kryetari kërkoi nga Kuvendi miratimin me vota të programit të punës.

Kuvendi e miratoi njëzëri programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2025, i cili do të botohet në *Vjetari 2024*.

Ad-3.

Në vazhdim Kuvendi i shqyrtoi me radhë plotësimin e Statutit të ASHAK-ut dhe plotësimin e Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Kryetari Kraja tha se Kryesia e Akademisë e ka ngritur grupin punues për të bërë plotësimin e Statutit dhe të Rregullores dhe grupi ka pasur mandat për të bërë vetëm plotësime të cilat e funksionalizojnë Seksionin e Arteve dhe ndonjë tjetër nëse paraqitet nevoja. Ai e ftoi A. Bajramin që si kryesues i grupit të njoftojë Kuvendin me ecurinë e punës. A. Bajrami njoftoi se grupi punues ka bërë propozimet sipas kërkesës së Kryesisë dhe draftin e Statutit dhe të Rregullores ua ka ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të

paraqitur vërejtje apo sugjerime. Meqë nuk ka pasur asnjë vërejtje apo sugjerim draftet e dokumenteve në fjalë i janë përcjellë Kryesisë për procedim të mëtejshëm.

Më pas Kryetari kërkoi nga L. Pula të ofrojë sqarimet e nevojshme për vazhdimin e punës. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 24 anëtarë të Akademisë nga 34 sa janë gjithsej (pa akademik R. Qosja). Statuti i Akademisë konsiderohet i miratuar me 2/3 e anëtarëve të Akademisë, apo 11 vota, ndërsa Rregullorja konsiderohet e miratuar me shumicë votash, apo 18 vota.

Diskutuan M. Limani, F. Podvorica dhe R. Ismajli.

M. Limani në diskutimin e saj propozoi që të shikohet mundësia që të mos përfshihen në kuorum disa anëtarë të Akademisë që nuk janë prezent që një kohë, por M. Kraja tha se nuk mund t'i heqim nga kuorumi anëtarët e Akademisë për të cilët nuk kemi njoftim zyrtar, sepse bëjmë shkelje ligjore. F. Podvorica propozoi të bëhet një zgjidhje alternative për çështjen e votimit, por R. Ismajli tha se nuk mund të ketë zgjidhje alternative, sepse nuk e parasheh as Ligji e as Statuti.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi njëzëri plotësimin e Statutit.

Më pas filloi shqyrtimi i rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë.

S. Hamiti propozoi që te neni 4 të shtohet edhe një paragraf (1.3) dhe në atë paragraf të shënohet që: Të gjithë anëtarët e këtij Komisioni duhet të jenë nën 75-vjeç.

Propozimi i S. Hamitit doli në votim dhe mori vetëm 5 (pesë) vota. Propozimi

nuk kaloi dhe Kryetari e paraqiti për votim Rregulloren. Votuan të gjithë anëtarët. Për votuan 20 anëtarë, ndërsa kundër votuan 4 anëtarë.

Ad-4.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se në këtë mbledhje ishte planifikuar të miratohen edhe aktet përkatëse për themelimin e Akademisë së të rinjve në kuadër të ASHAK-ut, por grupi punues me kryesuese Gjyljeta Mushkolaj nuk kanë arritur të kryejnë punët e përcaktuara nga Kryesia e Akademisë, prandaj kjo çështje shtyhet për një mbledhje tjetër të Kuvendit, përderisa Kryesia do ta shqyrtojë edhe një herë këtë çështje, si dhe përbërjen e grupit punues.

Mbledhja u mbyll në orën 12:05.

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Sekretare e Akademisë

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit në mes të ASHAK-ut dhe UP-së



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) më 26 janar ka nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me Universitetin e Prishtinës (UP).

Memorandumi i bashkëpunimit u nënshkrua nga kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet Kraja dhe rektori, prof. Qerim Qerimi.

Përmes këtij memorandumi synohet rritja e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit për ngritjen dhe promovimin e performancës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët si dhe t'i përcaktojë fushat fundamentale të kërkimeve akademike, në të cilat palët janë të interesuara të punojnë së bashku në të ardhmen.

Në një deklaratë pas nënshkrimit, menaxhmenti i UP-së dhe ASHAK-ut theksuan se janë të përkushtuar për zbatimin e përpiktë të këtij memorandumi.

Në takimin zyrtar, të pranishëm ishin edhe akademike Justina Shiroka-Pula, nënkryetare e akademisë, akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të

Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe Lendita Pula, sekretare e akademisë.

Nga UP-ja, prof. Pranvera Breznica-Selmani, prorektore për zhvillim, buxhet, financa dhe bashkëpunim me sektorin privat, prof. Sefer Avdiaj, prorektor për kërkime, projekte, inovacion dhe informacion, dhe prof. Gentrit Berisha.

Me nënshkrimin e këtij memorandumi, pritët të krijohen mundësi të reja për shkëmbimin e dijes dhe për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, duke kontribuar në avancimin e dijes dhe shkencës.

U nda nga jeta akademik Feriz Krasniqi



Më 26 janar ka ndërruar jetë akademik Feriz Krasniqi, anëtar korrespondent i ASHAK-ut nga viti 1996 dhe anëtar i rregullt nga viti 2000.

Feriz Krasniqi lindi më 1931 në Tërpezë të Malishevës, ku kreu edhe shkollën fillore, gjimnazin e ulët e mbaroi në Prishtinë, ndërsa Shkollën Normale në Gjakovë. Më 1954 diplomoi në degën e

biologjisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Nishit, ndërsa më 1961 diplomoi po në degën e biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Shkupit. Një kohë të shkurtër punoi profesor i lëndës së biologjisë në Shkollën Normale të Prizrenit dhe më 1961 u zgjodh asistent në katedrën e biologjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Disertacionin e doktoratës “Vegjetacioni i pyjeve të rajonit kodrinor të Kosovës” e mbrojti në vitin 1968 në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit. Në vitin 1969 u zgjodh docent, kurse më 1980 profesor ordinar për lëndën sistematika e bimëve të larta në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Prishtinës, ku punoi derisa u pensionua. Akademik Feriz Krasniqi ushtroi funksione të ndryshme: ishte prorektor i Universitetit të Prishtinës (1973-1975) dhe dy mandate rektor i Universitetit të Prishtinës (1975-1979). Kreu edhe disa funksione shtetërore: deputet i Dhomës së Kombeve të Kuvendit Federativ dhe anëtar i Kryesisë së Kosovës. Akademik Feriz Krasniqi kërkimet shkencore i kishte orientuar në studimin e florës dhe të vegjetacionit spontan në tërësi, me theks të veçantë të atij të hapësirës kosovare. Që nga viti 1963 e deri së fundi ka publikuar punime të shumta shkencore nga kjo lëmi, të cilat janë botuar në revista të ndryshme shkencore të qendrave të ndryshme universitare. Ka dhënë kontribut të vlershëm në studimin e florës dhe vegjetacionit të Kosovës. Akademik Feriz Krasniqi ishte i pari studiues vendor, që mbi bazat shkencore u përfshi në studimin e gjithanshëm të florës spontane dhe

vegjetacionit spontan autokton të kësaj treve. Gjatë kësaj pune ai ka konstatuar një varg elementesh floristike të reja për florën e Kosovës e më gjerë, si dhe ka konstatuar dhe përshkruar variante e asociacione bimore të reja në trevën e Kosovës. Studimet e tij kanë rëndësi për hulumtimet më të thella në fushën e kërkimeve fundamentale dhe të mbrojtjes së ambientit dhe janë të lidhura ngushtë edhe me shkencat aplikative si agronominë, farmacinë, pylltarinë, veterinarinë, etj. Akademik Krasniqi ka dhënë kontribut të çmuar si themelues i herbarit kombëtar të florës së Kosovës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës.

Dr. Feriz Krasniqi ka marrë pjesë në shumë tubime të ndryshme shkencore dhe është i cituar në literaturën shkencore nga lëmi i florës dhe vegjetacionit.

Për shkallën e afirmimit dhe autoritetit që gëzonte akademik Feriz Krasniqi e vërteton edhe fakti i rëndësishëm që lloji bimor i ri për shkencën e floristikës i gjinisë *Cynoglossum* (*Solenanthus*) i zbuluar në masivin malor të Pashtrikut nga botanici i njohur T. Wraber emërtohet me emrin shkencor *Cynoglossum Krasnii* T. Wrab., që bën të ditur se emri i akademik Feriz Krasniqit të jetë i përjetshëm në historikun e shkencës së floristikës. Akademik Feriz Krasniqi botoi punime të shumta në periodikun shkencor të kohës, mori pjesë në një sërë projektsh shkencore dhe ishte autor ose bashkautor i disa teksteve shkollore dhe universitare. Për kontributin e tij në lëmin e kërkimeve shkencore, në procesin arsimor-edukativ të shumë brezave, në sigurimin e literaturës së nevojshme nga lëmi i biologjisë, në zhvillimin

institucional dhe afirmimin e Universitetit të Prishtinës, u nderua me shumë çmime dhe mirënjohje: më 1975 u nderua me Shpërblimi Krahinor i Dhjetorit, çmimin “Naim Frashëri” për tekstin universitar “Sistematika e bimëve të larta me elementet e filogjenisë” të botuar në vitin 1985. Përveç mirënjohjeve të tjera, në vitin 1995 Senati i Universitetit të Prishtinës ia dha titullin e nderit Profesor emeritus, për merita të veçanta në zhvillimin dhe avancimin e Universitetit të Prishtinës.

Në respekt të jetës dhe veprës së akademik Feriz Krasniqit, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 28 janar në orën 11:00 u mbajt mbledhja komemorative.

Mbledhja filloi me një minutë heshtje dhe më pas fjalën e mori kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Mehmet Kraja.

Ndërkaq, për veprën dhe jetën e akademik Feriz Krasniqit foli edhe sekretari i seksionit të shkencave të natyrës, anëtari korrespondent i Akademisë, Fetah Podvorica.

Në mbledhjen komemorative u lexua edhe telegrami i ngushëllimit i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pas mbledhjes komemorative u bënë homazhe në hollin e ASHAK-ut dhe varrimi i të ndjerit u bë të njëjtën ditë në orën 14:30 në varrezat e Prishtinës.

Akademia propozon që viti 2024 të shpallet vit i Shtjefën Gjeçovit

Në një letër dërguar ministrit të Kulturës, zotit Hajrullah Çeku, në fund të janarit të këtij viti, kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja,

ka propozuar që viti 2024 të shpallet vit i Shtjefën Gjeçovit, me rastin e 150-vjetorit të lindjes të arkeologut të parë shqiptar. Në letër thuhet:

“I nderuar zoti ministër,

Ju drejtohem me kërkesën që viti 2024 në Kosovë të shpallet Vit i Shtjefën Gjeçovit.

Atë Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Konstandin Gjeçi – Kryeziu) ka lindur më 12 korrik të vitit 1874 dhe është vrarë me atentat më 14 tetor 1929. Ishte shkrimtar, publicist, përkthyes, klerik, etnograf dhe arkeolog.

Ka lindur në Janjevë. Mësimet e fillores i kreu në vendlindje, ndërsa më 1884 hyri në Kolegjin Farnçeskan të Troshanit (Vilajeti i Shkodrës). Më 1888, pas përfundimit të kolegjit, shkoi në Kuvendin e Fojnicës (Bosnjë). Vijoi mësimet në Derventë, në Banjallukë, ndërsa mësimet teologjike i kreu në Kreshevë. Më 1896 u caktua meshtar në Troshan. Aty e mori emrin e ri Shtjefën-Kostandin. Shërbeu në Rubik dhe më 1897 u transferua famullitar në Zllakuqan të Klinës. Ishte mësues i shkollës së parë shqipe të Zllakuqanit. Vazhdoi të punojë edhe në vise të tjera: në Laç të Kurbinit (rihap shkollën shqipe), në Gomsiqe të Mirditës, në Durrës, në Vlorë, në Shkodër dhe si mësues i shqipes, në Arbënesh të Zarës (1905). Në vitet e fundit të jetës u kthye me punë në Zym të Hasit. Më 1929, për shkak të veprimtarisë patriotike, arsimore dhe kulturore u vra nga serbet në Kodrën Rrezin të Zymit të Hasit të Thatë.

Veprimtaria e Sh. Gjeçovit përfshin shumë vepra të botuara dhe dorëshkrime. Veprat e tij janë: “Kanuni i Lekë Dukagjinit ner Malcina t`Mdhaa”,

botuar në vazhdimë në revistën Albania (1898-1899); “Dashtunia e atdheut”, (dramë, 1901); “Jeta e Shën Luçisë pajtores s’arkidioçezit të Durrësit” (1904); “Agimet e Gjytetnisi, vepër morale didaktike (1910); “Shqiptari ngadhënjyes”, vepër e pabotuar (1904); “Princi i dy Dibrave apo Mojsi Golemi” (1904), “Mënera e Prezës”, novelë (1902); “Tradhti gjaksore (Vrasja e Mark Kulit)” (1906); “Përkrenarja e Skënderbeut” (1914). Shkroi edhe me pseudonime, ndërsa përktheu: “Vajza e Orleansit ose Joana d’Ark” (1916); “Shna Nou i Padues”, sipas A.N. Dal Gal (1912), “Atil Reguli”, dramë e Pietro Matastazit (1912), “Quo vadis”, roman i H. Sinkjeviçit (1923). Gjithashtu përktheu “Fjalë e urta” të Sokratit (1921) dhe disa vepra fetare. Mblodhi thesarin popullor nga kultura materiale dhe shpirtërore, shumë objekte arkeologjike dhe formoi muzeun françeskan, ku ekspozoi eksponate të rëndësishme muzeore, armë, veshmbathje dhe gjësende të tjera të rralla. Veçmas u vlerësua përmbledhja e tij dhe mbarëshkrimi “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Pushteti jugosllav, ku ishin të përfshirë edhe një numër kosovarësh, nuk e deshë Shtjefën Gjeçovin, të cilin jo vetëm që e vrau më 1929, por nuk i bëri as nderet që i takonin një burri mendjendritur, i cili la trashëgimi dy monumente të pavdekshme: themeloi arkeologjinë shqiptare dhe kodifikoi veprën më të rëndësishme të trashëgimisë zakonore shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës tashmë ka përfshirë në programin e vet të punës për vitin 2024 një konferencë shkencore kushtuar atë Shtjefën Gjeçovit. Do të donim që në

këtë përvjetor të zhvillohen edhe aktivitete të tjera, në të cilin do të përfshihej edhe institucionet e tjera shkencore dhe kulturore të vendit, si Instituti Albanologjik, Instituti i Arkeologjisë, Universiteti i Prishtinës, Instituti i Historisë, Instituti i Trashëgimisë Kulturore, komuna e Prishtinës, komuna e Lipjanit etj. Dhe natyrisht, në radhë të parë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Për çdo konkretizim të kësaj ideje jemi të gatshëm të intensifikojmë komunikimin dhe bashkëpunimin”.

U mbajtën takimet e redaksive të fushave të *Enciklopedisë Shqiptare*

Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, e cila bashkë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë është bartëse e projektit të *Enciklopedisë Shqiptare*, gjatë gjysmës së dytë të janarit janë mbajtur takime të redaksive të fushave për Kosovën.

Më 17 janar 2024 janë takuar fushat që mbulojnë periudha të ndryshme të historisë: Arkeologjia dhe Lashtësia, Mesjeta, Bizanti dhe Periudha Osmane, Rilindja Kombëtare, Lufta e viteve 1998-1999;

Më 19 janar janë takuar redaktorët dhe anëtarët e redaksive të fushave Albanologjia dhe Letërsia;

Më 24 janar janë takuar redaksitë e këtyre fushave: Gjeografia fizike, Gjeografia sociale, Arsimi, Ekonomia dhe Financat, Sistemet politike dhe Drejtësia, Shkencat shoqërore (sociologjia, filozofia, psikologjia), Religjioni;

Më 29 janar janë takuar fushat që mbulojnë artet dhe disa fusha të tjera: Artet pamore, Muzika, Artet skenike dhe Filmi, Trashëgimi kulturore, Ngulimet historike dhe diaspora, Informimi, Sportet;

Më 31 janar 2023 janë takuar redaksitë e fushave të natyrës dhe të shkencave teknike: Shkencat e natyrës (biologjia, kimia, matematike, fizika), Mjekësia dhe shëndeti, Shkencat e mjedisit, Bujqësia dhe blegtoaria; Industrinë dhe teknologjitë, Energjitë dhe energjetika, Gjeologjia dhe minierat, Inxhinieritë, Ndërtimtaria dhe Arkitektura.

Qëllimi i takimeve ka qenë avancimi i punëve rreth projektit *Enciklopedia Shqiptare*, veçmas detyrat që dalin rreth hartimit të fjalësit të artikujve sipas fushave përkatëse.

Takim pune për *Enciklopedinë shqiptare*

Më 14 shkurt 2024, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u zhvillua një takim pune për *Enciklopedinë shqiptare* në mes anëtarit të redaksisë së fushës (ekonomi, financë, tregti) të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Anastas Angjeli dhe redaktore së fushës (ekonomi dhe financa), akademike Justina Shiroka-Pula.



Në takim morën pjesë edhe anëtarët të tjerë të ASHAK-ut, prof. Isa Mustafa dhe prof. Besnik Krasniqi. Takimi konsistoi në shkëmbimin e mendimeve për harmonizimin e zërave që të dy palët kanë përgatitur deri tani dhe drejtimit e mëtejshme të punës.

U mbajt mbledhja e Redaksisë qendrore të *Enciklopedisë shqiptare*



Më datë 18 mars 2024 u mbajt mbledhja e radhës e Redaksisë qendrore të *Enciklopedisë shqiptare* në të cilën u shqyrtuan raportet e punës së Redaksisë vendore të Kosovës dhe të Redaksisë vendore të Shqipërisë, si dhe u diskutuan detyrat e punës dhe u përcaktua kalendari i aktiviteteve për periudhën mars-dhjetor 2024. Mbledhja u drejtua nga kryeredaktori i *Enciklopedisë shqiptare*, akademik Skënder Gjinushi, ndërsa raportet e punës së redaksive vendore i paraqitën: akademik Mehmet Kraja, kryeredaktor i Redaksisë vendore të Kosovës dhe akademik Shaban Sinani, kryeredaktor i Redaksisë vendore të Shqipërisë.

Në raportin e punës për Redaksinë vendore të Kosovës, akademik Kraja paraqiti të dhënat relevante për punën e deritashme, duke u ndalur veçmas te përmbyllja e punëve rreth hartimit të akteve, rregulloreve dhe dokumenteve të domosdoshme për funksionimin e strukturave redaksionale të *Enciklopedisë Shqiptare* në Kosovë

dhe në Shqipëri, si dhe ngritjen nga Redaksia vendore e Kosovës të redaksive të 29 fushave, të cilat përfshijnë tërësinë e lëndës shkrimore të pjesës për Kosovën të *Enciklopedisë Shqiptare*. Ai gjithashtu bëri të ditur se gjatë takimeve të ndara me redaksitë e fushave janë dhënë udhëzimet përkatëse për hartimin e listës së zërave, respektivisht të artikujve që duhet të shkruhen nga secila fushë. Është caktuar fundi i muajit mars, tha ai, si afat i fundit për dorëzimin e listave paraprahe të zërave për secilën fushë.

Në emër të Redaksisë vendore të Tiranës, e paraqiti raportin e punës akademik Shaban Sinani, i cili u shpreh i kënaqur me punën e deritashme të strukturave redaksionale të *Enciklopedisë Shqiptare*, duke propozuar edhe fazat e punëve të pritshme për vitin 2024, mbi bazën e kalendarit të propozuar po në këtë takim. Ai gjithashtu theksoi se në vitin e kaluar u mbyll faza e hartimit dhe e miratimit të akteve të kornizës ligjore dhe profesionale, u plotësua vertikalisht rrjeti i redaksive në të tri nivelet dhe redaksitë e fushave tashmë kanë nisur nga puna për përgatitjen e fjalësit paraprahe të *Enciklopedisë Shqiptare*.

Në këtë takim të Redaksisë qendrore të *Enciklopedisë Shqiptare*, përfaqësuesja e entitetit shqiptar të Maqedonisë së Veriut, dr. Valbona Toska, bëri të ditur se redaksia e tyre tashmë e ka hartuar regjistrin paraprahe të zërave, që do të shkruhen prej tyre për botimin e përbashkët të kësaj Enciklopedie.

Në këtë mbledhje u vendos që:

1. Deri në fund të muajit qershor redaksitë e fushave të kenë përfunduar përzgjedhjen me kriterë shkencorë njësitë enciklopedike, duke ua dorëzuar listat redaksive vendore dhe më tej asaj qendrore, që bën miratimin e tyre;

2. Deri në muajin shtator të jetë bërë ndarja e tyre sipas rëndësisë dhe shkallës së përfaqësimit në artikuj përmbledhës, të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Lista e artikujve monografikë miratohet nga RQ bashkë me autorët realizues;

3. Deri në fund të vitit të jenë propozuar nga redaksitë e punës, të jenë dakorduar dhe miratuar autorët realizues;

4. Redaksitë e fushës të takohen dy herë në vit, një herë në Tiranë e një herë në Prishtinë;

5. U miratua në tërësi kalendar i takimeve dhe mbledhjeve të redaksive.

Shpallet Konkursi për ndarjen e Çmimit stimulues nga lëmi i shkencave të natyrës, inxhinierisë dhe teknologjisë, mjekësisë dhe shëndetit, si dhe bujqësisë

Konkursi u shpall më 20 mars dhe qëndroi i hapur deri më 19 prill.

Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj përfaqëson ASHAK-un në simpoziumin e 10-të: Të drejtat e njeriut dhe shkenca, që u mbajt në Berlin

Më 20 dhe 21 mars 2024, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj mori pjesë në simpoziumin e 10-të: Të drejtat e njeriut dhe shkenca. Simpoziumi u

mbajt në Berlin dhe u organizua nga Akademia Norvegjeze e Shkencave dhe Letrave dhe Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave, Leopoldina. Prof. Mushkolaj ka marrë pjesë me prezantim në simpozium dhe prezantimi i saj është pritur me interesim.

U promovua libri: *Proceset konvencionale membranore dhe të integruara* i anëtarit korrespondent Salih Gashi



Më 21 mars 2024 në mjediset e ASHAK-ut u bë paraqitja publike e librit me titull: *Proceset konvencionale membranore dhe të integruara* të autorit prof. Salih Gashi, anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Promovimi u bë me rastin e 80 - vjetorit të lindjes së prof. Salih Gashit.

Fjalën përshëndetëse e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent, ndërsa kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet Kraja e përgëzoi autorin Salih Gashi për këtë botim të radhës dhe njëherësh i uroi 80 - vjetorin e lindjes, duke i dëshiruar shëndet dhe aktivitet të mëtejshëm.

Më pas Fetah Podvorica paraqiti shkurtimisht të dhëna nga biografia e prof. Salih Gashit dhe vuri në pah kontributin e tij akademik dhe shkencor të gjatë më se 5 dekada, si në ngritje të

kuadrit akademik dhe në krijimtari shkencore.

Në emër të recensentëve të librit: *Proceset konvencionale membranore dhe të integruara* akademik Nexhat Daci dhe akademik Fejzullah Krasniqi, për librin foli akademik Fejzullah Krasniqi. Ai i paraqiti elementet kryesore që e karakterizojnë këtë botim. Ai saktësoi se libri trajton kryesisht tri lëmi kryesore: parimet dhe zbatimi i proceseve konvencionale, membranore dhe të integruara që janë zbërthyer nëpër kapituj të veçantë. Këto procese bashkëkohore sot përdoren në lëmin e separimit në industri të ndryshme dhe trajtimin e ujit. Proceset e shtjelluara e në veçanti ato membranore dhe të integruara janë procese të reja, për të cilat ka njohuri teorike të pakta dhe zbatime shpesh të kufizuara dhe terma të pastandardizuara, prandaj autori është përpjekur t'i trajtojë në mënyrë që ato të jenë sa më të afër fenomeneve që i përfaqësojnë.

Në fund të promovimit, autori i librit, prof. Salih Gashi, foli për nxitjen që ka pasur për ta shkruar këtë libër.

U hap ekspozita: *Kosova në gjuhët e botës*



Në Galerinë e Akademisë, më 25 mars 2024, në orën 13, në 25-vjetorin e

ndërhyrjes së NATO-s, u hap ekspozita e botimeve për Kosovën në gjuhë të huaj *Kosova në gjuhët e botës*.

Ekspozitën e shpalli të hapur akademik Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë dhe në fjalën e tij tha:

“Përsëritjet e gjithëve, akademikë dhe të tjerë të pranishëm,

Një përsëritje të veçantë ia drejtoj kryetarit të Parlamentit, zotit Konjufca. Faleminderit për praninë tuaj, zoti Konjufca!

Jam këtu, para jush që të them nja dy fjalë për këtë ekspozitë, që po e çelim me rastin e 25-vjetorit të fillimit të bombardimeve të NATO-s.

Ne e kemi quajtur ekspozitën “Kosova në gjuhët e botës”, por ndoshta titulli më i saktë do të ishte nëse do ta quanim “Kosova në memorien e botës – 25 vjet pas”.

Pra, ekspozita është memoria e botës për ne, një memorie kontemporane për Kosovën.

Por duhet thënë menjëherë se kjo që kemi këtu nuk është vetëm memorie për Kosovën, ndoshta më shumë është një mesazh largvajtës dhe i pakoduar, me vlerë të qëndrueshme politike dhe humane, mesazh i botës progresive në fund të shekullit XX për shekullin e ri, shekullit XXI, dhe mijëvjeçarin e tretë.

Përmes këtyre librave që i shihni të ekspozuara, dy gjëra mendoj se janë bërë të ditura me qartësi të madhe, që do të kenë ndikim në rendin e ri botëror dhe që kanë zënë fill në Kosovë: se të drejtat e njeriut qëndrojnë mbi sovranitetin dhe se popujt e vegjël nuk mund dhe nuk duhet të nëpërkëmbën vetëm për

faktin se janë më të vegjël dhe se kanë pasur fat më të keq në histori.

Por dua të them edhe një gjë, që mendoj se ka rëndësi në këtë 25-vjetor të NATO-s në Kosovë dhe po në këtë 25-vjetor të çlirimit të Kosovës: Kjo ekspozitë është edhe një thirrje për të mos harruar! Thirrje e kujtesës dhe e ndërgjegjes.

Në fund, më lejoni të them se ne, domethënë Akademia, tashmë kemi bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të specializimit të bibliotekës sonë me botime për Kosovën në gjuhë të huaja. Është mbledhur një lëndë solide bibliotekare dhe besoj se në një të ardhme të afërme do të arrijmë që bibliotekën e Akademisë me botime të këtilla, do ta hapim për të gjithë të interesuarit.

Ju faleminderit”

Ekspozitën e nderoi me një fjalë rasti kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Glauk Konjufca.

Në fund u mbajt një program artistik në të cilin dy pianistet e njohura Syzana Jakupi dhe Alba Muçolli Dehiri ekzekutuan vepra muzikore të kompozitorëve të shquar.

Kryeministri Kurti viziton ekspozitën: Kosova në gjuhët e botës



Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri

i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zoti Hajrullah Çeku, më 29 mars vizitoi ekspozitën *Kosova në gjuhët e botës*, e cila u hap në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në 25-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Kryeministri u prit nga kryetari i Akademisë, Mehmet Kraja dhe nga anëtarët e kryesisë: Justina Shiroka-Pula, Gjyljeta Mushkolaj dhe Fetah Podvorica. Kryetari i Akademisë e njoftoi kryeministrin Kurti për përmbajtjen e ekspozitës dhe për synimet e Akademisë që ky fond i librave të indeksohet në formë katalogu dhe të hapet për lexues dhe studiues të ndryshëm.

U mbajt tryeza shkencore: *Krijimtaria letrare e Ali Aliut në 90- vjetorin e lindjes*



Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 2 prill 2024, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë u mbajt tryeza shkencore “Krijimtaria letrare e Ali Aliut në 90-vjetorin e lindjes”.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Sabri Hamiti, kryetar i Këshillit organizues, ndërsa fjalë rasti mbajti akademik Mehmet Kraja, anëtar i Këshillit.

Tryeza u zhvillua në dy seanca dhe në të u paraqitën me kumtesa akademikë dhe studiues nga Kosova, Shqipëria, Italia dhe Maqedonia e Veriut: Sabri Hamiti, Shaban Sinani, Matteo Mandala, Zejnullah Rrahmani, Nysret Krasniqi, Arian Leka, Fatmir Sylejmani, Zija Çela dhe Resul Shabani.

Aktiviteti u përmbyll me fjalën përshëndetëse të akademik Ali Aliut.

Deputetë të Kosovës dhe Shqipërisë vizituan Akademinë



Më 3 prill Deputetë të komisioneve për arsim, shkencë dhe informim të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të prirë nga Ardian Golaj, kryetar i komisionit dhe Elvis Kushi, nënkryetare e komisionit, vizituan Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Deputetët i pritën anëtarët e kryesisë së Akademisë dhe kryetari, akademik Mehmet Kraja, i njoftoi mysafirët për punën e Akademisë, për organizimin e saj dhe për bashkëpunimin e frytshëm që Akademia e Kosovës ka me Akademinë e Shqipërisë. U shfaq interesim veçmas për ecurinë e deritashme të punës rreth projektit përbashkët *Enciklopedinë Shqiptare*, që është në realizim e sipër nga dy akademitë.

U mbajt konferenca shkencore: *Roli i Konferencës së Bujanit në procesin e shtetformimit të Kosovës*



Më 5 prill 2024, në organizim të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në Prishtinë u mbajt konferenca shkencore: *Roli i konferencës së Bujanit në procesin e shtetformimit të Kosovës*.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, kryetar i Këshillit organizues.

Konferenca u zhvillua në dy seanca dhe në të morën pjesë me kumtesa akademikë dhe studiues nga Kosova e Shqipëria: Jusuf Bajraktari, Fehmi Rexhepi, Marenglen Verli, Frashër Demaj, Arsim Bajrami, Beqir Meta, Hamit Kaba, Teki Kurti, Agim Zogaj, Salihe Salihu, Marenglen Kasmi dhe Arbër Hadri.

U mbajt simpoziumi shkencor: *Ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe konkurrueshmërisë*



Më 18 prill 2024, në organizim të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në Prishtinë, u mbajt simpoziumi shkencor *Ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe konkurrueshmërisë*.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Isa Mustafa, kryetar i Këshillit organizues.

Simpoziumi u zhvillua në tri seanca.

Me kumtesat e tyre u paraqitën akademikë dhe profesorë nga Kosova, Shqipëria: Justina Shiroka Pula, Liridon Kryeziu, Isa Mustafa, Hivzi Islami, Muhamet Mustafa, Alba Hashani, Besnik Krasniqi, Arsim Bajrami, Petrit Gashi, Neshat Podvorica, Avdullah Hoti, Valentin Toçi, Albulena Shala, Drita Konxheli, Ardiana Gashi, Nick J. Adnett, Hajdar Korbi, Njomza Latifi Mustafa dhe Shpresa Mehmeti Bajrami.

U mbajt *Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor*



Më 23-25 prill 2024 në Tiranë, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajt *Panairi i 3-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor*.

Panairin e shpallën të hapur akademik Skënder Gjinushi, kryetari ASHSH-së, akademik Mehmet Kraja, kryetar i

drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Piro Misha.

Në kuadër të kësaj vizite, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë iu dhuruan disa nga botimet më të fundit të realizuara nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.

Librat e dhuruar do të qëndrojnë të ekspozuar në Sallën Shkencore (Kati II) të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Akademik Rexhep Ismajli mban ligjëratë në Vjenë

Me ftesë të *Institut fur die Erforschung der Habsburgermonarchie und des Balkanraumes der Osterichen Academie der Wissenchaften*, më 7 maj 2024, akademik Ismajli në mjediset e reja të Akademisë austriake, ku është i vendosur ky institut, ka mbajtur ligjëratën me titull: *Albanistic studies in Yugoslavia 1918-1989. (Studimet albanistike në Jugosllavi 1918-1989)*. Moto e ligjëratës ishte: *Lindja e një disipline shkencore në rrethana survejimi*.

Akademik Ismajli në Vjenë ka realizuar edhe vizita të rëndësishme në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që ka ASHAK-u me Akademinë austriake.

U promovua libri: *Gjeopolitika, territori, konflikti* i akademik Hivzi Islamit dhe prof. Arsim Ejupit



Më 22 maj 2024, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në prani të shumë pjesëmarrësve nga bota akademike dhe shkencore, u bë promovimi i botimit: ***Gjeopolitika, territori, konflikti***, me nëntitull: *Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve* të autorëve Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi.

Në këtë botim gjithë materia shtjellohet në disa kaptina dhe shumë pika trajtimi. Botimi nis me definimin dhe zhvillimin e gjeopolitikës si disiplinë shkencore, rolin e saj në kuadër të sistemit të dijeve dhe të shkencave, pastaj me gjeopolitikën në kërkim të identitetit, zhvillimin e mendimit gjeopolitik, gjeopolitikën nga stigmatizimi te rehabilitimi, gjeopolitikën nga shkenca raciste, e instrumentalizuar nga regjimi nazist i Hitlerit, te kthyerja e “dinjitetit” shkencor të saj, sikundër edhe shqyrtimin e relacioneve midis gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë etj. Një nga problemet shumë komplekse që zë vend në këtë botim janë edhe gjeopolitika, gjeohapësira, kufijtë dhe konfliktet territoriale në botë (shembujt e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, çfarë janë India dhe Pakistani rreth Kashmirit, konflikti arabo-izraelit, problemet territoriale të Kinës me fqinjët, agresioni rus i paprovokuar dhe i pajustificuar ndaj Ukrainës, që është duke u zhvilluar në terren para syve të gjithë botës, duke e ndërruar pasqyrën gjeopolitike të gjithë botës etj.). Kaptinat qendrore që zënë vend të merituar në këtë botim janë politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe trojeve të tjera etnike shqiptare, si dhe

Ballkani si “fuçi baruti” dhe paaftësia e “Kontinentit Plak” për zgjidhjen e problemeve të rajonit.

Çështja e kufijve trajtohet në aspektin teorik dhe në hapësirat konkrete, sikurse është p.sh. kufiri midis Kosovës dhe vendeve fqinje, në veçanti me Serbinë, përfshirë shkëmbimin e territoreve midis saj dhe Serbisë si një qasje e dëmshme për Kosovën dhe Luginën e Preshevës, debatet rreth procesit të demarkimit të kufirit midis Kosovës Malit të Zi, pastaj instrumentalizimi i shkencës dhe vënia e saj në shërbim të qarqeve politike dhe parapolitike me qëllim që ato të shndërrohen në kauza politike në kuadër të luftës për pushtet të individëve dhe grupacioneve politike shqiptare të Kosovës etj. Tema e demarkacionit nisi dhe mbeti një kauzë e rrejshme dhe kufiri Kosovë – Mali i Zi sot e gjithë ditën mbeti aty ku ishte vijëzuar para 15 shkurtit 1947. Pasi erdhën në pushtet mashtuesit e votuan Marrëveshjen me Malin e Zi (2018) pa ia hequr asnjë presje tekstit të Marrëveshjes së mëparshme (2015). Çmimin e paguan qytetarët e Kosovës: mbetën të izoluar në lëvizjen e lirë në hapësirën e BE-së, në vend që Kosova të merrte liberalizimin në vitin 2016, kur ishte në paketë me Gjeorgjinë dhe Ukrainën! Liberalizimi faktik i qytetarëve të Kosovës ndodhi vetëm më 1 janar 2024, ndërkaq përparësitë dhe të metat tek i presim!

Tema në vete që trajtohen në këtë libër studimor janë demopolitika dhe gjeopolitika; Kosova në rrjedhat gjeopolitike dhe gjeopopullative vështuar në prizmin historik dhe etnik; konteksti i ndërlukuar i një lufte mirë të përgatitur përmes të ashtuquajturit “Front i Jugut” në fillim të viteve ‘90,

pastaj migrimet e jashtme dhe konteksti gjeohapësinor dhe gjeopolitik etj. Një pjesë e librit i kushtohet ujit si burim i konflikteve dhe mosmarrëveshjeve, si dhe bashkëpunimit ndërkufitar të Luginës së Preshevës (përparësitë dhe problemet gjeopolitike). Në fund jepen pjesë të zgjedhura të disa dokumenteve, në bazë të të cilave mund të kuptohen rikonfigurimi dhe ristrukturimi gjeopolitik i hapësirës ballkanike, evropiane dhe botërore, si dhe një pasqyrë e literaturës e burimeve, një rezyme në anglisht dhe indeksi i emrave. Botimi ka 569 faqe.

Aktivitetin e shpalli të hapur akademik Anton K. Berishaj, ndërsa për librin folën akademik Muhamedin Kullashi dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj.

Në fund të pranishmit i përshëndeti edhe autori i parë i librit, akademik Hivzi Islami.

U mbajt forumi shkencor: *Studimi gjeologo-sizmik të zonave së thyerjeve tektonike tërthore Kurbnesh – Kukës – Prizren dhe Shkodër – Pejë, si dhe vlerësime të rrezikut sizmik për një jetë më të sigurt*



Më 22 maj 2024, në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është mbajtur forumi shkencor: Studimi gjeologo-sizmik i zonave së thyerjeve tektonike tërthore Kurbnesh – Kukës – Prizren dhe Shkodër – Pejë, si dhe vlerësime të rrezikut sizmik për një jetë më të sigurt. Ky forum njëditor është bashkorganizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të bashkëpunimit. Organizimin e forumit e ka ndihmuar edhe Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”. Në forum kanë marrë pjesë studiues të ndryshëm nga Kosova dhe Shqipëria si dhe studentë. Forumin e ka përshëndetur në emër të Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut, prof. Fetah Podvorica, sekretar i këtij Seksioni, ndërsa në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e ka përshëndetur akad. Rrapo Ormeni. Në forum gjatë punimeve në dy seanca janë trajtuar nga aspekte të ndryshme, thyerjet tektonike aktive Kurbnesh – Kukës – Prizren dhe Shkodër – Pejë, të cilat paraqiten si zona me rrezik sizmik potencial, për sa u përket zonave urbane, infrastrukturës dhe veprave inxhinierike me karakter strategjik të cilat ndodhen të afërsi të saj.

Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj përfaqëson ASHAK-un në Kuvendin e përgjithshëm të ALLEA-s, në Berlin

Më 22 dhe 23 maj 2024, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj mori pjesë në Kuvendin e përgjithshëm të ALLEA-s, që shënoi edhe 30-vjetorin e themelimit.

Tema e simpoziumit ishte:
Bashkëpunimi kërkimor evropian në një

peizazh gjeopolitik në ndryshim: Sa të hapur mund të jemi?

Prof. Mushkolaj ka marrë pjesë në dy sesione të programit të përbashkët të ALLEA-s dhe ENYA (Akademitë Nacionale të të rinjve të Evropës).

U mbajt Konferenca shkencore: Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe pastrimi i ujërave të ndotura



Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës (ASHAK) në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 27 dhe 28 maj 2024 e bashkorganizon konferencën shkencore: *Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura*. Në ditën e parë u paraqitën studiues dhe ekspertë nga Kosova, Shqipëria dhe Austria. Këshillin organizativ të kësaj Konference e përbënin: prof. Salih Gashi kryetar i këshillit organizues shkencor, akad. Fejzullah Krasniqi, akad. Neki Frashëri, akad. Nexhat Daci, prof. Fetah Podvorica, akad. Ilirjan Malollari, prof. Besnik Baraj, prof. Myzafer Limani, prof. Roza Allabashi dhe prof. Valbona Kolaneci. Sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, prof. Fetah Podvorica, mbajti fjalën e hapjes, me ç’rast theksoi rëndësinë që kanë studimet për

resurset ujore, si dhe metodat e trajtimit të ujërave të ndotura duke përfshirë jo vetëm largimin e tyre prej ujërave, por edhe zbërthimin e plotë të tyre. Akad. Ilirjan Malollari përshëndeti në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe e potencoi rëndësinë e trajtimit të këtyre problematikave në shumë aspekte, sepse ndryshimet klimatike dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave janë ndër sfidat më të mëdha që përballet shoqëria sot. Prof. Salih Gashi, në emër të Këshillit organizues shkencor dha sqarime në lidhje me organizimin e konferencës, qëllimin e saj dhe temat që do të trajtohen prej 33 pjesëmarrësve. Në kuadër të qëllimit të konferencës ai theksoi rëndësinë që e ka diversifikimi i prodhimit të energjisë elektrike gjegjësisht tranzicioni energjetik në mënyrë që të zvogëlohet emetimi i gazrave serrë, pastaj menaxhimi i integruar i resurseve ujore, si dhe përdorimi i metodave dhe teknologjive të reja në pastrimin e ujërave të ndotura.

Më pas, në kuadër të konferencës, në ditën e parë u paraqiten 19 kumtesa. Kumtesat e tyre i paraqitën:

– Prof. Roza Allabashi – Infrastruktura e gjelbër, element i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave të shiut në zonat urbane

– Prof. Majlinda Daci-Ajvazi – Sfidat e ndryshimeve klimatike: Ndërtimi i një të ardhmeje më të qëndrueshme për Kosovën

– Akad. Ilirjan Malollari – *Teknikat inovative të gjelbra për kthim të ujërave industriale dhe organike të ndotura në vlerë përmes sistemeve bioinxhinierike*

– Prof. Fetah Podvorica- *Largimi i ndotësve organikë të qëndrueshëm prej ujit me anë të teknologjive të avancuara të oksidimit*

elektrokimik

– Akad. asoc. Besnik Baraj- *Rreziku potencial shëndetësor i biotës detare të gjirit të Vlorës: vlerësimi i niveleve të merkurit*

– Prof. Bashkim Thaçi- Efikasiteti i largimit të joneve të plumbit dhe kadmiumit prej tretësirave ujore duke përdorur boçat e pishës si biosorbent

– Prof. Petrit Zorba-*Gabimet në matjet dhe vlerësimin e reshjeve atmosferike, parë në kontekstin e skenarëve të ndryshimeve klimatike për Shqipërinë*

– Prof. Avdulla Alija-Ndotja e lumenjve në Kosovë nën kushte të ndryshimeve klimatike: Biomonitorimi i gjenotoksicitetit dhe vlerësimi i rrezikut

– Prof. Valbona Kolaneci-Rezervat peshkore në liqenet natyrore të Shqipërisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm të tyre

– Prof. Avni Berisha-Analiza e detajuar teorike e adsorbimit të "molekulave të përhershme" në oksid grafeni: një hulumtim ab initio

– Prof. Majlinda Vasjari-Modifikimi i pastës së karbonit me oksid të grafenit të reduktuar që përmban nanogrimca të metaleve dhe përdorimi i saj për përcaktim të merkurit dhe plumbit

– Prof. Kledi Xhaxhiu – Një material kompozit kompakt si pastrues universal i ujërave të ndotur

– Prof. Behxhet Mustafa-Parku i energjisë së erës në Bajgorë me rëndësi për uljen e ndotjes së mjedisit

– Prof. Nevila Broli-Sjellja voltammetrike dhe përcaktimi i antibiotikëve makrolitë me anë të sensorëve nanostrukturorë me bazë karboni

– Msc Muhamed Farruku-Hulumtimi i sjelljes së ekstraktit alkoolik të gjetheve Ulmus L. si inhibitor i gjelbër i korrozionit në mjedis acid për tubacionet e çelikut të karbonit të përdorur për transportin e ujit

– Prof. Sonila Duka-Vlerësimi i ndryshimeve hapësinore dhe kohore të

Indeksit të cilësisë së ujit (EQI)/ Shembull studimor – Liqeni i Shkodrës
 – Prof. Majlinda Mecaj-Vlerësimi i ndotjes së mjedisit ujor në vendburimet hidrokarbure dhe rekomandimet për rehabilitimin e tij
 – Prof. ass. Flamur Sopaj-Hekuri metalik si burim i katalizatorit për procesin Fenton gjatë degradimit të metiloranzhit
 – Prof. Bledar Pepa-Vëzhgim mbi biomonitorimin e lumenjve shqiptarë me anë të gjallesave bentike: Arritje dhe sfida

Në ditën e dytë të Konferencës shkencore “Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura” të organizuar nga Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ASHAK) në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 28 maj 2024, në ora 9 e 30, u vazhdua me paraqitjen e kumtesave nga pjesëmarrësit e paraparë me program me ç’rast u paraqiten 12 kumtesa.

Kumtesat e tyre i paraqitën:
 – Prof. Mihone Kerolli – *Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në basinin e lumit Ibër në Kosovë*
 – Dr. Albana Veseli- *Përdorimi i senzorit elektrokimik për përcaktimin e Eritromicinin në burimet e ujërave të pijshëm.*
 – Dr. Enis Dalo- *Vlerësimi i ndotjes me metale të rënda (Nikel, plumb dhe zink) në sedimentin e Lumbardhit*
 – Ms. Kristi Thodhorjani- *Ndikimi i ndryshimeve klimatike në prodhimin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë*
 – Msc. Nensi Isak- *Shfrytëzimi i argjilave natyrore të Shqipërisë si adsorbent për pastrim të ujit prej pesticideve të ndryshme*
 – Msc. Sara Dervishi – *Zbërthimi i*

Rodaminës B në ujë duke përdorur fotokatalizatorët e TiO₂ të dopuar me metale në zeolite ose në nano-substratet e grafitit
 – Prof. ass. Albana Mehmeti-Uji, *mundësitë e trajtimit dhe sfidat e ruajtjes*
 – Dr. Bukurije Hoxha-Efektet e përdorimit të hidroenergjisë në Kosovë në ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
 – Msc. Sadik Cenolli-Përcaktimi elektrokimik i azitromicinës me elektroda pastë karboni të modifikuara me nanomateriale
 - Msc. Ana Ameda “Përcaktimi i metaleve të rënda duke përdorur elektrodën me bazë –rGO”.
 – Dr. Jonilda Llupa- *Menaxhimi i ujërave të ndotura në industrinë e prodhimit dhe procesimit të lëngjeve të frutave: rasti i Shqipërisë*
 – Dr. Imer Sadriu- *Përdorimi i karbonit dhe grafitit të veshur në sipërfaqe me polimerë me gjurmë molekulare për detektim elektrokimik të izoproturonit.*
 – Prof. Jonida Canaj- *Karakteristikat kryesore të komponimeve policiklike aromatike dhe ekspozimi i tyre në ujë dhe ajër, efektet toksike të tyre*

Pas përfundimit të prezantimit të punimeve të konferencës në ora 13.15 prof. Fetah Podvorica, në emër të Këshillit organizues të konferencës i paraqiti në formë preliminare konkluzionet e konferencës dyditore ku në mes tjerash vuri në pah rëndësinë e prezantimeve të paraqitura për ta sqaruar gjendjen aktuale të ujërave në Kosovë dhe Shqipëri pastaj janë potencuar dhe shkaktarët që ndikojnë në ndotjen e tyre, si dhe janë prezantuar metoda dhe teknika të ndryshme të monitorimit të parametrave të ndryshëm. Janë prezantuar edhe metoda që mundësojnë largimin efikas të

ndotësve duke përfshirë edhe degradimin e plotë të tyre. Është vënë në pah rëndësia e kërkimeve shkencore për të mundësuar menaxhimin e integruar të resurseve ujore, si dhe krijimin e infrastrukturës së gjelbër, si element i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave të shiut në zonat urbane. Efektet e ndryshimeve klimatike janë të pranishme kudo në planet dhe manifestohen edhe në vendet tona përmes valëve të nxehtësisë, temperaturave shumë të larta gjatë stinës së verës, thatësive, por edhe reshjeve të rrëmbyeshme të shiut, shfaqjes së zjarreve në pyje etj. Pastaj prof. Besnik Baraj foli në emër të pjesëmarrësve nga Shqipëria ku në mes tjerash e potencoi rëndësinë e organizimit të përbashkët të ngjarjeve të tilla shkencore, e vlerësoi lart organizimin shumë të mirë të konferencës, si dhe cilësinë e punimeve të prezantuara gjatë dy ditëve.

U nda nga jeta akademik Rexhep Ferri



Më 6 qershor 2024, në moshën 86-vjeçare vdiq njëri ndër piktorët më të mëdhenj të artit shqiptar, akademik Rexhep Ferri.

Akademik Ferri i përket gjeneratës së artë të piktorëve kosovarë.

Rexhep Ferri u lind në Kukës më 1937. Në vitin 1958 mbaroi Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa në vitin 1966 u diplomua në degën e pikturës të Akademisë së Arteve në Beograd. Në periudhën 1974-2005 ishte pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Ka hapur ekspozita të pavarura në Galerinë e Kolektivit Grafik në Beograd (1968 dhe 1973), në Galeria Darte II Cenacolo, Viçenca, Itali (1969), në Galerinë e Qendrës Kulturore, Beograd (1976), në Galerinë *Lambert*, Paris (1977) në Galerinë e Muzeut Kombëtar, Nish (1980), në Galerinë e Arteve, Prishtinë (1982), në Galerinë e Arteve, Sarajevë (1983), në Galerinë Vakko, Izmir, Ankara dhe Stamboll (1989), në Galerinë Vakko, Stamboll (1998), në Galerinë Kombëtare, Tiranë (2001), në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2020) etj.

Më 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i kësaj Akademie.

Ka botuar libra me poezi, romane, ese. Veçohen nëntë tituj të përmbledhur në veprat e zgjedhura letrare.

Më 1971 mori Çmimin e Dhjetorit të Kuvendit të Kosovës, ndërsa në vitin 2012, me rastin e 100 - vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, iu dha titulli Qytetar Nderi i Vlorës.

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës u hap ekspozita tij personale me veprat e zgjedhura. Po në Akademi u botua edhe monografia për veprën e tij.

Në respekt të jetës dhe veprës së akademik Rexhep Ferrit, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 7 qershor 2024 u mbajt mbledhja komemorative dhe më pas, deri në orën 12:00 u bënë homazhe.

Mbledhja filloi me një minutë heshtje dhe më pas fjalën e mori kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Mehmet Kraja.

Për jetën dhe veprën e akademik Ferrit foli akademik Eqrem Basha.

Në mbledhje mori pjesë edhe kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti i cili mbajti një fjalë mortore në nderim të akademik Ferrit.

U lexuan dy telegrame ngushëllimi:

Telegram ngushëllimi nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe nga anëtar korrespondent Xhevdet Xhafa.

Varrimi i akademik Ferrit u bë më 7 qershor 2024, në orën 13:00 në varrezat e Prishtinës.

U mbajt konferenca shkencore: 25-vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekull shtetndërtim, arritje dhe sfida – qasje multidisiplinare



Konferenca u mbajt më 10 qershor 2024.

Fjalën e hapjes e mbajti anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj,

sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Fjalë rasti mbajti akademik Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë i cili tha:

“Të nderuar miq,

Zoti kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti president Sejdiu, zoti president Mojsiu

Të nderuar akademikë, zoti i kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zoti Gjinushi

Të nderuar të pranishëm!

Në hapje të kësaj konference për 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, më lejoni të bëj një si përkufizim të shpejtë të kësaj ngjarjeje dhe të them se për kombin tonë çlirimi i Kosovës ishte ngjarja e dytë më me rëndësi në historinë shqiptare të shekullin XX, krahas pavarësisë së Shqipërisë.

Por ajo që na bën të mendohemi më gjatë për këtë ngjarje historike, të pangjashme në historinë tonë, është dimensionin kontemporan, botëror, që mori ky zhvillim i pazakonshëm për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe botën demokratike: askush më nuk e konteston se lufta për Kosovën bëri një ndryshim thelbësor në mënyrën e konceptimit të lirisë së popujve, demokracisë dhe vetadministrimit, parime këto që për shumë kohë u shkelën rëndë në vendimmarrjet historike, veçmas në konferencat e paqes. Pra, një ndryshim konceptual, botëkuptimor, në njohjen e së drejtës për liri të kombeve dhe jetë të dinjitetshme të të gjithë njerëzve të mbarë planetit.

Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i Kosovës është ndryshim konceptual dhe vlerë botërore edhe për një mori çështjesh të tjera, që lidhen me perceptimin e së

drejtës në marrëdhëniet
ndërkombëtare, në sovranitetin e
shteteve, ndryshime këto që
bashkëkohësuan mendimin politik dhe i
dhanë dimension human të drejtës së
ftohtë dhe ndonjëherë të egër të lirisë
dhe vetëvendosjes së popujve.

Për ne, ndërkaq, që mësuam historinë,
por nuk ishim aq të sigurt nëse do ta
jetonim atë, çlirimi i Kosovës nuk do të
pushojë të jetë, përveç se ngjarje me
vlerë sipërore, edhe një mësim i
jashtëzakonshëm i historisë për aleancat
politike, sepse tashmë është e qartë se
Shqipërinë dhe Kosovën, me gjithë
ankesat tona të hershme dhe të vona, e
bëri mendimi politik oksidental dhe nuk e
morëm asnjë ndihmë sado të vogël ose
mbështetje nga gjysma tjetër e globit.

Unë nuk besoj në coincidenca as profeci,
besoj në vullnetin e njeriut, në mendjen
dhe pasionet e tij. Por këtë bindje ma
luhat një fakt i çuditshëm: çlirimi i
Kosovës ndodhi më ditën e Lidhjes
Shqiptare të Prizrenit. Thashë, nuk i besoj
koincurrencës, por i besoj një fakti tashmë
të ngulitur në vetëdije se dy shekujt e
shkuar bënë kombin dhe shtetet tona:
Lidhja e Prizrenit bëri kombin shqiptar,
shekulli XX bëri dy shtetet tona.

Shekulli XXI ende nuk e ka thënë për ne
fjalën e vet!

Ju faleminderit!"

Konferencën e nderoi me praninë e tij
kryeministri i Republikës së Kosovës, z.
Albin Kurti, i cili po ashtu mbajti një fjalë
rasti.

Me fjalë rasti u paraqitën edhe z. Fatmir
Sejdiu ish- president i Republikës së
Kosovës dhe z. Alfred Mojsiu ish-
president i Republikës së Shqipërisë.

Në këtë konferencë u paraqitën me
kumtesat e tyre akademike dhe
profesorë nga Kosova dhe më gjerë, si:

Paskal Milo, Muhamendin Kullashi,
Sonja Biserko, Mark Baskin, Arsim
Bajrami, Valentina Duka, Frashër
Demaj, Ksenofon Krisafi, Hajredin Kuçi,
Ibrahim Gashi, Gjyljeta Mushkolaj,
David L. Phillips, Bekim Baliqi dhe
Salihe Salihu.

Koncerti Festiv



Më 10 qershor 2024, me fillim prej orës
19:00, Akademia e Shkencave dhe e
Arteve e Kosovës (ASHAK) mbajti
koncert festiv për nder të 25-vjetorit të
Ditës së Çlirimit të Kosovës.

Në koncert performoi ansambli i
harqeve *Academia Albanica*, me
dirigjent Eno Koço dhe nën udhëheqjen
artistike të Lorenc Radovanit.

U promovua libri: *Proceset dhe ciklet termodinamike* i akademik Fejzullah Krasniqit dhe prof. Naser Sahitit



Më 24 qershor 2024 në lokalet e
ASHAK-ut u bë promovimi publik i librit

me titull *Proceset dhe ciklet termodinamike* i autorëve akademikë Fejzullah Krasniqi dhe prof. Naser Sahiti. Në promovim morën pjesë kryetari dhe nënkryetarja e ASHAK-ut, anëtarë të ASHAK-ut si dhe profesorë dhe staf akademik i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe të njësive të tjera akademike.

Fjalën përshëndetëse e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i cili njëherësh e mbajti edhe fjalimin në emër të recensentëve të librit. Në fillim ai potencoi faktin se ky libër është shpallur libri fitues i Çmimit *Vepra më e mirë studimore* në panairin e 3-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, që u mbajt nga data 23-25 prill 2024 në Tiranë, organizuar në bashkëpunim mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit me motivacionin: *Një vepër që pasqyron zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë së termodinamikës, fokusuar në problemet konkrete të ngrohjes, përmes një analize dhe sinteze të detajuar të proceseve më të rëndësishme termodinamike, duke shenjuar një arritje në studimet shqiptare.*

Më tutje, duke u bazuar në raportin e recensentëve të librit akad. Nexhat Daci dhe akad. Isuf Krasniqi, prof. Fetah Podvorica foli në detaje për përmbajtjen e librit i cili ka 6 kapituj të cilët janë të shpërndarë në 700 faqe të librit dhe paraqet një analizë dhe sintezë të thukët dhe cilësore të proceseve dhe cikleve termodinamike dhe në këtë aspekt vlerësohet edhe si një kontribut i caktuar i autorëve në

rrafshin shkencor dhe profesional. Në raport theksohet gjithashtu se libri *Proceset dhe ciklet termodinamike* mund të shërbejë si material i rëndësishëm edhe për studentët e nivelit master dhe të doktoraturës shkencore në lëmin e shkencave teknike në përgjithësi dhe në inxhinierinë mekanike në veçanti.

Në fund të promovimit, autorët e librit, akademik Fejzullah Krasniqi dhe prof. Naser Sahiti mbajtën fjalë rasti. Në fjalën e tij akademik Krasniqi duke komentuar rëndësinë e librit, në mes tjerash, theksoi se përveç analizës së bilancit energjetik të cikleve të punës e cila mjaftohet vetëm me përdorimin e ligjit të parë të termodinamikës, në libër është studiuar edhe analiza eksergjetyke e cikleve. Kjo analizë duke e përfshirë edhe Ligjin e dytë të termodinamikës, e shpreh aspektin cilësor të energjisë. Në këtë mënyrë, analiza eksergjetyke del më e plotë, më përmbajtësore dhe si të tillë edhe më e besueshme. Ai theksoi se ky libër do jetë një ndihmesë e madhe për komunitetin shkencor të fushës së termoteknikës dhe termoenjergjetikës dhe se në të mund të gjenden mjaft konkluzione dhe kontribute origjinale shkencore të cilat nuk hasen në literaturën aktuale.

Ndërsa prof. Naser Sahiti në mes tjerash potencoi rëndësinë që e ka përmirësimi i efijencës së energjisë dhe aplikimit të teknologjive të tjera miqësore ndaj mjedisit në tranzicionin energjetik. Në këtë kontekst, libri aktual është shkruar ashtu që të shërbejë qoftë për nxitjen e hulumtimit lidhur me mundësitë e rritjes së efijencës së energjisë p.sh. të termocentraleve dhe në këtë mënyrë zvogëlimin e ndotjes mjedisore enorme

e cila rezulton nga këto impiante, qoftë për eksplorimin e mundësve alternative të prodhimit të energjisë, siç janë prodhimi i kombinuar i energjisë apo shfrytëzimi racional i pompave të nxehtësisë, por edhe për ofrimin e mundësive që hulumtimet përkatëse eksperimentale ose numerike të prezantohen në mënyrë të qëndrueshme dhe konsistente shkencore dhe në këtë mënyrë të bëhen të qasshme për komunitetin shkencor.

Ceremonia e ndarjes së Çmimit *stimulus nga lëmi i shkencave të natyrës*



Më 28 qershor 2024 në lokalet e ASHAK-ut u mbajt ceremonia për ndarjen e Çmimit *stimulus nga lëmi i shkencave të natyrës*. Në të morën pjesë kryetari dhe nënkryetarja e ASHAK-ut, anëtarë të ASHAK-ut, përfaqësuesi Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, laureatët e çmimit, si dhe të ftuar të tjerë.

Ceremoninë e udhëhoqi sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i cili njëherësh ishte edhe kryesues i Këshillit për përzgjedhjen e kandidatëve për Çmimin *stimulus nga lëmi i shkencave të natyrës* në kuadër të Seksionit të Shkencave të

Natyrës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Në fillim të ceremonisë një fjalë përshëndetëse e mbajti kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet Kraja. Ai në mes tjerash potencoi faktin se me ndarjen e këtij çmimi, ASHAK-u e tregon përkushtimin që të vlerësojë të arriturat e shkencëtarëve të rinj duke e bërë promovimin e arritjeve të tyre shkencore. Me këtë hap ASHAK-u po e përmbush një obligim të ALLEA-s, Aleancës së të gjitha Akademive të Shkencave të Evropës, që të përkujdeset për shkencëtarët e rinj dhe perspektivën e tyre. Në këtë kuadër, u nxor nga harresa *Çmimi stimulus për shkencëtarët e rinj* i themeluar shumë vite më parë, në mbështetje të një donacioni anonim, me një shpresë deridiku të justifikuar, se donacione të këtilla ose të ngjashme do të kemi edhe në të ardhmen dhe se ky çmim të bëhet i përvitshëm dhe tradicional. Ai mendon se Akademia duhet të themelojë edhe çmime dhe mirënjohje të tjera dhe të braktisë një herë e mirë vanitetet dhe shpirtngushtësinë provinciale dhe të sillet si lider institucional, ashtu siç e ka edhe përkufizimin ligjor dhe reputacionin publik.

Më pastaj, anëtari korrespondent Fetah Podvorica tregoi për procedurën që e ka ndjekur Këshilli për përzgjedhjen e kandidatëve për Çmimin *stimulus nga lëmi i shkencave të natyrës* i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Këshilli i ka shqyrtuar me kujdes 26 aplikacionet e kandidatëve të paraqitur në *lëmin e shkencave të natyrës, inxhinierisë dhe teknologjisë, mjekësisë dhe shëndetit, si dhe bujqësisë*. Duke u bazuar në qëllimin e konkursit i cili synonte

stimulimin e punës kërkimore-shkencore të të rinjve deri në moshën 36 vjeç, që kanë të arritura të larta gjatë karrierës së tyre së deritanishme, dhe në planin strategjik të ASHAK-ut, në pikën 2, që e thekson nevojën e kujdesit për krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore të brezit të ri, gjegjësisht pikën 2.6 që e thekson faktin se ASHAK-u angazhohet që krijuesit e rinj të shpërblehen për arritjet e larta shkencore dhe artistike në Kosovë, Këshilli ishte përcaktuar për kriteret si në vazhdim: a) Çmimi stimulues t'i ndahet kuadrit shkencor që punon në institucionet e Kosovës dhe b) Njëri çmim t'i ndahet një shkencëtareje të re dhe tjetri një shkencëtari të ri. Këshilli, njëzëri, kishte ardhur në përfundim se:

1. Prof. asoc. Armond Daci, (lindur më 18 nëntor 1988)
2. Prof. ass. Bukuriye Hoxha, (e lindur më 28 qershor 1996)

ishin dy kandidatët e propozuar për marrjen e *Çmimit stimulues në kuadër të Seksionit të Shkencave të Natyrës* së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe këtë propozim e kishte miratuar Kryesia e ASHAK-ut.

Më tutje në ceremoni foli anëtar korrespondent i ASHAK-ut Arsim Morina, njëherësh anëtar i Këshillit për përzgjedhjen e kandidatëve për Çmimin stimulues. Ai paraqiti disa të dhëna për zhvillimin e karrierës së tij akademike, si dhe të arriturat e prof. asoc. Armond Dacit, nga Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës. Prof. Asoc. Armond Daci i ka 31 publikime të botuara në platformat kryesore të revistave shkencore, 8 prej tyre si autor i parë dhe tri punime si autor korrespondent. Punimet e

botuara si autor i parë i ka të botuara në revistat që gjenden të ranguar në çerekun e parë, Q1 dhe në atë të dytë, Q2. Në platformën Scopus, aktualisht, i ka 364 citime dhe e ka indeksin Hirsch 11. Është koordinator prej UP-së i projektit “Increasing research capacities in Kosovo – Nanoparticles in the Environment and Medical Research – NanoKos” të financuar prej Unionit Europian.

Ndërsa anëtare korrespondente e ASHAK-ut, Myzafer Limani, anëtare e Këshillit për përzgjedhjen e kandidatëve për Çmimin stimulues. Ajo së pari theksoi se prof. ass. Bukuriye Hoxha ka pasur të arritura shkencore në një disiplinë shkencore mjaft të veçantë në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës. Pastaj ajo paraqiti disa të dhëna nga të arriturat e saj. Ajo i ka 13 punime publikime të botuara në platformat kryesore të revistave, 6 prej tyre si autore e parë dhe tri punime si autore korrespondente. Në platformën Scopus, aktualisht, i ka 35 citime dhe e ka indeksin Hirsch 4.

Pas ndarjes së Çmimit stimulues nga ana e kryetarit të ASHAK-ut, akademik Kraja, për të dy fituesit e tij, këta mbajtën nga një fjalë të shkurtër falënderimi.


Prof. asoc. Armond Daci në mes tjerash theksoi se e vlerëson shumë këtë çmim të ndarë nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i cili do ta motivojë që të punojë edhe më shumë në ardhmen. “Sot është një ditë e veçantë se puna në festë e në veçanti gjatë këtij rrugëtimi akademik dhe udhe shtegtimit tim, nëpër shumë vende për shumë vite padyshim që është një sakrificë. Kemi bërë shumë bashkëpunime dhe shumë

grupe shkencore, por ajo që më bën të ndihem mirë sot këtu është sepse ndihem i vlerësuar nga vendi im”, tha ai.

Prof. ass. Bukuriye Hoxha theksoi se ndjehet shumë e respektuar për këtë çmim të ndarë nga ASHAK-u, të cilin e falënderoi për vlerësimin e bërë për të arriturat e saj. Ajo tha po ashtu se ky çmim do të shërbejë për të dhe për kolegët e saj si një motiv për rritje të punës shkencore, për avancimin e saj në një fushë të rëndësishme siç është energjia e ripërtërishme e cila lidhet aktualisht me ndryshimet klimatike për të cilat jemi dëshmitarë me gjendjen aktuale.

Ceremonia përfundoi me dy pika muzikore që i ekzekutuan pianistet Syzana Jakupi dhe Alba Muçolli-Dehiri.

U nda nga jeta shkrimtari Ismail Kadare, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës



Me pikëllim të thellë ASHAK-u mori lajmin e trishtuar se është ndarë nga jeta shkrimtari Ismail Kadare, emblema

e letërsisë bashkëkohore shqipe, njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj dhe më të njohur të letërsisë europiane, kandidat i shumëfishtë për çmimin Nobel dhe fitues i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve ndërkombëtare, vepra e të cilit është përkthyer në më shumë se dyzet gjuhë të botës.

Përveç si shkrimtar, Ismail Kadare ishte personaliteti qendror i kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, protagonist i zhvillimeve më të përparuara në letërsinë shqipe gjatë kësaj periudhe. Lindi në Gjirokastrë, studioi gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës dhe letërsi botërore në Moskë. Fillimet letrare të Kadaresë janë kryesisht në poezi (“Frymëzime djaloshare”, 1954; “Ëndërrimet”, 1957; “Shekulli im”, 1961; “Përse mendohen këto male”, 1964; “Motive me diell”, 1968; “Koha”, 1976). Me emrin e tij lidhet ardhja në letërsi e “brezit të viteve 1960”, që solli një frymë emancipimi të përgjithshëm në kulturën kombëtare.

Vepra e parë e rëndësishme e Kadaresë është romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1963), që është një pikë kthese në prozën moderne shqiptare. Në prozën e tij, Kadare e vështroi të shkuarën jo vetëm si histori qëndrese heroike, por si histori mbijetese të identitetit shqiptar. Pason romanet: “Prilli i thyer”, “Kamarja e turpit”, “Pashallëqet e mëdha”, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Vit i mbrapshtë”, “Shkaba”, “Spiritus”, “Hija”, “Pasardhësi”, ku vihen përballë vlerat e jetës dhe çmimi i vdekjes. Romani “Kush e solli Doruntinën” (1979) solli te lexuesi ringjalljen e baladave të hershme shqiptare, ndërkaq “Kronikë në gur” (1971) është

romani i dytë i Kadaresë që trajton temën e luftës antifashiste. Romani “Kështjella” është quajtur “roman historik”, por dhe “roman i heroit të papranishëm”. Autori arrin të ngrejë në këtë roman kultin e bashkësisë në vend të kultit të heroit të përveçëm.

Romanet e Kadaresë me temë nga historia, të shkuarën e kanë kryesisht si një shkas për të sotmen. Nocioni i kështjellës është i pranishëm edhe te “Prilli i thyer” (kulla e ngujimit); te “Krushqit janë të ngrirë”, te “Ndërtimi i piramidës së Keopsit”, te “Piramida”, ndërsa nocioni i urës gjendet tek “Ura me tri harqe”, “Kush e solli Doruntinën”, “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, “Kushëriri i engjëjve”. Romani “Dimri i vetmisë së madhe”, që u botua më 1973, trajtohet tema e konfliktit me sovjetikët. Romani tjetër “Koncert në fund të dimrit” (1987), trajton temën e konfliktit me kinezët. Romani “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” (1979) përfaqëson veprën më problematike dhe më mospajtuese të Kadaresë me realizmin socialist. Thelbi i romanit është alegoria politike antitotalitariste, duke marrë shkas prej mënyrës së funksionimit të ish-Perandorisë Osmane.

Ndërkaq, letërsia e Kadaresë pas vitit 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike dhe shpërfaqjen e identitetit shqiptar.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës më 1991 e zgjodhi Kadarenë anëtar të jashtëm të saj, për kontributin e çmuar në fushën e letërsisë.

Me këtë rast Akademia u shpreh ngushëllime të thella familjes Kadare, shkrimtarëve, miqve të shumtë dhe

institucioneve kulturore dhe shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, të mërkurën, më 3 korrik 2024, në ambientet e saj, mbajti mbledhje komemorative në nderim të veprës dhe personalitetit të Ismail Kadaresë.

Mbledhja u mbajt me praninë e anëtarëve të Akademisë dhe të pjesëmarrësve të tjerë të shumtë. Për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë folën akademikët Mehmet Kraja, Sabri Hamiti dhe Rexhep Ismajli. Në fjalët e tyre ata tërhoqën vëmendjen për vlerat e qëndrueshme të veprës së Kadaresë dhe për raportet e tij të veçanta me Kosovën. Mbështetja e Kadaresë për Kosovën ka qenë e jashtëzakonshme, e vazhdueshme, substanciale. Zëri i Kadaresë në mbështetje të Kosovës ka krijuar kontekst politik ndërkombëtar, ka arritur të depërtojë nëpër kancelaritë e ftohta diplomatike dhe ka qenë frymëzim për shumë gjenerata intelektualësh, mësuesish, studentësh, nxënësish, pra për një masë të gjerë njerëzish në Kosovë, përfshirë edhe ata që, në aktin final të kësaj historie, u vunë në radhët e para të luftës për çlirimin e Kosovës. Vepra letrare e Kadaresë, shkrimet dhe analizat publicistike, intervistat dhe deklaratat, por edhe mesazhet gojore, kanë luajtur rol emancipues për Kosovën dhe kosovarët, u tha me këtë rast.

Në Tiranë në mbledhjen komemorative të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në emër të ASHAK-ut mori pjesë me fjalë rasti akademike Justina Sh. Pula, nënkryetare e Akademisë, e cila më pas

mori pjesë edhe në ceremoninë e varrimit.

Konferenca shkencore: *Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024*



Më 2 korrik 2024, me fillim prej orës 9:30, në organizim të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në Prishtinë, u mbajt konferenca shkencore: *Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024*.

Konferenca nisi me shënimin e 34-vjetorit të shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990.

Konferencën e hapi anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Në hapjen solemne të kësaj konference ishin të pranishëm ish-delegatët e Kuvendit të Kosovës, të cilët morën pjesë në shpalljen e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe pjesëmarrës të tjerë të kësaj ngjarjeje të rëndësishme të historisë më të re të Kosovës.

Për rolin historik të Deklaratës Kushtetuese, për aktin e shpalljes dhe për hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Kaçanikut (7 shtator

1990), folën Iliaz Ramajli, Muharrem Shabani dhe prof. Ismet Salihu.

Punimet e konferencës u zhvilluan në dy seanca dhe në to u paraqitën me kumtesa akademikë dhe profesorë nga Kosova dhe Shqipëria, si: Arsim Bajrami, Aurela Anastasi, Erind Merkuri, Gjyljeta Mushkolaj, Jusuf Zejneli, Ksenofon Krisafi, Ilir Barjaba, Kosta Barjaba, Mirlinda Batalli, Arta Rama Hajrizi, Florent Muçaj, Gresa Caka Nimani, Visar Morina, Salihe Salihu, Kejsi Rizo, Nijazi Halili dhe Lulëzim Nika.

Konferencën e shpalli të mbyllur prof. Arsim Bajrami.

Akademik Mehmet Kraja merr pjesë në manifestimin letrar: *Kalimera poetike, në Ulqin*

Akademik Kraja bashkë me akademik Ali Aliun qëndruan në Ulqin më 2-6 gusht 2024. Ata morën pjesë në manifestimin letrar: *Kalimera poetike - Basri Çapriqi*, që mbahet çdo vit në Ulqin. Akademik Kraja mori pjesë dhe u paraqit me fjalën e tij në mbrëmjen e parë që iu kushtua shkrimtarit Ismail Kadare dhe foli për raportet e Kadaresë me Kosovën dhe me veprat e tij letrare kushtuar Kosovës. Ai po ashtu me fjalë u paraqit edhe në mbrëmjen e dytë me ç'rast foli për veprimtarinë letrare të akademik Ali Aliut. Që të dy akademikët (M. Kraja dhe A. Aliu) morën pjesë edhe në mbrëmjen kushtuar poetit Sadik Bejko.

ASHAK shpall zgjedhjet për anëtarë të saj

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në përputhje me Ligjin dhe

Statutin, më 2 shtator 2024 u ka vënë në dispozicion institucioneve përkatëse *Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë*, e cila është miratuar në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 30 gusht 2024.

Në tekstin e Qarkores është saktësuar kush mund të bëjë propozimet, mënyra si bëhen ato dhe deri kur është afati për paraqitjen e kandidatëve.

Takim i përbashkët i redaksive Kosovë-Maqedoni e Veriut



Në kuadër aktiviteteve të rregullta të punës për hartimin e *Enciklopedisë Shqiptare*, më 4 shtator në Prishtinë, në ambientet e Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Kosovë u mbajt një takim pune i dy redaksive të Enciklopedisë: i Redaksisë vendore të Kosovës dhe Redaksisë së posaçme të Maqedonisë së Veriut. Takimi kishte për qëllim shqyrtimin dhe diskutimin e fjalësit të zërave për Maqedoninë e Veriut të Enciklopedisë Shqiptare, një regjistër i gjerë emëror i artikujve që do të shkruhen nga autorë të ndryshëm, që kanë për tematikë personalitete, subjekte, dukuri, ngjarje dhe fenomene të jetës së shqiptarëve në hapësirën gjeografike të këtij shteti, përfshirë trashëgiminë historike, politike dhe kulturore të këtij entiteti.

Në këtë takim, Redaksisë vendore të

Kosovës i priu kryeredaktori për Kosovën i *Enciklopedisë Shqiptare*, akademik Mehmet Kraja, ndërsa

Redaksisë së posaçme të Maqedonisë i priu prof. Aziz Pollozhani.

Takime të redaksive të fushave Kosovë-Shqipëri të projektit Enciklopedia Shqiptare

Më 16 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, filluan të mbahen takime të redaksive të fushave Kosovë-Shqipëri të projektit *Enciklopedia Shqiptare*.

Sot u mbajtën takimi i fushës Letërsia, kryesuar nga akademik Sabri Hamiti, takimi i fushës Albanologjia, kryesuar nga anëtar korrespondent Shkumbin Munishi, dhe takimi i fushës Arkeologjia dhe lashtësia, kryesuar nga akademik Jusuf Bajraktari.

Takime të redaksive të fushave Kosovë-Shqipëri të projektit Enciklopedia Shqiptare

Më 17 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajtën takimi i fushës *Ekonomi dhe financa*, kryesuar nga akademike Justina Shiroka-Pula dhe takimi i fushës *Sistemet politike dhe drejtësia*, kryesuar nga anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj.

18 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt takimi i fushës *Arsimi*, kryesuar nga prof. dr. Naser Zabeli, takimi i fushës *Mesjeta, Bizanti dhe periudha osmane*, kryesuar

nga prof. dr. Muhamet Mala dhe takimi i fushës *Rilindja kombëtare*, kryesuar nga anëtari korrespondent Frashër Demaj.

Më 19 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajtën takimi i fushës *Historia e shekullit XX*, kryesuar nga prof. dr. Fehmi Rexhepi dhe takimi i fushës *Lufta e viteve 1998-1999*, kryesuar nga prof. dr. Arbër Hadri.

Më 20 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt takimi i fushës *Ngulmimet historike dhe diaspora*, kryesuar nga prof. dr. Kosovar Basha, takimi i fushës *Religjioni*, kryesuar nga prof. dr. Jahja Drançolli, dhe takimi i fushës *Sportet*, kryesuar nga prof. dr. Albert Mecini.

Më 23 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt takimi i fushës *Gjeografia fizike*, kryesuar nga prof. dr. Valbon Bytyqi dhe takimi i fushës *Gjeografia sociale*, kryesuar nga prof. dr. Arsim Ejupi.

Më 24 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt takimi i fushës *Shkencat shoqërore-Filozofi/Sociologji/Psikologji*, kryesuar nga prof. dr. Shemsi Krasniqi, takimi i fushës *Artet pamore*, kryesuar nga akademik Eqrem Basha, takimi i fushës *Artet skenike dhe filmi*, kryesuar nga prof. dr. Besim Rexhaj, takimi i fushës *Informimi*, kryesuar nga prof. dr. Binak Kelmendi, takimi i fushës *Trashëgimia kulturore*, kryesuar nga prof. dr. Tahir Latifi, dhe takimi i fushës *Artet muzikore*, kryesuar nga akademik Rauf Dhomi.

Më 25 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajtën takimi i

fushës *Shkencat e natyrës-Biologjia/Kimia/Fizika/Matematika*, kryesuar nga anëtari korrespondent Fetah Podvorica, takimi i fushës *Shkencat e mjedisit*, kryesuar nga anëtari korrespondent Salih Gashi, takimi i fushës *Bujqësi dhe blegtori*, kryesuar nga prof. dr. Bajram Berisha dhe takimi i fushës *Industritë dhe teknologjitë*, kryesuar nga anëtare korrespondente Myzaferë Limani.

Më 26 shtator 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajtën: takimi i fushës *Energjitë dhe energjetika*, kryesuar nga prof. dr. Naser Sahiti, takimi i fushës *Gjeologjia dhe minierat*, kryesuar nga prof. dr. Naser Peci, takimi i fushës *Inxhinieria, ndërtimtaria dhe arkitektura*, kryesuar nga akademik Isuf Krasniqi, dhe takimi i fushës *Mjekësia dhe shëndeti*, kryesuar nga anëtari korrespondent Arsim Morina.

Nënkryetarja e Akademisë, akademike Justina Shiroka Pula dhe sekretarja e Akademisë, znj. Lendita Pula morën pjesë në Konferencën e 8-të të Përbashkët të Shkencës të Procesit të Berlinit, në Berlin

Me ftesë të Akademisë Nacionale Gjermane të Shkencave-Leopoldina, nënkryetarja dhe Sekretarja e Akademisë qëndruan në Berlin dhe morën pjesë në Konferencën e 8-të të Përbashkët të Shkencës të Procesit të Berlinit.

Konferenca ishte e rëndësishme dhe në të u diskutuan tema të rëndësishme, si: Roli i arsimit, hulumtimit akademik dhe inovacionit në mbrojtjen e demokracisë dhe avancimin e vizionit evropian në

Ballkan; Rritja e bashkëpunimit shkencor ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së; Vlerësimi i Procesit të Berlinit dhe ndikimi i tij në Arsim, Kërkim dhe Inovacion.

Ceremonia solemne u hap nga z. Gerald Haug, kryetar i Akademisë Nacionale Gjermane të Shkencave-Leopoldina. Konferencën dhe pjesëmarrësit i nderoi ministrja Federale e Arsimit dhe Kërkimit Gjerman, znj. Bettina Stark-Watzinger e cila mbajti fjalë rasti.

Gjatë ditëve të Konferencës, përkatësisht më 1 tetor të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës u pritën në Bundestagun Gjerman nga z. Kai Gehring, Kryetar i komisionit për arsimin, kërkimin dhe vlerësimin e teknologjisë.

U mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare e menaxhmentit dhe ndërmarrësisë *Përballja me ndryshimet në një botë dinamike*




Më 4 tetor 2024, në organizim të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare e menaxhmentit dhe ndërmarrësisë *Përballja me ndryshimet në një botë dinamike* / "Navigating Change in a Dynamic World".

Në të morën pjesë me kumtesa anëtarë të Akademisë dhe profesorë të shquar nga vendi dhe më gjerë, si në vijim:

Besnik Krasniqi, Isa Mustafa, Justina Shiroka-Pula, Norbert Bach, Andrea Caputo, Carolin Leutloff-Grandits, Niklas Schulte, Dominik Kanbach, Philip Jaufenthaler, Andreas Kallmünzer, Sascha Kraus, Ilir Hebovija, Ardita Hykaj, Adrian Civici, Eni Nasi, Nikollaq Pano, Anastas Angjeli, Ajkuna Mujo, Dhimitri Tole, Agron Dula, Lura Rexhepi-Mahmutaj, Nora Jusufi, Leonita Mazrekaj, Tringa Krasniqi, Ira Gjika, Mirlinda Jashanica-Gashi, Eneida Hoxha, Visar Vokri, Halim Mahmuti, Alma Bajramaj, Muhamet Mustafa, Hajdin Berisha, Berim Ramosaj, Eriola Hoxha, Elona Shehu, Ergita Kase, Edlira Bode, Lindita Milo-Lati, Elvisa Drishti, Gentjan Ulaj, Jona Marashi, Sonila Nikolla, Alban Hashani, Liridon Kryeziu, Gazmend Qorraj, Gezim Jusufi, Agron Hajdari, Veland Ramadani, Mahmut Hizirolu, Besnik Avdiaj, Vjosë Latifi, Gadaf Rexhepi, Albana Gashi, Gentrit Berisha, Iraj Hashi, Hyrije Abazi-Alili, Eros Angjeli, Gjon Gjonlleshaj, Vlora Prenaj, Besart Hajrizi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Theranda Beqiri, Kaltrina Arifaj, Laura Płatkowska-Prokopczyk, Kujtim Humeli, Xhavit Islami, Enis Mulolli, Blerona Shala, Altin Xhafa, Argjentë R. Qerimi, Besar Berisha.

Ndërron jetë akademik Tahir Emra



Më 7 tetor 2024, në moshën 86-vjeçare ndërroi jetë piktori i shquar, ndër më të

shquarit e artistit shqiptar, akademik Tahir Emra.

Akademik Emra u lind në Gjakovë më 1938. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen të artistit më 1959 në Pejë. Në vitet 1959-1961 punoi si mësues i vizatimit në vendlindje, më pas studioi në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Diplomoi më 1966 për pikturë, teksa një vit më vonë u zgjodh ligjërues e pastaj profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, në Degën e Arteve Figurative. Më pas vijoi studimet pasuniversitare, magjistroi më 1970 dhe më 1974 u zgjodh docent për vizatim dhe pikturë në Akademinë e posathemeluar të Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe më 1982 profesor ordinar. Ka qenë docenti dhe prodekani i parë shqiptar i Akademisë së Arteve, pastaj shef katedre në dy mandate. Gjatë viteve '90, për disa vjet ka mbajtur mësim me studentët në atelienë e shtëpisë së tij. Për dhjetë vjet (1994-2004) ka mbajtur mësim në lëndët vizatim dhe pikturë edhe në Akademinë e Arteve të Universitetit të Tetovës. Ishte njëri nga themeluesit e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe pjesëmarrës i rregullt në aktivitetet e saj.

Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është zgjedhur në vitin 2000, ndërsa anëtar i rregullt në vitin 2008. Për një mandat ka qenë sekretar i Seksionit të Arteve të ASHAK-ut.

Ka hapur disa ekspozita të pavarura dhe ka marrë pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Veprat e tij gjenden në shumë galeri e muze të botës, në institucione dhe në koleksione private.

Në vitin 2013 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës botoi monografinë e piktorit Tahir Emra me riprodhimet e veprave më të njohura dhe me studimin e piktorit Kujtim Buza.

Në respekt të jetës dhe veprës së akademik Tahir Emrës, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhja komemorative

Mbledhjen e filloi me një minutë heshtjeje dhe një fjalë rasti kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, ndërsa për veprën dhe figurën e akademik Tahir Emrës, foli akademik Eqrem Basha.

Në mbledhjen komemorative u lexua edhe telegrami i ngushëllimit i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

U mbajt promovimi i librit: *Ujërat dhe popullsia* i prof. Valbon Bytyqi



Më 9 tetor 2024, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore e promovoi librin *Ujërat dhe popullsia* me nëntitull *Shpërndarja territoriale dhe kohore e ujërave dhe e popullsisë në Kosovë*, të autorit Valbon Bytyqi.

Promovimin e hapi me një fjalë rasti anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të

Shkencave Shoqërore. Për librin folën akademikët Hivzi Islami dhe Justina Sh. Pula, recensentë dhe në fund fjalë falënderuese mbajti edhe autori i librit, prof. Valbon Bytyqi.

U mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare: *Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit (150-vjetori i lindjes)*



Më 14 tetor 2024, në organizim të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare *Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit (150-vjetori i lindjes)*.

Konferencën e hapi akademik Sabri Hamiti, ndërsa fjalë rasti mbajti kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Në konferencë morën pjesë me kumtesat e tyre akademikë dhe profesorë të njohur nga Kosova, Shqipëria dhe më gjerë, si Sabri Hamiti, Gëzim Hoxha, Shaban sinani, Vitor Demaj, Neritan Ceka, Nysret Krasniqi, Mark Marku, Kujtim Shala, Persida Asllani, Dhurata Shehri, Muhamet Hamiti, Gëzim Gurga, Agron M. Camaj, Arsim Bajrami, Arbnora Dushi, Edmond Malaj, Evalda Paci, Marin Haxhimihali, Zana Hoxha, Kujtim Mani, Fehmi Cakolli, Tomi Treska, Jaho Brahaj dhe Lush Culaj.

Konferenca i zhvilloi punimet në tri sesione.

Raporti i punës për takimin e redaksive vendore të Kosovës dhe të Shqipërisë me përgjegjësitë e redaksive të fushave të *Enciklopedisë Shqiptare*



Për tri ditë me radhë, përmbledhur në katër seanca, është mbajtur takimi i punës i redaksive vendore të Kosovës dhe të Shqipërisë me përgjegjësit e fushave të *Enciklopedisë Shqiptare*. Të pranishëm kanë qenë përgjegjësit e të gjitha redaksive të fushave nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe të gjithë anëtarët e Redaksisë vendore nga Prishtina dhe shumica e anëtarëve të redaksisë përkatëse nga Tirana.

Ditën e parë (10 tetor, pasdite) është mbajtur një seancë përgatitore dhe është prezantuar programi, qëllimi dhe synimet e takimit. Nga përgjegjësit e dy redaksive vendore të Kosovës dhe të Shqipërisë u kërkua që pjesëmarrësit të zhvillojnë komunikim dhe takime të ndërvitshme midis fushave të Enciklopedisë, në mënyrë që t'i sheshojnë dallimet dhe t'i koordinojnë sa më mirë punët e mbetura rreth fjalësit të fushave përkatëse.

Në ditën e dytë (11 tetor, në seancën e paradites dhe të pasdites), pas fjalëve hyrëse të përgjegjësve të redaksive vendore të Kosovës dhe të Shqipërisë

(M. Kraja dhe Sh. Sinani), është raportuar për fjalësin e secilës fushë veç e veç (gjithsej 29 fusha), për regjistrin e fjalësit të hartuar nga redaksitë e të dyja palëve dhe për shkallën e harmonizimit të fjalësit ndërmjet redaksive të fushave Kosovë-Shqipëri. U shqyrtuan në detaje mungesat e fjalësve të fushave, përsëritjet eventuale, gjithnjë duke kërkuar që zbatimi i kriterëve të jetë i vazhdueshëm dhe i pandryshueshëm për të dy palët. U diskutuan edhe probleme të tjera të fjalësit, siç janë nocionet e përgjithshme, kriteret për përfshirjen e personaliteteve, kolizionet eventuale të fushat e afërta, gjithëpërfshirja, përsëritjet etj. Në përgjithësi, u tregua kujdes i shtuar që fjalësit e fushave të jenë të balancuar, të hartuar me profesionalizëm, të kenë mbështetje shkencore dhe të gjejnë zbatim në hartimin e teksteve për Enciklopedinë. Gjithashtu iu kushtua kujdes identifikimit dhe emërimit të fjalësve për artikuj përmbledhës, të cilët, sipas udhëzuesit të hartuar më herët, duhet të përfshijnë një numër të konsiderueshëm emërtimesh dhe njësisht nga të gjitha fushat.

Ditën e tretë (12 tetor, paradite), u bë një rekapitullim i punës së bërë deri më tani, duke caktuar edhe detyrat afatshkurtra për redaksitë vendore dhe redaksitë e fushave, siç janë: Përmirësim i fjalësit sipas vërejtjeve të paraqitura; emërtimi dhe përmbajtja e zërave përmbledhës; reduktimi i fjalësit të fushat me numër të tejkaluar të zërave; rishikimi dhe përmirësimi i emërtimeve të fjalësit; koordinimi midis fushave të afërta; si dhe koordinimi i punës ndërmjet redaksive të fushave Kosovës-Shqipëri.

Nga pjesëmarrësit, takimi u vlerësua i dobishëm dhe i suksesshëm, me sugjerimin se takimet e këtilla do të jenë të nevojshme të bëhen edhe në të ardhmen.

Raportin e paraqiti:

Akademik Mehmet Kraja,

Kryeredaktor për Kosovën i

Enciklopedisë Shqiptare

U promovuan librat: *Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Evropës Veriore dhe Bota letrare*



Më 16 tetor 2024, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë promovoi librat: *Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Evropës Veriore dhe Bota letrare* e autorit Muhamet Hamiti.

Aktivitetin e hapi akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të letërsisë.

Për librin e parë folën akademik Rexhep Ismajli dhe anëtar korrespondent Bardh Rugova, ndërsa për të dytin foli anëtar korrespondent Nysret Krasniqi, recensent.

Autori Muhamet Hamiti në fund i përshëndeti dhe i falënderoi të pranishmit me një fjalë.

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica merr pjesë në konferencën ndërkombëtare të Nanoteknologjisë, me titull *Nanoballkan 2024*

Më 28 tetor deri më 1 nëntor 2024, anëtar korrespondent Fetah Podvorica ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të Nanoteknologjisë, me titull *Nanoballkan 2024*.

Konferenca u mbajt në Tiranë dhe u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me ndihmën e njësisë së hulumtimit NanoAlb dhe nga institutet kryesore të nanoteknologjisë në Barcelonë (ICREA-ICN2-BIST), si dhe fondacioni Phantoms. Prof. Podvorica ka mbajtur gjatë konferencës dy ligjërata: *Chemical grafting of coal surface with mixed alkyl-aryl alkyers* dhe *Techering lignite sufrage with organic layer*.

U mbajt promovimi i librit: *Akustika, të folurit dhe muzika* i anëtares korrespondente Myzafer Limani



Më 6 nëntor 2024, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës promovoi librin *Akustika, të folurit dhe muzika* i autores Myzafer Limani.

Promovimin e shpalli të hapur anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i seksionit të Shkencave të

Natyrës. Për librin folën akademik Fejzullah Krasniqi dhe prof.dr. Sabrije Osmanaj. Në fund autorja e librit me një fjalë rasti i falënderoi të gjithë të pranishmit.

U mbajt promovimi i librit: *Veshja elektrokimike e sipërfaqeve të materialeve me molekula organike* i anëtarit korrespondent Fetah I. Podvorica



Më 8 nëntor 2024, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës, promovoi librin *Veshja elektrokimike e sipërfaqeve të materialeve me molekula organike* i autorit Fetah I. Podvorica.

Promovimin e shpalli të hapur akademik Fejzullah Krasniqi. Për librin folën recensentët: anëtar korrespondent Salih Gashi dhe Prof. Avni Berisha.

Në fund autori me një fjalë rasti i falënderoi të gjithë të pranishmit.

Anëtar korrespondent Salih Gashi merr pjesë në konferencën ndërkombëtare *Green energy, erth&environmental science 2024*

Më 17-19 nëntor 2024 anëtar korrespondent Salih Gashi merr pjesë

në cilësinë e Keynote speaker në konferencën ndërkombëtare *Green energy, earth&environmental science 2024*. Konferenca u mbajt në Amsterdam-Holandë.

Prof. Gashi ka paraqitur kumtesën me titull: *The removal characteristic of Pb(II) and Cd (II) ions from Aqueous Solutions Using Corn Bran as Adsorbent*.

U mbajt promovimi i librit “Dizajni kushtetues i qeverisjes lokale, e drejta e komunave në liri të asociimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në Republikën e Kosovës” i anëtares korrespondente Gjyljeta Mushkolaj



Më 19 nëntor 2024, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore promovoi librin: “Dizajni kushtetues i qeverisjes lokale, e drejta e komunave në liri të asociimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në Republikën e Kosovës” nga Gjyljeta Mushkolaj.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Hivzi Islami, ndërsa për librin folën recensentët; anëtar korrespondent Arsim Bajrami dhe Prof. Mirlinda Batalli.

Të pranishmit në fund i përshëndeti dhe i falënderoi për pjesëmarrje edhe autorja e librit.

U mbajt tryeza shkencore “Akademik Fehmi Agani – personalitet shumëdimensional (me rastin e 25-vjetorit të vrasjes)”



Më 18 dhjetor 2024, në organizim të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me fillim prej orës 10:00, u mbajt tryeza shkencore “Akademik Fehmi Agani – personalitet shumëdimensional (me rastin e 25-vjetorit të vrasjes)”.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Anton K. Berishaj. Me kumtesa morën pjesë akademikë e profesorë të njohur, si: akademik Hivzi Islami, akademik Rexhep Ismajli, akademik Isa Mustafa, akademik Jusuf Bajraktari, akademik Muhamedin Kullashi dhe anëtar korrespondent Arsim Bajrami.

Akademik Fejzullah Krasniqi merr pjesë në konferencën ndërkombëtare *Sfidat e ngrohjes së ndërtesave të banimit në zhvillimin e qëndrueshëm*

Më 21 dhjetor 2024 në Tiranë u mbajt konferenca ndërkombëtare *Sfidat e ngrohjes së ndërtesave të banimit në zhvillimin e qëndrueshëm*, në të cilën akademik Fejzullah Krasniqi mori pjesë aktivisht duke qenë pjesë e panelit drejtues të seancës plenare. Akademik Krasniqi po ashtu paraqiti kumtesën me

titull: *Aplikimi i sistemeve të kogjenerimit nga TEC Kosova B për ngrohje*. Kumtesa zgjoi interesim të pranishmit.

U mbajt Kuvendi zgjedhor i ASHAK-ut për zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe avancimin e anëtarëve korrespondentë në anëtarë të rregullt



Mbledhja u mbajt më 23 dhjetor 2024 dhe në këtë mbledhje Kuvendi i ASHAK-ut zgjodhi:

Anëtarë të rregullt (akademikë)

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

1. Bardh RUGOVA
2. Shkumbin MUNISHI

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore

1. Arsim BAJRAMI
2. Besnik KRASNIQI
3. Frashër DEMAJ

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

1. Arsim MORINA
2. Salih GASHI

IV. Seksioni i Arteve

1. Xhevdet XHAFA

Anëtarë korrespondentë

I. Seksioni i Shkencave Shoqërore

1. Muhamet MALA

II. Seksioni i Shkencave të Natyrës

1. Enver HAMITI

III. Seksioni i Arteve

1. Ismet JONUZI
2. Zake PRELVUKAJ

Takim në ASHAK me delegacionin e “Drejtorisë për hetimin dhe zbulimin e krimeve të luftës” të Policisë së Kosovës



Më 24 dhjetor në mjediset e ASHAK-ut, anëtarët e Akademisë, Arsim Bajrami, Gjyljeta Mushkolaj dhe Frashër Demaj pritën delegacionin e “Drejtorisë për hetimin dhe zbulimin e krimeve të luftës” të Policisë së Kosovës të kryesuar nga major Bashkim Spahiu. Në takim u bisedua për bashkëpunimin e ndërsjellë në këtë fushë të rëndësishme për zbardhjen e krimeve të luftës të kryera nga Serbia në Kosovë.

VJETARI
2024

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 8 tabakë shtypi

Tirazhi: 100 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

